

1 E mërkurë, 18 dhjetor 2024
2 [Seancë e hapur]
3 [Seancë mbi Marrëveshje për Pranimin e
4 Fajësisë]
5 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]
6 [I akuzuari Bahtijari paraqitet përmes
7 videolidhjes]
8 --- Seanca fillon në orën 09.04

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Mirëmëngjesi dhe mirë se vini të gjithë të pranishmit në sallë
11 apo jashtë sallës.

12 z. Sekretare, thërrisni lëndën, ju lutem.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
14 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2023-10, Prokurori i
15 Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi
16 Shalës. Faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Do t'ju kërkoja palëve të prezantohen duke filluar me
20 Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Fjalën e keni ju.

21 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit. Mirëmëngjesi.
22 Tazneen Shahabuddin, Ndhmësprokurore -- Prokurore në Zyrën e
23 Prokurorit të Specializuar. Bashkë me mua është Josh Hafetz,
24 Prokuror dhe Ndhmësprokurori John Devaney, dhe pas meje është
25 menaxherja e lëndës, Line Pederson.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Tani i drejtohem Mbrojtjes dhe ju kërkoja të prezantoheni
4 dhe të prezantoni ekipin tuaj kush merr pjesë këtu apo në
5 sallën e gjyqit apo përmes videolidhjes.

6 Fillojmë me Mbrojtjen e z. Shala.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar Gjykatëse.

8 Unë jam Toby Cadman, Mbrojtës i Specializuar për z. Shala. Së
9 bashku me mua është John Cubbon, Bashkëmbrojtës i
10 Specializuar, Isabella Kirwan, që është juriste, Admir
11 Berisha, hetues dhe z. Shala.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Pastaj vazhdojmë me Mbrojtjen e z. Januzi.

15 Z. REES: [Përkthim] Jonathan Rees, Mbrojtës i
16 Specializuar. Bashkëmbrojtësi i Specializuar Huw Bowden;
17 Muharem Halilaj, në rreshtin e parë, gjithashtu, si udhëheqës
18 ekipi [Sipas përkthimit]. Na ndihmojmë gjithashtu Elin Morgan,
19 Sali Harmes, Zoe Laugharne, që janë stazhiere në rreshtin
20 prapa.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit shumë, z. Avokat.

23 Tani kalojmë tek Mbrojtja e z. Bahtijari. Fjalën e keni
24 ju.

25 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve në sallën

1 e gjyqit dhe ata që janë jashtë. Unë jam Felicity Gerry,
2 Mbrojtëse e Specializuar e z. Bahtijari, i cili është i
3 pranishëm përmes videolidhjes. Bashkë me mua është Marion
4 Carrin në sallën e gjyqit. Zyrtarja ligjore Dafne [Sipas
5 përkthimit] Yiqing Liu, Phillipa Stafford, Caitlyn Deleney
6 [Sipas përkthimit] dhe Cassandra Le Good dhe Ismar Ridzalovic.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Vazhdojmë. Trupi Gjykses synon të zhvillojë seancën sot
10 në seancë publike.

11 Trupi Gjykses i rikujton palëve se nëse ka nevojë të
12 kalojmë në seancë private, për shembull, për të respektuar
13 privatësinë e të akuzuarve apo për të shmangur nxjerrjen e
14 ndonjë informacioni konfidencial, pres që palët t'i drejtohen
15 Trupit Gjykses menjëherë dhe ne do ta trajtojmë atë çështje në
16 atë moment.

17 Trupi Gjykses sot ka caktuar seancën e sotme për të
18 diskutuar parashtrimet e palëve mbi pikat e ndryshme që kanë
19 të bëjnë me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe
20 procedurën.

21 Së pari, do t'i jap fjalën -- do të jap një kontekst
22 procedural lidhur me këtë, gjithashtu, edhe për nevojat e
23 publikut.

24 Më 24 tetor të këtij viti, Trupi Gjykses vendosi që
25 gjykimi do të fillojë të hapet me 14 nëntor 2024. Kjo është

1 parashtrimi i protokolluar 559.

2 Me 11 nëntor, ZPS-ja dhe Mbrojtja njoftuan Trupin Gjykses
3 se ata ishin në fazat përfundimtare të arritjes, për secilin
4 prej të akuzuarve, marrëveshje për pranimin e fajësisë. Kjo
5 është parashtrimi 587.

6 Me 12 nëntor, pas kërkesës së palëve, Trupi Gjykses shtyu
7 fillimin e gjykimit me qëllim që të lehtësonte përfundimin dhe
8 përmbylljen e marrëveshjeve të fajësisë. Kjo është parashtrimi
9 593.

10 Me 13 nëntor, ZPS-ja informoi Trupin Gjykses se kishin
11 arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me z. Shala, z.
12 Januzi dhe z. Bahtijari. Dhe këto marrëveshje iu dorëzuan
13 Trupit Gjykses. Parashtrimi 596/COR.

14 Me 14 nëntor, pas nxjerrjes -- dorëzimit të marrëveshjeve
15 të fajësisë, Trupi Gjykses, pra, miratoi kërkesën e palëve për
16 të pezulluar të gjitha afatet kohore të caktuara më parë për
17 parashtrimet e ardhme, me përjashtim të afateve kohore që kanë
18 të bëjnë me rishikimin e paraburgimit të të akuzuarve.
19 Parashtrimi 600.

20 Me 20 nëntor, Trupi Gjykses nxori vendimin mbi çështjet
21 që kanë të bëjnë me procedurën mbi marrëveshjen e fajësisë.
22 Parashtrimi 612, që të cilit do t'i referohem si Vendimi për
23 Procedurat e Marrëveshjes së Fajësisë - ku u udhëzuan palët që
24 të parashtrojnë një version të rishikuar të secilës
25 marrëveshje të fajësisë duke përmbushur kriteret e rregullës

1 94 të Rregullores së Procedurave edhe Provave para Dhomave të
2 Specializuara; dhe të bëjnë parashtrime me shkrim lidhur me
3 çështjet që kanë të bëjnë me dënimin dhe të paraqesin
4 informacion apo prova mbi dënimin, në qoftë se dëshirojnë të
5 bëjnë një gjë të tillë.

6 Trupi Gjykses urdhër -- Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në
7 gjithashtu që të parashtrojë në aktakuzën e rishikuar duke
8 marruar parasysh kushtet e marrëveshjes së rishikuar mbi
9 pranimin e fajësisë.

10 Të premtën, me 6 dhjetor, ZPS-ja parashtroi -- dorëzoi
11 parashtrimet për marrëveshjen e fajësisë dhe dënimin,
12 përfshirë edhe versionin e rishikuar për secilën marrëveshje.
13 Të njëjtën ditë, ata dorëzuan aktakuzën e rishikuar, siç ishin
14 urdhëruar nga Trupi Gjykses.

15 Po të njëjtën ditë, Mbrojtja e Shalës, Mbrojtja e Januzit
16 dhe Mbrojtja e Bahtijarit dorëzuan parashtrimet e tyre
17 përkatëse ku trajtonin çështje që kanë të bëjnë me dënimin dhe
18 ku paraqiteshin informacione apo prova relevante.

19 Të hënë, me 9 dhjetor, ZPS-ja parashtroi një kërkesë,
20 parashtrimi 621, ku i kërkonte Trupit Gjykses që të rishikonte
21 Vendimin mbi Procedurën e Marrëveshjes së Fajësisë, vendim --
22 parashtrimi i vendimit 612, ose si alternativë të miratonte
23 kërkesën e ZPS-së për të bërë apel ndaj këtij vendimi.
24 Mbrojtja e Shalës dhe Mbrojtja e Bahtijarit u përgjigjën ndaj
25 kërkesës së ZPS-së me 12 dhe 13 dhjetor 2024, përkatësisht.

1 Mbrojtja e Januzit informoi se nuk do të përgjigjeshin. ZPS-ja
2 tha që nuk do të jepnin kundërpërgjigje.

3 Të premten e kaluar, 13 dhjetor, Trupi Gjykses nxori
4 vendimin për caktimin e kalendarit për seancën e sotme dhe
5 urdhëroi riklasifikimin e marrëveshjeve të pranimit të
6 fajësisë të rishikuara, riklasifikimin për z. Shala dhe z.
7 Januzi në interes të bërjes publike të procedurës. Në të
8 njëjtin vendim, Trupi Gjykses vendosi që z. -- marrëveshja e
9 pranimit të fajësisë së z. Bahtijari nuk do të diskutohej në
10 këtë seancë sepse nuk përmbushte kriteret sipas rregullës 94
11 të Rregullores.

12 Me 16 dhjetor, pra, të hënën e kaluar, palët e informuan
13 Trupin Gjykses se kishin arritur një marrëveshje për pranimin
14 e fajësisë të re me z. Bahtijari dhe ia dorëzuan këtë
15 marrëveshje Trupit Gjykses. Parashtrimi 628. ZPS-ja dhe
16 Mbrojtja e Bahtijarit parashtrojnë se marrëveshja e re e
17 fajësisë zgjidh çështjet që ishin ngritur më herët nga Trupi
18 Gjykses dhe i kërkon Trupit Gjykses, në interes të
19 përshpejtimit të procedurës, që të marrin parasysh
20 marrëveshjen e re dhe të caktojnë një seancë të kësaj
21 marrëveshje, për trajtimin e kësaj marrëveshje për z.
22 Bahtijari me 18 dhjetor 2024.

23 Dhe dje, ZPS-ja dorëzoi njoftimin e tërheqjes së kërkesës
24 së saj me numër 621, në të cilën kishte kërkuar rishikimin e
25 vendimit për procedurën e marrëveshjes së fajësisë, ose si

1 alternativë kërkonte leje për të -- autorizim për të bërë apel
2 ndaj këtij vendimi.

3 Dhe së fundi, po dje, ZPS-ja parashtroi aktakuzën e
4 rishikuar më tej. Parashtrimi 630.

5 Duke patur parasysh këto zhvillime procedurore Trupi
6 Gjykues do të vijojë si në vijim. Gjatë seancës së -- pjesës
7 së parë të seancës Trupi Gjykues do të diskutojë çështje që
8 janë të gjitha me interes për tre të akuzuarit dhe pastaj do
9 të nxjerrë një numër të caktuar urdhrash gojor.

10 Pas kësaj, do të bëjmë dy seanca të ndara për të
11 diskutuar marrëveshjet e fajësisë të z. Shala, i cili është
12 aty mbrapa e shoh, dhe z. Januzi, përkatësisht, me ZPS-në për
13 të ecur sa më shumë që është e mundur me këtë procedurë.

14 Së pari, nga ora 11.00 deri në orën 1.00, do të
15 diskutojmë marrëveshjen e fajësisë së z. Shala, parashtrimi
16 618, Shtojca 1. Seanca në vijim pastaj pas pushimit, pra 2.30
17 deri në 4.30, do të diskutojmë marrëveshjen mbi pranimin e
18 fajësisë së z. Januzi, që është parashtrimi 618, Shtojca 2,
19 dhe parashtrimi 632, Shtojca 1, me përkthimin në shqip.

20 Gjatë dy seancave, Trupi Gjykues do t'i pyesin z. Shala
21 dhe z. Januzi, do t'ju kërkojë atyre të konfirmojnë sipas
22 rregullës 94(5)(a) të Rregullores, si në vijim: nëse
23 Mbrojtësit e tyre përkatës kanë diskutuar me z. Shala dhe z.
24 Januzi kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë për
25 secilin prej tyre; nëse z. Shala dhe -- jo, z. Shala, ndoshta

1 mund të kaloni pak më djathtas që t'ju shoh më mirë.

2 Faleminderit.

3 Pra, nëse z. Shala dhe z. Januzi kuptojnë kushtet e
4 marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë përkatëse. Së treti,
5 nëse z. Shala dhe z. Januzi konfirmojnë pranimin e fakteve
6 lidhur me -- në lidhje me aktakuzat që janë në marrëveshjen
7 mbi pranimin e fajësisë për secilin prej tyre; nëse z. Shala
8 dhe z. Januzi janë pajtuar me marrëveshjen mbi pranimin e
9 fajësisë në mënyrë vullnetare, pa kërcënim dhe shtrëngim; dhe
10 nëse z. Shala dhe z. Januzi i kuptojnë pasojat e marrëveshjeve
11 mbi pranimin e fajësisë për ta dhe heqin dorë nga e drejta për
12 t'u gjykuar sipas një gjykimi të zakonshëm.

13 Pastaj Trupi Gjykses do t'i kërkojë z. Shala dhe z.
14 Januzi të konfirmojnë nëse ata dëshirojnë të ndryshojnë
15 deklarimin e tyre mbi fajësinë fillestare dhe të bëjnë një
16 deklaram tjetër për Pikat 1, 2 të aktakuzës së rishikuar të 6
17 dhjetorit 2024. Do të kthehem tek kjo pjesë e aktakuzës më
18 vonë.

19 Trupi Gjykses, gjithashtu, do i japë mundësinë ZPS-së,
20 Mbrojtjes së Shalës dhe Mbrojtjes së Januzit që të bëjnë
21 parashtrime gojore shtesë lidhur me dënimin, përveç atyre që
22 janë parashtruar me shkrim, si dhe çështje të tjera që kanë
23 rëndësi për procedurën për marrëveshjen e fajësisë.

24 Më tej Trupi Gjykses do t'i japë mundësinë z. Shala dhe
25 z. Januzi, në qoftë se ata dëshirojnë të bëjnë një deklaratë

1 lidhur me procedurën për marrëveshjen e fajësisë, përfshirë
2 edhe çështje që kanë të bëjnë me fajësinë apo dënimin.

3 Në rregull.

4 Z. REES: [Përkthim] Mund të përmend një temë?

5 Ju thatë që synoni që të pyesni z. Januzi nëse ai
6 dëshiron të ndryshojë deklarinimin mbi fajësinë duke iu referuar
7 aktakuzës së rishikuar që është dorëzuar me 6 dhjetor. Në
8 fakt, është aktakuza e rishikuar më tej që duhet të përdoret
9 për këtë qëllim dhe që është dorëzuar dje.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, z. Avokat. Do të kthehem tek kjo pikë. Siç e
12 thashë më herët tek statusi i kësaj aktakuze dhe do ta
13 trajtojmë më tej. Konstatoj komentin tuaj gjithsesi.

14 Në rregull. Tani kalojmë tek çështjet paraprake.

15 Që në fillim Trupi Gjykses konstaton tërheqjen nga ZPS-ja
16 të kërkesës së saj me numër 621 në të cilën kërkonte rishikim
17 të vendimit mbi procedurën e marrëveshjes së fajësisë apo, si
18 alternativë, autorizim për të bërë apel ndaj këtij vendimi,
19 dhe nuk do ta trajtojë këtë më tej.

20 Trupi Gjykses gjithashtu informon palët se ndonëse
21 tërheqja e kërkesës nga ana e ZPS-së, duke patur parasysh
22 njoftimin e vonshëm bashkë me parashtrimet e tjera të vonshme,
23 Trupi Gjykses nuk do të nxjerrë vendim lidhur me marrëveshjet
24 për pranimin e fajësisë në fund të kësaj seance, seancë që do
25 të vazhdojë edhe nesër. Një vendim me shkrim lidhur me faktin

1 nëse Trupi Gjykses miraton marrëveshjet për pranimin e
2 fajësisë do të nxirret në kohë të duhur pas seancave të sotme
3 dhe të nesërme, si dhe pas vlerësimit të Trupit Gjykses nëse
4 kërkohen parashtrimet e tjera me shkrim apo seancat e tjera.

5 Së fundi, Trupi Gjykses informon palët se urdhri për
6 parashtrimin e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë të
7 rishikuara më tej, do të nxirren në kohë. Urdhri për këtë do
8 të nxirret në kohë.

9 Pastaj, sa i takon parashtrimin të ZPS-së për aktakuzën e
10 rishikuar më tej, parashtrimi i protokolluar me numër 630,
11 Shtojca 1, Trupi Gjykses vëren se ky dokument i rishikuar
12 është njoftuar dhe në orën 3.24 të pasdites. Duke pasur këtë
13 parasysh, Trupi Gjykses nuk do ta vlerësojë këtë për qëllime
14 të seancë së sotme, duke patur parasysh se nuk ka -- Trupi
15 Gjykses nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që do t'i kishte
16 dhënë mundësi për ta rishikuar atë dhe vlerësuar në mënyrë të
17 duhur. Trupi Gjykses do ta shqyrtojë në kohë të duhur.

18 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se aktakuza që
19 aktualisht merret parasysh në këtë çështje në përputhjen me
20 udhëzimet e Trupit Gjykses në paragrafët 23 dhe 34(b) të
21 vendimit me numër 612, është ai dokument që duhet të
22 parashtrohet nga ZPS-ja me datë 6 dhjetor 2024 -- dokumenti që
23 ishte parashtruar nga ZPS-ja me 6 dhjetor me numër 610.

24 Z. REES: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Prisni, prisni. Mos ndërprisni. Po flas.

2 Pastaj do t'i -- në vijim do t'i referohemi këtij si
3 dokument, aktakuza e datës 6 dhjetor 2024.

4 Përpara që të vazhdojmë, dhe do t'ju jap fjalën z. Rees.
5 Z. Rees, mos u shqetësoni, do t'jua jap fjalën.

6 Përpara që të vazhdojmë, megjithatë, kërkojmë nga palët
7 që të shpjegojnë pse paragrafët 11, 19, pra 11 dhe 19 të
8 aktakuzës të datës 6 dhjetor 2024 janë fshirë nga aktakuza e
9 dorëzuar dje, parashtrimi 630, dhe nëse, në qoftë se kjo
10 ndodh, në çfarë shkalle kjo fshirje ndikon në akuzat për të
11 cilat është bërë deklarami i fajësisë në marrëveshjen mbi
12 pranimin e fajësisë.

13 Së pari do t'ja jap fjalën z. Rees, sepse kërkoi fjalën.
14 Pastaj do t'ja jap fjalën edhe dy mbrojtësve të tjerë.

15 Z. Avokat, keni fjalën ju.

16 Z. REES: [Përkthim] Mund t'i përgjigjem pyetjes së parë
17 pse janë përfshirë këto dy paragrafë. Është shumë thjesht.

18 Juve na keni urdhëruar, znj. Gjykatëse, që aktakuza të
19 rishikohet për të pasqyruar përmbajtjen e marrëveshjes së
20 fajësisë. Marrëveshja e fajësisë përqendrohet vetëm në
21 frikësimin përmes ofrimit të një përfitimi. Kërcënimi nuk
22 është pjesë e marrëveshjes së fajësisë dhe nuk është as frika
23 apo shqetësimi i shkaktuar tek dëshmitarët e pretenduar.

24 Ndikimi tek dëshmitarët nuk është diçka për të cilën jemi
25 pajtuar dhe nuk është vërtetuar kundër z. Januzi. Për

1 rrjedhojë, kur u dorëzua aktakuza e rishikuar e 6 dhjetorit,
2 ne trajtuam me ZPS-në atë që sipas mendimit tonë nuk është në
3 përputhje me urdhrin për të rishikuar aktakuzën dhe për të
4 pasqyruar këto në marrëveshjen e fajësisë.

5 Pas shkëmbimeve konstruktive të gjata me Prokurorinë, të
6 cilat përfundimisht çuan në aktakuzën e rishikuar me qëllim
7 për nevoja të marrëveshjes të fajësisë që u dorëzua me datën
8 17 dhjetor. Është dokumenti për të cilin palët janë pajtuar
9 dhe pasqyron marrëveshjen e fajësisë.

10 Në fakt kjo nuk ndikon fare në marrëveshjen e fajësisë,
11 pra, sepse është në përputhje dhe përputhet me marrëveshjen e
12 fajësisë për z. Januzi dhe do të -- kolegët e mi do të merren
13 me qëndrimin e z. Shala dhe Bahtijari. Megjithatë, ajo që mund
14 të them është që kuptohet se palët janë marrë vesh se kjo
15 pasqyrohet në -- kjo pasqyron, kjo aktakuzë pasqyron
16 marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë për të gjithë të
17 akuzuarit.

18 Marrëveshjet janë bazuar në baza faktike që janë shtojcë
19 e marrëveshjes. Do të shikoni në këto marrëveshje të fajësisë
20 që në këto shtojca nuk ka asnjë referencë, nuk përmendet fare
21 ndonjë shqetësim apo pasojë frike, apo shqetësimi nga ana e --
22 sa i takon dëshmitarëve. Për rrjedhojë, ne parashtrojmë se
23 aktakuza është relevante për qëllime të marrëveshjeve për
24 pranimin e fajësisë dhe kjo aktakuzë është ajo e rishikuar e
25 datës 17 dhjetor 2024.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
2 dëgjova parashtimin tuaj. A ka ndonjë pasojë që ky të jetë
3 dokumenti që ne do të përdorim sot?

4 Z. REES: [Përkthim] Po. Ne duhet të injorojmë aktakuzën e
5 rishikuar, atë të mëhershme, sepse siç ZPS-ja në mënyrë të
6 duhur dhe të drejtë njoftoi Trupin Gjykes për parashtimin e
7 saj. Në të kohë bisedimet vazhdonin mes palëve për të arritur
8 një marrëveshje.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit, z. Rees. Nuk do të zgjatëm me këtë diskutim me
11 ju lidhur me këtë, por po ju them që ne e kemi konstatuar që
12 ka bisedime që vazhdojnë. Kemi konstatuar gjithashtu që e kemi
13 marrë dje aktakuzën e rishikuar më tej, dje vonë pasdite. Kaq
14 mund të them.

15 Z. REES: [Përkthim] Kjo është pasojë e një rezultati e
16 një pune të madhe nga ana e ekipit të Prokurorisë që janë
17 përballë meje. I përgëzoj për frymën konstruktive në të cilën
18 kanë marrë pjesë në këto diskutime. Por është edhe rezultati i
19 punës së madhe që kemi bërë edhe ne nga ana jonë për të
20 arritur këtë.

21 Natyrisht do të kishim dëshiruar që këtë marrëveshje ta
22 kishim arritur më herët se sa ç'e arritëm. Por, duke pasur
23 parasysh që aktakuza e rishikuar më tej e datës 17 dhjetor
24 pasqyron marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë, thelbi i së
25 cilave është në duart e Trupit Gjykes për një kohë të gjatë.

1 Tani parashtroj se aftësinë e Trupit Gjykses për të trajtuar
2 dhe kuptuar sa më shpejt -- rishikuar përmbajtjen e
3 marrëveshjeve të fajësisë, dhe duke iu referuar aktakuzës së
4 datës 17 dhjetor, ne kërkojmë që aktakuza e rishikuar e
5 mëhershme të mos merret parasysh.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pjesa
7 e fundit e ndërhyrjes suaj u konstatua dhe u shënua.
8 Faleminderit.

9 Tani i jap fjalën Mbrojtësit të z. Shala.

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Kemi qëndrim të njëjtë. Natyrisht
11 qëndrimi i z. Shala është që aktakuza e datës 6 dhjetor nuk e
12 pasqyron në mënyrë të duhur përmbajtjen e marrëveshjes mbi
13 pranimin e fajësisë. Ndryshimet që janë bërë aty tani në
14 aktakuzën e rishikuar më tej të datës 17 dhjetor, pasqyrojnë
15 këto ndryshime në mënyrë të duhur.

16 Ky është qëndrimi jonë, pra që ne duhet të vazhdojmë më
17 tej me aktakuzën e datës 17 dhjetor dhe jo atë të mëhershme

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Do të shtoja gjithsesi që është
21 vështirë të vazhdojmë më tej me këto çështje sot përveç nëse
22 dhe kur aktakuza e datës 17 dhjetor të vlerësohet nga ju, e
23 nderuara Gjykatëse, si aktakuza mbi të cilën duhet të
24 mbështetemi për të vazhduar më tej.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Parashtrimi juaj është i qartë. Faleminderit.

2 Mbrojtësja e z. Bahtijari, fjalën e keni ju.

3 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Ne pajtohemi me parashtrimet e z.

4 Rees dhe z. Cadman për z. Januzi dhe z. Shala, përkatësisht.

5 Aktakuza e datës 17 dhjetor është aktakuza e cila është

6 njoftuar për të cilën ka një marrëveshje. Është bërë në

7 bashkëpunim, është e arsyeshme, është një zgjidhje e arsyeshme

8 e çështjeve, pasqyron në mënyrë të duhur provat dhe pasqyron

9 në mënyrë të duhur marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë.

10 Siç është konstatuar nga Gjykata, Trupi Gjykues ka pasur

11 kohë që nga dje dhe për ta rishikuar atë. Ka konstatuar cilët

12 paragrafë janë hequr, fshirë aty, dhe për rrjedhojë kjo

13 procedurë duhet të vazhdojë mbi bazën e kësaj aktakuze, pra të

14 datës 17 dhjetor, për të cilën të gjithë jemi pajtuar dhe kemi

15 punuar shumë për ta arritur.

16 Duhet të shtoj që qëndrimi i z. Bahtijari është që ai

17 duhet të lirohet menjëherë dhe çdo vonim i mëtejshëm është --

18 i shkakton dëm atij. Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Avokate Mbrojtëse, është qëndrimi juaj që ndryshimet e

22 vetme të bëra në aktakuzën e ndryshuar më tej janë paragrafët

23 që i përmenda unë?

24 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Jo, po bëja një përmbledhje të

25 asaj që ne kemi parashtruar.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] në
2 rregull.

3 ZPS-ja, fjalën e keni ju.

4 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Ne pajtohemi me parashtrimet
5 e Mbrojtësve të Specializuar, sa i përket asaj se si u arrit
6 në marrëveshjen që rezultoi në aktakuzën e rishikuar më tej.

7 U tërhoq pika 1, si dhe fakte dhe pretendime të tjera që
8 u morën parasysh gjatë marrëveshjeve të rishikuara për
9 fajësinë.

10 Megjithatë, ne këtë aktakuzë e ndamë me Mbrojtësit
11 përpara se të bënim parashtrimin e 6 dhjetori, që është edhe
12 arsyeja pse në faqen kryesore të atij parashtrimi ne kemi bërë
13 të ditur që do të ketë edhe diskutime të tjera të mëtejshme
14 dhe ato biseda vazhduan me zell nga të gjitha palët dhe ne të
15 gjithë arritëm marrëveshjet dhe dorëzuam aktakuzën e
16 rishikuar të ndryshuar më tej.

17 Dhe kushtet e aktakuzës së rishikuar më tej nuk vendosin
18 ndonjë kufi për sa i përket pranueshmërisë nga ana e Trupit
19 Gjykes të atyre marrëveshjeve për secilin nga tre të
20 akuzuarit dhe këto marrëveshje për fajësi i referohen
21 paragrafëve specifike dhe dispozitave në aktakuzën e ndryshuar
22 që u dorëzua me numrin 379 me 10 korrik.

23 Për nevojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe
24 asaj për të cilën palët kanë rënë dakord sa i përket akuzave
25 për të cilat akuzuarit propozojnë të vetëdeklarohen fajtorë,

1 këto aspekte të aktakuzës mbeten të pandryshuara dhe nuk duhet
2 të kenë kurrfarë ndikimi në aftësinë e Trupit Gjykses për t'i
3 pranuar ato marrëveshje apo për të vazhdu në bazë të
4 marrëveshjeve ashtu siç shkruhen për nevojat e kësaj seance
5 sot.

6 Me parashtrimin e aktakuzës së 6 dhjetorit dhe asaj të 17
7 dhjetorit, ZPS-ja ishte e qartë në parashtrimin e vet se këto
8 aktakuza hynë në fuqi pas pranimin të marrëveshjeve nga palët
9 dhe pas vetëdeklarimit të fajësisë, kështu që për asnjë arsye
10 këto marrëveshje nuk e zgjidhnin çështjen dhe mbetën me
11 aktakuzat e rishikuara të cilat ishin të dizajnuara me atë
12 qëllim ndërmend.

13 Qëndrimi jonë është se që nga dita e sotme dhe deri në
14 vetëdeklarimin e fajësive dhe pranimin të tyre, ne jemi në
15 pozitë që të vazhdojmë tek përcaktimi i dënimit dhe që
16 versionin i punës i aktakuzës duhet të mbetet ai i 10 korrikut
17 që u ndryshua më pas.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit. Gjithsesi që do t'ua jap fjalën edhe Mbrojtësve
20 që të përgjigjen në parashtrimet e ZPS-së.

21 Z. Rees, a keni diçka për të shtuar në lidhje me këtë?

22 Z. REES: [Përkthim] Është e qartë se të gjitha palët,
23 Mbrojtja dhe Prokuroria pajtohen se aktakuza që duhet të
24 merret parasysh për qëllimet e marrëveshjes së fajësisë është
25 ajo e 17 dhjetorit 2024 dhe se aktakuza e 6 dhjetorit e

1 rishikuar nuk duhet të merret parasysh dhe thjesht duhet të
2 vazhdohet procesi në bazë të aktakuzës së 17 dhjetorit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Z. Avokat, përfaqësues i z. Shala keni diçka për të
6 shtuar?

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Pajtohem me atë që ka thënë z. Rees
8 dhe ZPS-ja.

9 Do të shtoja vetëm se na vendos pak si një pozitë të
10 papërshtathsme për sa i përket mënyrës se si do të vazhdohet.
11 Nuk e di se si mund të vazhdojmë në lidhje me parashtrimet për
12 përcaktimin e dënimit pa pasur dijeni për vendimin që do të
13 merret në lidhje me marrëveshjet e fajësisë ose në qoftë se
14 ato do të pranohen.

15 Është vendim brenda kompetencës së juaj si Trup Gjykses
16 dhe unë ju kërkoj që të merrni një vendim urgjent në lidhje me
17 këtë çështje në mënyrë që të dimë se si do të vazhdojmë më
18 tej.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Znj. Gerry.

22 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Faleminderit. Pajtohem me
23 parashtrimet që u bënë këtë sallë gjyqi, veçanërisht me ato të
24 z. Cadman, se nuk ka kuptim që të vazhdojmë pa e ditur në
25 qoftë se aktakuza e rishikuar më tej është pranuar dhe

1 respektivisht janë pranuar edhe marrëveshjet për fajësinë që
2 dalin prej saj.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Tani e ka fjalën znj. Prokurore.

6 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Unë kam një qëndrim tjetër
7 dhe dua ta qartësoj atë që e thashë pak më herët. Ne pajtohemi
8 se për sa i përket aktakuzës së rishikuar duhet të vazhdojmë
9 me atë që u dorëzua dje. Megjithatë, duke qenë se marrëveshjet
10 për fajësinë i referohen konkretisht aktakuzës së 10 korrikut
11 dhe paragrafëve që përmban ajo, dhe duke qenë se kjo nuk do të
12 ndryshojë, qëndrimi jonë është se nuk ka ndonjë farë pengese
13 që të vazhdojmë edhe sot për sa i përket sqarimeve të
14 mëtejshme në lidhje me marrëveshjet e fajësisë që janë
15 dorëzuar, marrëveshjet midis ZPS-së dhe çdonjërit prej të
16 akuzuarve për qëllimet e seancës së sotme.

17 Ne themi se marrëveshja e fajësisë është një dokument i
18 plotë që pasqyron të gjitha pikat e aktakuzës për të cilat të
19 akuzuarit propozojnë të vetëdeklarohen fajtorë, përmban dhe
20 akuzat konkrete si dhe bazën faktike mbi të cilën bazohen ato
21 akuza.

22 Kështu që mund të vazhdojmë edhe sot në lidhje me këtë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit, znj. Prokurore.

25 Për mua është me rëndësi që të gjithë ju të paraqisni

1 mendimet tuaja në masë të mjaftueshme këtu.

2 Meqë nuk shoh që dikush tjetër do të marrë fjalën, do të
3 vazhdoj me dhënien e dy urdhrave gojor. Pas kësaj Trupi
4 Gjykues do të bëjë një pushim dhe do ta diskutojnë çështjen që
5 ka përpara dhe do të kthehet më pas me vendim. E shikoj që
6 pohoni me kohë që është shenjë e mirë.

7 Urdhri i parë gojor ka të bëjë me marrëveshjen e re të
8 fajësisë që kanë dorëzuar ZPS-ja dhe Mbrojtja e Bahtijarit të
9 hënën me 16 dhjetor 2024. Është parashtrimi i protokolluar
10 628, Shtojca 1. Unë dhashë historikun procedural për sa i
11 përket këtij parashtrimi, pasi --

12 A nuk më dëgjoni?

13 ZNJ. GERRY: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Mikrofonin duhet ta keni të fikur. Por mund t'ja lëshoni pak
16 më shumë zërin.

17 ZNJ. GERRY: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
19 urdhri gojor ka të bëjë me marrëveshjen e fajësisë së dorëzuar
20 nga ZPS-ja dhe Mbrojtja e Panelit [Sipas përkthimit].

21 Pasi ka shqyrtuar marrëveshjen e re të fajësisë, Trupi
22 Gjykues konstaton se kjo marrëveshje i plotëson kërkesat e
23 rregullës 94(2) të Rregullores.

24 Prandaj, Trupi Gjykues, e gjykon të arsyeshme të caktojë
25 një seancë për të enjten me 19 dhjetor 2024, në orën 1.00 në

1 vartësi të vendimit që mund të marrë Trupi Gjykses sot në
2 lidhje me çështjen e pazgjidhur për të diskutuar pra,
3 marrëveshjen e re të z. Bahtijari për pranimin e fajësisë me
4 ZPS-në, në mënyrë që të sigurohet ecuri e shpejtë e procesit.

5 Gjatë asaj seance, Paneli do të ndjekë rendin e ditës të
6 paraqitur në paragrafin 20 të vendimit të vet 626. Në
7 përputhje me këtë, Mbrojtja e Bahtijarit, udhëzohet të bëjë të
8 ditur në qoftë se z. Bahtijari ka ndërmend të bëjë deklaratë
9 në procesin e marrëveshjes së fajësisë, duke përfshirë dhe për
10 çështje që kanë të bëjnë me fajësinë dhe caktimin e dënimi
11 deri sot me datën 18 dhjetor.

12 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Këtë mund të -- për këtë mund t'ju
13 përgjigjem menjëherë. Nuk ka ndërmend të bëjë deklaratë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
15 herën tjetër ta dini që të mos më ndërprisni. Unë e bëj të
16 ditur në fund se ku përfundon urdhri.

17 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Gjithashtu, duke marrë parasysh natyrën e seancës dhe çështjet
20 që duhet të diskutohen gjatë saj, Trupi Gjykses merr vendim në
21 bazë të nenit 42(2) të Ligjit, që të mbajë këtë seancë në
22 prani të z. Bahtijari. Konkretisht, Trupi Gjykses e gjykon të
23 arsyeshme që të urdhërojë z. Bahtijari të jetë i pranishëm në
24 Gjykatë në seancën e nesërme me 19 dhjetor 2024.

25 Së fundi, duke marrë parasysh parashtrimet që lidhen me

1 marrëveshjet e re për pranimin e fajësisë dhe vendimin e
2 Trupit Gjykses për të vazhduar me diskutimin në seancën e
3 nesërme, Trupi Gjykses e konstaton se është e përshtatshme të
4 riklasifikojë si publike marrëveshjen e re të z. Bahtijari për
5 pranimin e fajësisë. Trupi Gjykses udhëzon Zyrën
6 Administrative të bëjë riklasifikimin e kësaj marrëveshje si
7 publike.

8 Këtu përfundon urdhri i parë gojor.

9 Edhe një herë do të përsëris se mund të flisni atëherë
10 kur tua jap unë fjalën. Dhe fjala ju jipet rregullisht palëve.

11 Urdhri i dytë gojor ka të bëjë me zhdëmtimet.

12 Trupi Gjykses vëren parashtrimet që janë bërë lidhur me
13 zhdëmtimet në marrëveshjet e fajësisë. Në këtë drejtim Trupi
14 Gjykses rikujton se nuk ka një vendim kornizë lidhur me
15 pjesëmarrjen e viktimave që është nxjerrë në këtë çështje për
16 të informuar viktimat potenciale për të drejtat e tyre sipas
17 Ligjit dhe Rregullores.

18 Për të siguruar që të drejtat e cilësdo viktimë të
19 mundshme janë respektuar dhe për të dhënë dhe duke marrë
20 parasysh specificitetin e kësaj çështje, Trupi Gjykses
21 urdhëron si vijon.

22 Si hap i parë, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave duhet të
23 merr deri me -- duhet të merr aktakuzën e 6 dhjetorit dhe
24 vendimin e konfirmimit të datës 2 tetor 2023, si dhe vendimin
25 për konfirmimin e ndryshimeve të aktakuzës të 8 korrikut 2024.

1 Për këtë qëllim urdhëron Zyrën Administrative që këto
2 dokumente t'ia dorëzojë Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave.
3 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave nuk duhet që këtë informacion
4 t'ia nxjerrë asnjë personi, duke qenë se versioni i
5 paredaktuar i aktakuzës së 6 dhjetorit i vendimit të
6 konfirmimit të 2 tetorit 2023, dhe vendimit të konfirmimit të
7 ndryshimeve të aktakuzës të 8 korrikut 2024, bëjnë qartë të
8 ditur se kush mund të jenë viktimat potenciale.

9 Trupi Gjykues urdhëron ZPS-në që këtë ta ndajë me Zyrën e
10 Pjesëmarrjes së Viktimave aq sa është e nevojshme, domethënë,
11 të dhënat e kontaktit të këtyre personave në mënyrë që Zyra e
12 Pjesëmarrjes së Viktimave të mund t'i kontaktojë në kohën e
13 duhur në përputhje me -- në koordinim me Zyrën për Mbrojtjen
14 edhe Mbështetjen e Dëshmitarëve sipas nevojës. Gjithashtu,
15 ZPS-ja duhet t'ia japë Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave çdo
16 informacion apo rekomandim tjetër të nevojshëm në lidhje me
17 sigurinë e parashtruesve të kërkesave në mënyrë që ZPS-ja të
18 mund të ushtrojë funksionet e veta në mënyrë të plotë.

19 Zyra e Pjesëmarrjes duhet të sigurojë menjëherë për sa i
20 përket informimit të këtyre personave në qoftë se do të ketë
21 parashtrues të kërkesave me një përmbledhje të procesit të
22 parashtrimit të kërkesave; numrit të përgjithshëm të kërkesave
23 të marra dhe numrin e kërkesave të parashtruara, numrin e
24 viktimave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, kërkesat e të
25 cilëve janë parashtruar dhe llojet e dokumente të pranuar për

1 vërtetimin e identitetit, të lidhjes familjare dhe kështu me
2 radhë; llojin e dëmit të pretenduar dhe llojin e
3 dokumentacionit të pranuar për vërtetimin e atij dëmi; një
4 përmbledhje të masave mbrojtëse që kërkon kjo zyrë; dhe
5 rekomandimin e masave të tilla.

6 Trupi Gjykues vëren se sipas rregullës 113(6) [Sipas
7 përkthimit] të Rregullores, parashtresit e kërkesave mund të
8 apelojnë vetvetiu vendimin e Trupit Gjykues që hedh poshtë
9 kërkesat e tyre. Këto apele mund të parashtrohen përpara
10 Gjykatës së Apelit brenda 14 ditësh nga vendimi i Trupit
11 Gjykues.

12 Këtu përfundon edhe urdhri i dytë gojor i Trupit Gjykues.

13 Ne do të bëjmë një pushim tani prej 30 minutash për
14 kuvendimet e Trupit Gjykues.

15 --- Pauza fillon në orën 09.49

16 --- Seanca rifillon në orën 10.35

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
18 se erdhët përsëri. Në rregull, atëherë.

19 Trupi Gjykues kuvendoi në çështjen -- për çështjen që
20 kishte ngelur e pazgjidhur dhe do të japim një urdhër me gojë.

21 Pasi shqyrtuam parashttrimet e palëve në lidhje me
22 çështjen e aktakuzës të rishikuar më tej të dorëzuar me 17
23 dhjetor 2024, Trupi Gjykues vendos që të ruajë vendimin që të
24 mos e quajë ose të mos e marrë parasysh këtë aktakuzë për
25 qëllimet e kësaj seance.

1 Trupi Gjykses vëren se tre marrëveshjet për pranimin e
2 fajësisë siç janë tani, i referohen Aktakuzës së Konfirmuar të
3 10 korrikut 2024. Si rezultat i kësaj, Paneli, Trupi Gjykses
4 konstaton se nuk ka asnjë pengesë që të vazhdohet me
5 diskutimin e kushteve të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë
6 mbi këtë bazë. Megjithatë, nëse palët nuk pajtohen për bazën
7 që sapo ja u përshkrova, seanca do të shtyhet dhe Trupi
8 Gjykses do të japë udhëzime të mëtejshme më vonë. Në qoftë se
9 vetëm një nga ekipet e Mbrojtjes do të pajtohet mbi këtë bazë,
10 Trupi Gjykses do të vazhdojë me atë Mbrojtje dhe me atë të
11 akuzuar.

12 Ky është urdhri i Trupit Gjykses.

13 Do të jap fjalën në fillim Mbrojtjes dhe propozoj që ju
14 të flisni edhe me klientët tuaj. Ju japim leje që ta bëni
15 këtë. Dhe së pari, pra, do t'ia jap fjalën ekipeve të
16 Mbrojtjes dhe pastaj Prokurorisë që të japin mendimet e tyre.

17 Z. REES: [Përkthim] A mund të kërkoj një sqarim për një
18 çështje. Në fillim të seancës së sotme, e nderuar Gjykatëse,
19 kur ju parashikuat se çfarë procedure do të ndiqet, ju iu
20 referuat urdhrit F00626 në paragrafin 20, ku ju na kujtuat se
21 Trupi Gjykses do të vazhdojë me secilin prej të akuzuarve dhe
22 do t'i bëjë pyetje që lidhen me rregullën 94(5)(a) dhe (d) dhe
23 shtuat pastaj që do t'i kërkonin atyre të konfirmojnë se si
24 duan të vetëdeklarohen.

25 Në lidhur me aktakuzën e 6 dhjetorit, a e kuptoj drejt që

1 ky urdhër gojor që dhatë tani ju nuk keni ndërmend t'i pyesni
2 të akuzuarit se si duan të vetëdeklarohen në lidhje me
3 aktakuzën e rishikuar dhe të 6 dhjetorit dhe në qoftë se është
4 kështu, a keni ndër mend t'i bëni pyetjet se si duan të
5 vetëdeklarohen në lidhje me paragrafët e caktuar në aktakuzën
6 e amenduar, e ndryshuar të 10 korrikut, apo nuk doni fare t'i
7 bëni këto pyetje?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Rees, a do të preferonte këtë Mbrojtja?

10 Z. REES: [Përkthim] Preferenca e Mbrojtjes është që në
11 qoftë se kjo pyetje do të bëhet, atëhere pyetja të bëhet mbi
12 bazën e aktakuzës së 17 dhjetorit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
14 e qartë. Por, unë e kuptoj që ju do të vazhdoni mbi bazën e
15 marrëveshjeve për pranimin e fajësisë për të cilat keni rënë
16 dakord, mbi atë bazë do të vazhdojmë. Dhe mbi bazën e atyre do
17 të bëhen pyetjet.

18 Z. REES: [Përkthim] Atëhere për sqarim, Trupi Gjykses nuk
19 ka ndërmend t'i pyesi të pandehurit se si duan të
20 vetëdeklarohen në bazë të një aktakuze?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne do
22 t'i bëjmë pyetjet mbi bazën e marrëveshjeve për pranimin e
23 fajësisë që keni dorëzuar. Pyetjet që ju keni, që i përmendët
24 ju tani ne do t'ju bëjmë klientëve tuaj mbi bazën e
25 marrëveshjeve për pranimin e fajësisë që janë dorëzuar nga

1 palët që i referohen aktakuzës të korrikut 2024.

2 I nderuar Mbrojtës, ky Trup Gjykues nuk ka për qëllim që
3 të ndryshojë ndonjë gjë në këtë seancë për sa i përket juve
4 apo ZPS-së.

5 Në qoftë se në paragrafin 5 të marrëveshjes për pranimin
6 e fajësisë që keni bërë, në emër të klientit tuaj, ju i
7 referoheni paragrafëve 8 dhe 9 të aktakuzës, unë do ta
8 përmend. Unë nuk do të përmend paragrafin 19 që ju nuk e keni
9 në marrëveshje.

10 Pra, në qoftë se do t'i referohemi akuzave, Pikës 2 dhe 3
11 të aktakuzës së 10 korrikut 2024 që pastaj në aktakuzën e
12 rishikuar më tej bëhen Pikat 1 dhe 2, pikërisht janë të
13 njëjtat pika. Nuk ndryshon asgjë. Ne nuk do themi --

14 Ne mund të themi Pika 2 dhe Pika 3, po ju duhet ta keni
15 parasysh që bëhet fjalë për Pikën 1 dhe 2 në aktakuzën e
16 rishikuar më tej. Pra, ne nga ana jonë nuk kemi asnjë qëllim
17 që të ndryshojmë ndonjë gjë nga marrëveshja.

18 Z. REES: [Përkthim] Ne atëhere jemi në gjendje të
19 vazhdojmë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
21 jeni në gjendje të vazhdoni atëhere? Në rregull.

22 I jap fjalën Mbrojtësit të z. Shala.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Z. Rees i bëri pyetjet që ishin të
24 cilat kishim paqartësi. Kështu që në qoftë se zoti -- dua të
25 përsëri edhe një herë që në qoftë se z. Shala i bëhet, i bëhen

1 pyetjet siç thatë ju, ne jemi në gjendje të vazhdojmë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
3 Gerry.

4 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Ne jemi në gjendje të vazhdojmë me
5 -- në rastin e z. Bahtijari, por duhet që të lajmërohet ai që
6 do të vijë sot mbasdite sepse ai nuk -- atij nuk i është thënë
7 që duhet të vijë. Nuk kemi bërë parashtime në lidhje me
8 praninë e tij. Dhe në qoftë se vazhdohet kështu ne mund të
9 kemi mundësi që të vazhdojmë me çështjen e tij që sot.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Znj. Prokurore.

13 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Bazuar në propozimin që të
14 vazhdohet mbi bazën e marrëveshjeve të fajësisë edhe ne jemi
15 në gjendje që të vazhdojmë sot me seancat që planifikon Trupi
16 Gjykues.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Atëhere në rregull. Do të vazhdojmë me seancën e parë që
20 ishte planifikuar për sot dhe do të vazhdojmë me klientin
21 tuaj. Për z. Bahtijari do të vazhdojmë nesër, pra diskutimet
22 në lidhje me ju.

23 Atëhere, do të bëjmë një pushim për gjysëm ore dhe do të
24 fillojmë me marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe diskutimin
25 e saj për z. Shala. Prania e ekipeve të tjera të Mbrojtjes,

1 përfshirë edhe klientët e tyre që janë në sallën e gjyqit,
2 pra, të z. Januzi dhe të z. Bahtijari, nuk është e
3 domosdoshme, por në qoftë se dëshirojnë mund të qëndrojnë.

4 Dhe kaq për momentin. Do të shihemi mbas gjysmë ore.

5 Seanca shtyhet për gjysmë ore.

6 --- Pauza fillon në orën 10.46

7 --- Seanca rifillon në orën 11.17

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
9 se erdhët përsëri. Tani do të fillojmë me seancën në lidhje me
10 marrëveshjen për pranimin e fajësisë për z. Shala.

11 Dhe për procesverbalin do t'ia kërkoj edhe një herë që të
12 prezantohen palët dhe do të fillojë me Mbrojtjen e z. Shala.

13 Z. Cadman, keni fjalën. Dhe mund t'i referoheni edhe,
14 mund të thoni që përbërja është e njëjtë.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Përbërja e ekipit të z. Shala është
16 e njëjtë si në mëngjes. Unë jam Toby Cadman. Jam Mbrojtësi i
17 Specializuar; z. John Cubbon është Bashkëmbrojtës; po kështu
18 edhe z. Berisha dhe znj. Kirwan. Z. Shala vetë është i
19 pranishëm.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull.

22 Atëherë të vazhdojmë me Zyrën e Prokurorit të
23 Specializuar.

24 Z. DEVANEY: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam John
25 Devaney, jam Prokuror, Ndihmësprokuror. Dhe anëtarët e tjerë

1 të ekipit të Mbrojtjes [Sipas përkthimit] janë Joshua Hafetz,
2 Line Pederson që është menaxhere e çështjes.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit shumë. Atëherë, kemi edhe dy ekipe të tjera të
5 Mbrojtjes.

6 Z. REES: [Përkthim] Nuk kemi asnjë ndryshim në përbërjen
7 e ekipit të Mbrojtjes nga mëngjesi.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
9 Dr. Gerry.

10 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Ne jemi i njëjti ekip, z.
11 Bahtijari nuk është këtu.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull. E kemi shënuar.

14 Atëherë do të vazhdojmë, por para se të fillojmë dëshiroj
15 t'i kërkoj Sekretares së Gjykatës t'i japi z. Shala kopjen në
16 anglisht dhe në shqipe të marrëveshjes për pranimin e fajësisë
17 me ZPS-në, që është parashtrimi i protokolluar 618, Shtojca 1,
18 si dhe kopje në shqip dhe në anglisht të aktakuzës së 10
19 korrikut 2024, sepse kjo do të na ndihmojë me pyetjet e
20 ardhshme. Po kështu, a mund të na shfaqen edhe në ekran këto
21 dokumente? Faleminderit.

22 Për procesverbalin, vërej se marrëveshja për pranimin e
23 fajësisë u bë midis z. Shala dhe ZPS-së më 4 dhjetor 2024, dhe
24 se Mbrojtësi i Specializuar i të akuzuarit është Toby Cadman.

25 Mbrojtës, a mund ta konfirmoni këtë?

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Konfirmoj.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
3 Faleminderit.

4 Z. Shala, përpara se të filloj -- mund të qëndroni i
5 ulur. Para se të fillojmë, do t'ju referoj tek dokumenti që
6 quhet "Marrëveshje për pranimin e fajësisë" që i është
7 dorëzuar Trupit Gjygues si shtojcë e parashtimit 618, dhe që
8 ju dha një kopje tani Sekretarja e Gjykatës. Dhe, dua që të
9 shkoni në faqen 10. Ju lutem, shihni faqen 10. Aty shikoni,
10 numrat janë vënë në qoshe të sipërme të faqes, në të majtë.

11 Sekretare, ju lutem, a mund ta ndihmoni z. Shala që ta
12 gjejë.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Numri i faqeve në shqip, në gjuhën
14 shqipe është ndryshe nga ai në versionin në anglishte.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
16 dëshiroj që të shoh njëherë versionin në anglisht, vetëm dua
17 të verifikoj që është nënshkrimi i tij.

18 Pra, për fjalë -- e kemi fjalën për parashtimin 618,
19 Shtojca 1, në faqen 10. Në të majtë, a është nënshkrimi juaj,
20 z. Shala, aty?

21 I AKUZUARI SHALA: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
23 lutem, ndiz --

24 I AKUZUARI SHALA: Po, nënshkrimi im është.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Atëherë shkoni në faqen 22 të të njëjtit dokument. Në
2 të majtë sipër, në pjesën e sipërme të faqes, është nënshkrimi
3 juaj aty, në faqen 22?

4 I AKUZUARI SHALA: Yes. Po, nënshkrimi im është.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit.

7 Faleminderit, Sekretare, për ndihmën tuaj.

8 Shikoj Prokuroren që është çuar në këmbë. Prokurore, keni
9 fjalën.

10 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Desha të di përveç dy
11 nënshkrimeve që konfirmoi z. Shala, në faqen 10 të dokumentit
12 në paragrafin 26, dhe në faqen 21 të dokumentit, diku në
13 paragrafin 24, që vazhdon nga një faqe më para, janë edhe dy
14 nënshkrime të tjera. Nuk e di nëse doni të konfirmoni dhe ato
15 nënshkrime.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit. Prokurore, besoj që është e dobishme që t'i
18 konfirmojmë.

19 Atëherë, ju lutem, edhe njëherë, Sekretare, na ndihmoni
20 që t'i gjejme, të ndihmoni z. Shala t'i gjejë.

21 Z. Shala, ju lutem, shkoni në faqen 10, në fund të faqes.

22 A është nënshkrimi juaj dhe aty?

23 I AKUZUARI SHALA: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit. Dhe në faqen 21 tani të të njëjtit dokument,

1 diku në mes të faqes. Në të majtë.

2 I AKUZUARI SHALA: Po, nënshkrimi im.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
4 faleminderit të dyve.

5 I lutem Mbrojtësit, në të njëjtat faqe që sapo i
6 përmenda, në faqen 10 pra, dhe në faqen 11, a mund të
7 konfirmoni që janë nënshkrimet tuaja në të dy faqet?

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Atëherë, e njëjta gjë edhe për faqet 21 dhe 22.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit. Atëherë këtë e kryem.

14 Z. Shala, do t'ju drejtohem ju disa herë gjatë kësaj
15 seance që të përgjigjeni disa pyetjeve. Z. Shala, siç e dini,
16 dhe besoj e di dhe Avokati, Trupi Gjygues mund të miratojë
17 marrëveshjen e fajësisë që është bërë midis ju dhe Avokatit
18 tuaj dhe ZPS-së. Në qoftë se bindet që janë plotësuar kushtet.
19 Kjo është ajo që kërkon Rregulla 94(5) e rregullores. Për këtë
20 arsye, do të vazhdoj dhe do t'ju bëj disa pyetje me qëllim që
21 të verifikoj që janë përmbushur kushtet e Rregullës 94(5). A e
22 kuptoni këtë?

23 I AKUZUARI SHALA: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit.

1 Do të filloj me Rregullën 94, rregulla -- pika (5). Në
2 marrëveshjen e pranimin të fajësisë që keni nënshkruar thuhet
3 se ju keni diskutuar kushtet e marrëveshjen për pranimin e
4 fajësisë me Avokatin tuaj dhe se keni bërë marrëveshjen pas
5 konsultimeve të mjaftueshme me të. Për këtë i referohem
6 paragrafëve 19 dhe 24, dhe 25 të marrëveshjes.

7 Z. Shala, mund të konfirmoni që kështu ka qenë?

8 I AKUZUARI SHALA: Po, e vërtetë është. Për gjithçka jemi
9 konsultuar me Avokatin dhe jemi ra dakord për këtë
10 marrëveshje.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Shala, kjo seancë do të zgjasë pak, kështu që -- ju mund të
13 qëndroni tërë kohën i ulur, vetëm në një moment kur do t'ju
14 kërkoj që të ndryshoni vetëdeklarimin, vetëm atëherë do t'ju
15 kërkoj të ngriheni në këmbë. Por nëse doni, domethënë, gjatë
16 gjithë seancës, mund të qëndroni i ulur përndryshe.

17 I AKUZUARI SHALA: Faleminderit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Atëherë, i kthehem Rregullës 94(5), (b) dhe (c). Në këtë
20 kontekst, unë do të kaloj kushtet dhe termat e marrëveshjes së
21 pranimin të fajësisë në mënyrë që t'i mundësoj Trupit Gjykes
22 që të kuptojë se ju i keni kuptuar kushtet e marrëveshjes dhe
23 nga ana tjetër gjithashtu pajtoheni me ato kushte.

24 Z. Shala, a konfirmoni që i keni parë me shumë kujdes me
25 gjithë avokatin tuaj çdo pjesë të marrëveshjes në një gjuhë që

1 ju e kuptoni dhe se i kuptoni kushtet e kësaj marrëveshjeje
2 siç janë specifikuar në paragrafin 24 të kësaj marrëveshjeje?

3 I AKUZUARI SHALA: Po. E kam kuptu, sepse kanë qenë edhe
4 në gjuhën time marrëveshja.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull. Tani do të kaloj në mënyrë më konkrete tek Rregulla
7 94(5)(c) që ka të bëjë me faktet e pranuar nga ju, z. Shala,
8 mbi të cilat mbështeten akuzat që janë pjesë e marrëveshjes
9 për pranimin e fajësisë. Do të filloj me Shtojcën 1 të
10 marrëveshjes për pranimin e fajësisë për juve që përmban fakte
11 -- Bazën Faktike mbi të cilën është rënë dakord.

12 Në këtë Bazë Faktike mbi të cilën është rënë dakord,
13 faqja 12 e parashtimit të protokolluar 618, Shtojca 1, ju
14 jeni, keni rënë dakord për pikat në vijim, dhe do ta lexoj me
15 zë të lartë për juve. Pastaj do t'ju pyes të konfirmoni nëse
16 është kështu apo jo.

17 I pandehuri -- dhe për juve është faqja 23 e marrëveshjes
18 për pranimin e fajësisë që ju është dhënë, nëse dëshironi ta
19 ndiqni duke e lexuar këtë pjesë.

20 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja e Gjykatës
21 këshillohen]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
23 nevoja të procesverbalit, Baza Faktike mbi të cilën është rënë
24 dakord është në anglisht faqja 12 dhe në versionin shqip është
25 faqja 23.

1 A e keni përpara jush, z. Shala, e gjetët? Akoma jo?

2 I AKUZUARI SHALA: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Shala, fikeni mikrofonin, ju lutem. Dhe, z. Shala, kur keni
5 nevojë t'i drejtoheni Trupit Gjykses, ju lutem, ndizeni
6 mikrofonin, se përndryshe nuk na vjen përkthimi neve. A jeni
7 dakord me këtë?

8 I AKUZUARI SHALA: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
10 që thashë pak më parë pra, duhet të ndizni mikrofonin që t'ju
11 dëgjoj.

12 I AKUZUARI SHALA: Patjetër. Harroj nganjëherë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
14 kuptoj. Por më intereson shumë të dëgjoj atë që keni për të
15 thënë.

16 Në rregull. Tani do të lexoj atë mbi të cilën jeni marrë
17 vesh me, pra keni rënë dakord juve me Zyrën e Prokurorit të
18 Specializuar.

19 "I pandehuri Haxhi Shala pranon se ai ishte pjesë e një
20 grupi që kërkonte të nxiste Dëshmitarin 1 që të mos jepte
21 dëshmi para Dhomave të Specializuara të Kosovës përmes
22 premtimit për përfitim. Në veçanti, anëtarët e grupit, duke
23 vepruar nën drejtimin e të pandehurit Haxhi Shala, i shkuan
24 Dëshmitarit 1 në shtëpinë e tij, përkatësisht më 5 dhe 12
25 prill 2023. Gjatë vizitës së 5 prillit 2023, Ismet Bahtijari i

1 tha Dëshmitarit 1 se ai duhet të tërhiqte dëshminë e tij para
2 Dhomave të Specializuara të Kosovës. Gjatë vizitës së 12
3 prillit 2023, Sabit Januzi në vijim të vizitës së parë i
4 transmetoi Dëshmitarit 1 një ofertë që i pandehuri Haxhi Shala
5 dhe të tjerët do ta ndihmonin atë nëse ai e tërhiqte dëshminë
6 e tij. Para dhe pas çdo vizite më 5 dhe 12 prill 2023, i
7 pandehuri Haxhi Shala komunikoi dhe koordinoi me anëtarët e
8 tjerë të grupit për ndërveprimet e tyre me Dëshmitarin 1.”

9 Z. Shala, a e konfirmoni marrëveshjen tuaj, pranimin,
10 lidhur me Bazën Faktike mbi të cilën është rënë dakord dhe të
11 cilën sapo jua lexova?

12 I AKUZUARI SHALA: Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit. Tani do të vazhdoj dhe do lexoj sepse paragrafi
15 5 i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, u referohet atyre,
16 paragrafët 8, 9, 10 [Sipas përkthimit] 14, deri në 18, dhe
17 24(i), pika (i) dhe (ii) dhe (iii), të Aktakuzës së Konfirmuar
18 të datës 10 korrik 2024, e cila, të cilët i referohet në
19 marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

20 Pastaj, për lehtësim të të kuptuarit dhe të përcjelljes,
21 z. Shala, dokumenti me numrin 379, do të filloj duke lexuar
22 paragrafin 8. Z. Shala, e keni përpara jush paragrafin 8?

23 I AKUZUARI SHALA: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 rregull. Tani do ta lexoj. Është kjo pjesa më e rëndësishme.

1 Uroj që t'ju ndihmojë, që të jeni në gjendje ta ndiqni dhe
2 lexoni edhe ju.

3 Paragrafi 8 i Aktakuzës së Konfirmuar të datës 8, i datës
4 10 korrik 2024, përmban si në vijim:

5 "Më datën 5 prill 2023, Shala, i quajtur -- thirri
6 Januzin dhe Bahtijari edhe ai e thirri në telefon z. Januzi."

7 Pastaj kalojmë në paragrafin 9:

8 "Pastaj, pas thirrjes telefonike dhe verifikimit të
9 konfirmimit se Dëshmitari 1 ishte në shtëpi, Bahtijari shkoi
10 tek shtëpia e Dëshmitarit 1. Bahtijari i tha Dëshmitarit 1 se
11 Shala e kishte kontaktuar kohët e fundit dhe i kishte dërgu, i
12 kishte kërkuar që t'i thoshte Dëshmitarit 1 se duhej të
13 tërhiqte dëshminë."

14 Pastaj kalojmë tek paragrafi 11:

15 "Bahtijari u largua nga shtëpia e Dëshmitarit 1 dhe eci
16 drejt një veture aty afër në të cilën po prisnin dy meshkuj,
17 dhe një person i tretë në ulësen e shoferit."

18 Pastaj kalojmë në paragrafin, në paragrafët 14 deri në
19 18. Vazhdoni të më ndiqni, z. Shala, në rregull? E shoh që
20 pohuat me kokë. Tani paragrafi 14:

21 "Gjatë ditëve në vijim, Shala dhe Januzi, ndër të tjerë,
22 mbetën në kontakt, dhe u lidhën përmes telefonit së paku 4
23 herë midis 6 prillit dhe 9 prillit 2023.

24 "Më datë 12 prill pak pasi i kishte telefonuar Shalës,
25 jemi në paragrafin 15, "Januzi shkoi në shtëpinë e Dëshmitarit

1 1. Në shtëpinë e Dëshmitarit 1, Januzi i tha dëshmitarit 1 se
2 Shala i kishte kërkuar atij të vinte aty në vijim të vizitës
3 së Bahtijarit për të mësuar se çfarë planifikonte të bënte
4 Dëshmitari 1 dhe si mund të zgjidhej çështja e dëshmisë së
5 tij.”

6 Pastaj kalojmë në paragrafin 16:

7 “Konkretisht, Januzi i tha Dëshmitarit 1 se Shala i
8 kishte kërkuar Januzit që të përcillte mesazhin se nëse
9 Dëshmitari 1 do të tërhiqte dëshminë, Shala dhe persona të
10 tjerë të papërmendur me emra, do t’i ofronin ndihmë.
11 Dëshmitari 1 u përgjigj se në qoftë se Shala dhe ose të tjerët
12 do t’i jepnin atij 200.000 euro, do të arrihej ujdia.

13 “Dëshmitari 1 nuk konfirmoi apo mohoi se ishte dëshmitar.
14 Januzi tha që do t’u tregonte ‘atyre’ se çfarë kishte thënë
15 Dëshmitari 1.”

16 Kalojmë në paragrafin 18. Sapo lexova paragrafin 17.

17 “Pak pas vizitës së 12 prillit 2023 që i bëri Dëshmitarit
18 1, Januzi i telefoni sërish Shalës.”

19 Kalojmë në paragrafin 24 tani, pika (i):

20 “Më 5 prill 2023, me udhëzim të Shalës, Bahtijari
21 kontaktoi Dëshmitarin 1 dhe i tha atij se Dëshmitari 1, pra,
22 duhej të tërhiqte dëshminë në proceset e DHSK-së.”

23 Tani vazhdojmë me pikën (ii) të të njëjtit paragraf.

24 “Më 12 prill 2023, me udhëzim të Shalës, Januzi kontaktoi
25 Dëshmitarin 1, në vijim të kontaktit të mëhershëm të

1 Bahtijarit, për t'i komunikuar Dëshmitarit ofertën se Shala
2 dhe persona të tjerë të papërmendur me emra, do ta ndihmonin
3 Dëshmitarin 1 nëse ai pranonte të tërhiqte dëshminë e tij."

4 Tani paragrafi i fundit që do të lexoj. Pjesë për të
5 cilat keni rënë dakord sipas paragrafit 5 të marrëveshjen për
6 pranimin e fajësisë, (iii):

7 "Para dhe pas kontakteve të tyre me Dëshmitarin 1, Januzi
8 dhe dëshmitari komunikuan dhe bashkërenduan me njëri-tjetrin
9 dhe me Shalën."

10 Kjo ishte përmbajtja e paragrafëve në aktakuzën e
11 konfirmuar të datës 10 korrik 2024, siç përmendet në
12 paragrafin 5 të marrëveshjen për pranimin e fajësisë mes jush
13 dhe ZPS-së.

14 Tani do të kaloj tek paragrafi 5 i marrëveshjes për
15 pranimin e fajësisë, i cili lexon si në vijim:

16 "Haxhi Shala dhe Prokuroria", kjo është ajo që thoni në
17 paragrafin 5 në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pra.
18 Duhet të presim pak që të sigurohemi që z. Shala ka gjetur
19 paragrafin dhe mund ta lexojë, paragrafi 5. A e keni përpara
20 jush?

21 Në rregull atëherë, do tua lexoj me zë të lartë, z.
22 Shala, dhe pastaj do t'ju bëj një pyetje.

23 "Haxhi Shala dhe Prokuroria pajtohen që nëse Prokurori do
24 të bënte paraqitjen e provave, atëherë faktet dhe akuzat e
25 përcaktuara në paragrafët", të cilët sapo jua lexova, "8, 9,

1 11, 14-18, dhe 24 (nënparagrafët (i), (ii) dhe (iii) të
2 Aktakuzës së datës 10 korrik 2024, do të vërtetoheshin jashtë
3 dyshimit të arsyeshëm dhe se ato fakte janë të vërteta dhe të
4 sakta dhe nuk kundërshtohen nga Haxhi Shala.”

5 Z. Shala, e konfirmoni marrëveshjen tuaj me këtë
6 deklaratë që sapo ua lexova?

7 I AKUZUARI SHALA: Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit. Konstatohet kjo.

10 Faleminderit, znj. Punonjëse e Gjykatës për ndihmën. Do
11 t’ju kërkoja të vazhdonit të qëndroni pak më gjatë aty në
12 qoftë se ka nevojë z. Shala për ndihmën tuaj.

13 Tani do të diskutoj me juve, z. Shala, llojin, natyrën e
14 akuzave.

15 Z. Shala, Trupi Gjykes dëshiron të sigurohet që ju jeni
16 plotësisht i vetëdijshëm për akuzat që përmban marrëveshja për
17 pranimin e fajësisë dhe për këtë do t’ju lexoj paragrafët 3, 8
18 dhe 9 të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. E keni përpara
19 jush? Është parashtrimi i protokolluar 618, paragrafi 3.

20 I AKUZUARI SHALA: Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Paragrafi 3 lexon si në vijim.

23 “Haxhi Shala bie dakord të pranojë fajin para Trupit
24 Gjykes në përputhje me Rregullën 94 të Rregullores në lidhje
25 me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës, të datës 10 korrik

1 2024, në masën që ata pretendojnë, në Pikën Dy (2), pengim të
2 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare duke marrë
3 pjesë në aksionin e përbashkët të një grupi, midis më së paku
4 5 prillit dhe 12 prillit 2023, që -- e dënueshme sipas Kodit
5 Penal të Kosovës (KPK) Neni 17, 21, 28, 33, 35 dhe 401(2) dhe
6 (5), dhe Neni 15(2), dhe 16(3) i Ligjit mbi Dhomat e
7 Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar", më tej
8 i përmendur si "Ligji". "Dhe Pika Tre (tre), frikësim gjatë
9 procedurave penale me anë të premtimit për dhuratë ose çfarëdo
10 forme tjetër përfitimi midis më së paku datës 5 dhe 12 prill
11 2023, e dënueshme nën ligjin penal të, Nenin 17, 21, 31, 33,
12 35, i Kodit Penal të Kosovës, dhe Nenin 387, dhe Nenet 15(2)
13 dhe 16(3) i Ligjit, përfshirë të gjitha mënyrat e
14 përgjegjësisë të pretenduara në të."

15 Tani do të vijoj me paragrafin 8, z. Shala. Duhet të
16 lexoj shumë gjëra dhe ju duhet të dëgjoni shumë. Por duhet të
17 sigurohem që ju jeni i mirinformuar dhe keni kuptuar të
18 gjitha.

19 Paragrafi 8 lexon si në vijim.

20 "Haxhi Shala kupton plotësisht se ai po e pranon fajësinë
21 lidhur me, në lidhje me Pikat Dy (2) dhe (3) të Aktakuzës", e
22 datës 10 korrik 2024, "dhe konkretisht pranon sjelljen e tij
23 të përcaktuar në paragrafët 8, 9, 11, 14-18, dhe 24 (nën
24 paragrafët (i), (ii) dhe (iii) të Aktakuzës, dhe siç
25 përshkruhet më tej në Bazat Faktike të rëna dakord".

1 Pastaj paragrafi 9:

2 "Haxhi Shala kupton se nëse do të zhvillohej një gjykim,
3 Prokurorisë do t'i kërkohej të provonte elementet e mëposhtme
4 të neneve 21, 387, dhe 401(2) dhe (5) jashtë dyshimit të
5 arsyeshëm."

6 Tani do të rendis elementet e ndryshëm të akuzave.

7 "Pika Dy (2),

8 "Pjesëmarrja në një grup i cili përmes veprimit të
9 përbashkët" Neni 401(2) i Kodit Penal të Kosovës.

10 "Pengon ose tenton të pengojë një person zyrtar në
11 kryerjen e detyrave zyrtare", referenca është e të njëjtit
12 artikull.

13 "Vepra penale është kryer ndaj një gjyqtari, prokurori,
14 zyrtari të gjykatës, ose zyrtari të prokurorisë, dhe ndaj një
15 personi, ose ndaj një personi të autorizuar nga gjykata dhe
16 prokuroria ose ndaj një oficeri policie, gjatë kryerjes së
17 detyrave të tyre zyrtare." Dhe këtu Neni është 401(5) i Kodit
18 Penal të Kosovës.

19 Dhe së fundmi:

20 "Vetëdija dhe dëshira për të kryer aktin ose vetëdija si
21 një pasojë e ndaluar mund të ndodhë si rezultat i veprimit ose
22 mosveprimit dhe bashkimit në ndodhjen e tij", neni përkatës
23 përmendet.

24 Pastaj Pika Tre (3), dhe këtu do të rendis elementët që
25 Prokuroria do t'u duhej të vetëtonte përtej dyshimit të

1 arsyeshëm:

2 "Përdorimi i forcës ose kërcënimit të rëndë ose ndonjë
3 mënyre tjetër të detyrimit, premtimi për dhuratë ose ndonjë
4 forme tjetër përfitimi", Neni 387 i Kodit Penal të Kosovës.

5 "Nxitja e një personi tjetër që të mos jepte deklaratë
6 ose te jepte deklaratë të rreme, ose të mos i jepte
7 informacion të vërtetë policisë, prokurorit ose gjykatësit,
8 dhe ky informacion ka të bëjë me pengimin e procedurës
9 penale."

10 Neni 387 i Kodit Penal të Kosovës.

11 Dhe së fundi:

12 "Vetëdija dhe dëshira për të kryer, aktin ose vetëdija si
13 një pasojë e ndaluar mund të ndodhë si rezultat i veprimit ose
14 mosveprimit dhe bashkimit në ndodhjen e tij", Neni 21 i Kodit
15 Penal të Kosovës.

16 Z. Shala, tani që ju lexova këto tre paragrafë, a mund të
17 konfirmoni se jeni pajtuar, keni rënë dakord për tre pikat e
18 akuzës që lart, të lartpërmendura?

19 I AKUZUARI SHALA: Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Tani sa i takon pranimit të fajësisë do të lexoj
23 paragrafët 3 dhe 7 të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

24 Paragrafi 3, ky paragraf është lexuar dhe më herët në
25 kontekstin e natyrës së akuzave. Por është relevante dhe në

1 këtë kontekst. Pra, z. Shala, përsëri do t'ju lexoj paragrafin
2 3, por është e rëndësishme në kuadër të pyetjes që do t'ju bëj
3 pastaj.

4 "Haxhi Shala", paragrafi 3, "bie dakord të pranojë fajin
5 para Trupit Gjykues në përputhje me Rregullën 94, të
6 rregullores në lidhje me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të
7 aktakuzës, të datës 10 korrik 2024. Në masën që ata
8 pretendojnë në Pikën Dy (2), pengim të personave zyrtarë në
9 kryerjen e detyrave zyrtare, duke marrë pjesë në aksionin e
10 përbashkët të një grupi midis më së paku 5 prillit dhe 12
11 prillit 2023, e dënueshme sipas Kodit Penal të Kosovës, KPK,
12 pra, Nenit 17, 21, 28, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5), dhe Nenit
13 15(2), 16(3) të Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës
14 dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji, dhe në Pikën
15 Tre (3)", keni pranuar që të deklaroheni fajtor, pra për
16 "frikësim gjatë procedurave penale me anë të, përmes, ose
17 forme tjetër përfitimi, dhe së paku datë 5 prill, 12 prill
18 2023, e dënueshme sipas Neneve 17, 21, 31, 33, 35, dhe 387, të
19 KPK-së, dhe Neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit, duke përfshirë
20 të gjitha mënyrat e përgjegjësisë të pretenduara në të.

21 Z. Shala, a konfirmoni se keni rënë dakord mbi këtë pikë?

22 I AKUZUARI SHALA: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] U
24 konstatua, faleminderit.

25 Pastaj, paragrafi 7. E keni përpara jush? Po.

1 I AKUZUARI SHALA: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
3 është versioni në anglisht, në rregull.

4 "Haxhi Shala bie dakord të pranojë fajësinë në lidhje me
5 akuzat e identifikuara në paragrafin 3 më lart sepse ai në
6 fakt është fajtor dhe pranon fajin e tij dhe pranon
7 përgjegjësinë e plotë për sjelljen e tij, siç përshkruhet në
8 bazën faktike të rënë dakord."

9 Z. Shala, e konfirmoni marrëveshjen tuaj, pranimin, pra
10 rënien dakord lidhur me këtë pikë?

11 I AKUZUARI SHALA: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Tani do t'ju -- më vonë, do t'ju kërkohet që të
15 deklaroheni lidhur me fajësinë tuaj në mënyrë formale.
16 Vazhdojmë të diskutojmë, pra, kushtet e marrëveshjes për
17 pranimin e fajësisë. Kalojmë tek dënimi.

18 Z. Shala, po ju lexoj në paragrafin 11 të marrëveshjes
19 për pranimin e fajësisë se ju keni rënë dakord për caktimin e
20 një dënimi prej tre vitesh burgim. Dhe marrëveshja për
21 pranimin e fajësisë në të thuhet që në shkëmbim të pranimit të
22 fajit nga ju, ZPS-ja do t'ia rekomandojë Trupit Gjykes prej
23 tre vitesh burg dhe rekomandon që z. Shala t'i llogaritet koha
24 e kaluar në paraburgim të DHSK-së. Dhe sipas paragrafit 16(c)
25 të marrëveshjes, marrëveshja për pranimin e fajësisë, ZPS-ja

1 pajtohet të tërheqë Pikën Një (1) të akuzave.

2 E konfirmoni këtë z. Shala?

3 I AKUZUARI SHALA: Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Tani do kaloj te paragrafi 12 i marrëveshjes për pranimin
7 e fajësisë që ka të bëjë me mjetin ligjor juridik si koment
8 paraparak. Kujtoj se ZPS-ja ka tërhequr kërkesën e tyre për
9 rishqyrtim dhe lejëkërkesën për të bërë apel ndaj vendimit,
10 pra, 612 që është për parashtrimin e protokolluar 631 i datës
11 16 dhjetor 2024. Si rezultat i kësaj, paragrafi 12 i
12 marrëveshjes për pranimin e fajësisë do të ndryshohet për t'iu
13 përshtatur vendimit 612, dhe Trupi Gjykes do t'i nxjerrë
14 urdhrin përkatës në kohë. Megjithatë, dëshiroj t'ju, të
15 sigurohem që ju kuptoni ndikimin që kjo ka në marrëveshjen mbi
16 pranimin e fajësisë dhe që ju jeni dakord me këtë ndryshim,
17 natyrisht mund të konsultoheni dhe të konfirmoni me Avokatin
18 tuaj përpara se të përgjigjeni.

19 Së pari do të lexoj, z. Avokat, do ta lexoj fillimisht,
20 dhe pastaj do t'ju jap mundësinë ta konfirmoni dhe pastaj do
21 presim përgjigjen e z. Shala.

22 Z. Shala -- a e kuptoni dhe a pajtoheni që nëse Trupi
23 Gjykes aprovon, miraton, marrëveshjen për pranimin e fajësisë
24 dhe cakton një dënim që është në përputhje me këtë
25 marrëveshje, pra, për pranimin e fajësisë, juve ju hiqet e

1 drejta që të bëni apel ndaj këtyre vendimeve?

2 Më lejoni ta përfundoj pastaj do t'ju jap fjalën.

3 Pra, pika e dytë, ju nuk do të mund të tërhiqni pranimin
4 e fajit apo dënimin sipas pranimit të fajit.

5 Do të doja të konfirmoj, do t'ju kërkoja juve që të
6 konfirmoni që ju kuptoni dhe jeni dakord me dy pikat e
7 lartpërmendura, natyrisht mund të konsultoheni me Avokatin
8 tuaj përpara se të jepni përgjigje.

9 z. Cadman, a dëshironi të konsultoheni me klientin tuaj
10 paraprakisht? Po ju jap këtë mundësi.

11 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

13 Z. Shala është gati t'i përgjigjet pyetjes suaj.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit, z. Avokat.

16 Z. Shala, do të doja që të konfirmoni që ju kuptoni dhe
17 jeni dakord me dy pikat që ua lexova më herët. Fjalën e keni
18 ju.

19 I AKUZUARI SHALA: Po, e nderuar. Kam kuptuar edhe
20 pajtohena me ato që jemi marrë vesh me Avokatin, dhe Avokati
21 me Prokurorin. Në qoftë se dënimi është mbi tri vite, unë do
22 ta apeloj. Në qoftë se është tri vite e poshtë, jo.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Nuk ka
24 përkthim].

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Nuk ka përkthim].

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
2 Marrëveshja, siç është -- siç e lexova më herët në paragrafin
3 11, dhe do ta lexoj edhe njëherë siç është shkruar këtu.

4 Ishte përkthyesi në kanal in anglisht, tani është në
5 gjuhën shqipe.

6 Do t'ju përsëris, pra, z. Avokat, marrëveshjen në,
7 marrëveshja për pranimin e fajësisë është që z. Shala pajtohet
8 për një dënim tre vite burg. Nëse ka ndonjë keqkuptim lidhur
9 me këtë, konfirmojeni me klientin tuaj, sepse dëgjova diçka
10 për dy vite.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Ndoshta mund ta spjegoj. Ajo që z.
12 Shala po përpigëj të konfirmonte është se në qoftë se është
13 një dënim deri në tre vite, është diçka për të cilën është
14 rënë dakord, sepse ky ishte dënimi për të cilin -- pra ai nuk
15 po thonte që ka ndonjë ndryshim në marrëveshjen për pranimin e
16 fajësisë, por natyrisht çdo dënim nuk do të bëhej apel ndaj
17 ndonjë dënimi që shkon deri në 3 vite.

18 Pra nuk ka keqkuptim, në qoftë se dy vite, dy vite e
19 gjysmë, ose tre vite, ai humb të drejtën për të bërë apel ndaj
20 këtij vendimi.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
22 rregull. A është e qartë kjo dhe nga ana e Prokurorisë?

23 Z. DEVANEY: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Atëherë, do të vazhdojmë.

1 Nga ana e ZPS-së, vë në dukje paragrafin 16 të
2 marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

3 Faleminderit, znj. Sekretare.

4 Të njëjtat komente paraprake që i lexova në lidhje me
5 tërheqjen e kërkesës për rishikim të vendimit dhe për leje për
6 apel, vlen edhe për paragrafin 16(6) të marrëveshjes për
7 pranimin e fajësisë ku përmendet ajo mundësi e apelit, apo e
8 rishikimit. Në rregull.

9 Atëherë, do të vazhdojmë me pikën në vijim, z. Shala.
10 Sipas Rregullës 94(5)(c), Trupi Gjykses duhet të bindet se ju
11 e keni bërë marrëveshjen për pranimin e fajësisë me vullnet të
12 lirë, z. Shala.

13 Vërej se në paragrafin 24 të marrëveshjes për pranimin e
14 fajësisë, thoni -- dhe mund vetëm të dëgjoni, në qoftë se doni
15 dhe ta ndiqni me shkrim do t'ju jap referencën. Është
16 paragrafi 24, faqja 20, 21.

17 A e keni përpara, z. Shala? E shoh që bëtë "po" me kokë.

18 I AKUZUARI SHALA: Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
20 thoni se askush nuk më ka detyruar që të bëj këtë marrëveshje,
21 dhe thoni se "këtë marrëveshje për pranimin e fajësisë e bëj
22 me vullnet të lirë". Edhe Avokati juaj në paragrafin 19 thotë
23 se "keni hyrë në marrëveshjen për pranimin e fajësisë me
24 vullnet të lirë sepse nuk janë bërë kurrfarë kërcënimesh" dhe
25 se të vetmet premtime që ju janë bërë janë ato të përcaktuara

1 në këtë marrëveshje.”

2 Z. Shala, a mund t’i konfirmoni Trupit Gjykses se jeni
3 pajtuar me këtë marrëveshje për pranimin e fajësisë, në mënyrë
4 vullnetare, pa kurrfarë kërcënimi apo shtrëngimi?

5 I AKUZUARI SHALA: Po, znj. Gjyqtare. Me vullnetin tim
6 është bërë gjithçka.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe e
8 keni të qartë dhe e keni kuptuar atë që porsa ja lexova?

9 I AKUZUARI SHALA: Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Tani do të kalojmë tek pika në vijim. Trupi Gjykses
13 dëshiron të konfirmojë se ju, z. Shala, i kuptoni pasojat e
14 marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në qoftë se është ashtu,
15 dhe se ju hiqni dorë nga e drejta për t’u gjykuar me gjykim të
16 rregullt sikurse parashikohet në Rregullën 94(5)(d) të
17 rregullores, me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

18 Dhe në lidhje me këtë pikë, z Shala, ka disa hapa dhe do
19 t’i kalojmë së bashku një nga një.

20 Së pari, dua që t’ua lexoj paragrafin 17 prej pikës (a)
21 deri në pikën (f) dhe paragrafin 18(a) dhe (b) të marrëveshjes
22 për pranimin e fajësisë. Do t’ju jap pak kohë që t’i gjeni ato
23 dy paragrafë në parashtrimin 618. A i keni përpara, z. Shala?

24 I AKUZUARI SHALA: Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

1 mirë. Këta paragrafë përmbledhin të drejtat që prej të cilat
2 ju hiqni dorë dhe të drejtat të cilat ende i gëzoni në bazë të
3 marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Dhe së pari, z. Shala,
4 do t'ju lexoj se cilat të drejta, prej të cilave të drejta,
5 hiqni dorë pjesërisht ose plotësisht me anë të kësaj
6 marrëveshjeje dhe ato të drejta janë -- ju hiqni dorë
7 plotësisht apo pjesërisht nga këto të drejta, paragrafi 17:

8 Nën (a), hiqni dorë nga e drejta për t'u deklaruar i
9 pafajshëm dhe për të kërkuar nga Prokuroria që të provojë,
10 vërtetojë akuzat në aktakuzë jashtë dyshimit të arsyeshëm në
11 një gjykim publik të drejtë dhe të paanshëm;

12 E drejta për t'u gjykuar në prani tuajën dhe për t'u
13 mbrojtur nga një Mbrojtës i Specializuar në një gjykim të
14 tillë;

15 E drejta për të ngritur mbrojtje dhe arsye për
16 përjashtimin e përgjegjësisë penale dhe për të paraqitur prova
17 të pranueshme në një gjykim të tillë, pa paragjykuar ushtrimin
18 e të drejtës për të bërë parashtrime dhe për të paraqitur
19 prova në lidhje me dënimin.

20 E drejta që të mos detyroheni të dëshmoni kundër vetes
21 ose të pranoni fajësinë;

22 Dhe e drejta për të marrë në pyetje ose të merren në
23 pyetje në emrin tuaj dëshmitarët kundër jush dhe për të
24 siguruar pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të tyre në emrin
25 tuaj, dhe të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër jush pa

1 paragjykuar të drejtën tuaj për të marrë në pyetje çdo
2 dëshmitar që mund të nxirret për të dëshmuar, dhe të drejtën
3 për të thirrur dëshmitarë dhe për t'i marrë ata në pyetje në
4 emrin tuaj në çdo procedurë lidhur me dënimin, si edhe e
5 drejta për të ndjekur mjetet juridike të apelit lidhur me
6 vendimin e fajësisë apo përcaktimin e dënimit siç është
7 specifikuar në paragrafin 12 që posa e lexova.

8 Z. Shala, a mund të konfirmoni në qoftë se e keni kuptuar
9 këtë dhe se hiqni dorë prej këtyre të drejtave?

10 I AKUZUARI SHALA: Po, e kam kuptuar gjithçka.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
12 kjo nuk mjafton, z. Shala. Domethënë, është në rregull që
13 thoni se i kuptoni, por është me rëndësi që të, dhe të
14 deklaroheni se hiqni ose nuk hiqni dorë prej këtyre të
15 drejtave.

16 I AKUZUARI SHALA: Po, heqi dorë nga këto të drejta, në
17 qoftë se respektohet marrëveshja.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
19 di se çfarë do të thotë kjo. Unë i lexova të drejtat dhe dua
20 të dëgjoj nga klienti juaj se heq dorë prej tyre, nuk e di se
21 çfarë kushti, për çfarë kushti bëhet fjalë, në qoftë se
22 respektohen marrëveshja.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Do të konsultohem për një minutë.

24 [Përfaqësuesi i Mbrojtjes këshillohet]

25 Z. CADMAN: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, z. Shala e ka

1 të qartë. Mund t'ia bëni përsëri pyetjen dhe ai është i
2 gatshëm të përgjigjet.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
4 për qartësim, këto janë kushte për miratimin e marrëveshjes
5 për pranimin e fajësisë. Domethënë, statusi i këtyre të
6 drejtave.

7 Përsëri, z. Shala, a mund të më konfirmoni se e keni
8 kuptuar këtë dhe se hiqni dorë prej të drejtave që ua lexova?

9 I AKUZUARI SHALA: Po e kam kuptuar shumë mirë dhe heqi
10 dorë nga të drejtat secilat.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit, z. Shala.

13 E dyta, sipas kushteve të marrëveshjes për pranimin e
14 fajësisë, z. Shala, që janë paragrafët 18(a) dhe (b), a është,
15 a kuptohet se ju mbani të gjitha të drejtat të tjera, duke
16 përfshirë veçanërisht të drejtën për t'u përfaqësuar nga një
17 avokat mbrojtës në të gjitha fazat e procedurës dhe të
18 komunikoni në mënyrë të lirë me atë Avokat në takime
19 konfidenciale, si dhe të drejtën për të parashtruar
20 informacion ose dëshmi relevante për përcaktimin e dënimit
21 sipas Rregullës 162(1) dhe (5) të rregullores. A e keni të
22 qartë se ju vazhdoni t'i keni këto të drejta. Domethënë, i
23 gëzoni edhe më tej këto të drejta?

24 I AKUZUARI SHALA: Po, e kam kuptuar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Përpara se t'i drejtohem z. Shala, në qoftë se e kupton
3 pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe heqjes dorë
4 nga e drejta për t'u gjykuar në procedurë të rregullt, tani
5 dua t'i jap mundësinë ZPS-së dhe Mbrojtësit që të bëjnë
6 parashtrimet e tyre, të paraqesin mendimet e tyre që i
7 gjykojnë të nevojshme duke përfshirë në lidhje me Rregullën
8 94(5)(e) dhe (f) të rregullores. Pra, në qoftë se e gjykon të
9 nevojshme të bëjnë parashtrime të tilla.

10 Së pari do t'ia jap fjalën Zyrës së Prokurorit të
11 Specializuar dhe më pas Mbrojtjes. Kush do të flasë në emër të
12 Prokurorisë?

13 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Sa i përket dispozitave të
14 rregullës 94, nënparagrafi (5) dhe parashtrimeve në lidhje me
15 nënparagrafin (a) deri në (d), dhe ZPS-ja është e bindur se z.
16 Shala ka konfirmuar se i kupton dispozitat përkatëse në
17 marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në përgjithësi kupton
18 kushtet e asaj marrëveshjeje dhe se atë e ka bërë në bazë
19 vullnetare.

20 ZPS-ja, në lidhje me marrëveshjen, dëshiron të shtojë se
21 kjo marrëveshje është një dokument i plotë dhe se të gjitha
22 kushtet e përmendura në atë marrëveshje janë midis palëve dhe
23 nuk ka dispozita të tjera që mund të përdoren në interpretimin
24 e asaj marrëveshjeje.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Tani për sa i përket parashtrimeve në lidhje me kriterin
3 në qoftë se ekziston bazë e mjaftueshme faktike që vërteton
4 faktet thelbësore të nevojshme për vërtetimin e krimeve, a
5 keni diçka për të shtuar?

6 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.
7 Duke qenë se paragrafët që janë lexuar dhe janë në
8 procesverbal dhe faktet e përmbajtura në Shtojcën 1, baza
9 faktike vetë është e përfshirë në proces dhe sipas nesh janë
10 plotësuar të gjitha kushtet.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Tani ju e keni fjalën, Avokat Mbrojtës.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] E nderuar Gjykatës, meqë pyetja
15 jua j ka të bëjë me nën paragrafët (e) dhe (f), unë do t'i
16 kufizoj komentet e mia vetëm në lidhje me këta paragrafë.

17 Nuk ka nevojë të shtohet asgjë për sa i përket Bazës
18 Faktike. Janë plotësuar kushtet që janë në interes të
19 drejtësisë. Z. Shala i ka pranuar ato dhe e ka bërë të qartë se
20 i pranon ato, kështu që mendoj se nuk ka nevojë për
21 parashtrime të mëtejshme në këtë fazë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit, Avokat.

24 Atëherë, do të vazhdojmë.

25 Z. Shala, pasi keni dëgjuar parashtrimet e Zyrës së

1 Prokurorisë dhe të avokatit tuaj, a mund t'ju kërkoj që të
2 konfirmoni edhe një herë se i kuptoni kushtet dhe pasojat e
3 kësaj marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe se nuk dëshironi
4 të ndryshoni asgjë në këtë marrëveshje për pranimin e fajësisë
5 të cilën e keni nënshkruar?

6 I AKUZUARI SHALA: Po, e nderuar. Unë jam i vetëdijshtë
7 për këtë marrëveshje, e kuptoj shumë mirë, sepse është edhe në
8 gjuhën shqipe. Kam komunikuar me avokatin tim dhe plotësisht
9 jam dakord me këtë marrëveshje. I kuptoj edhe pasojat edhe të
10 gjitha.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
12 nuk dëshironi që të bëni asnjë ndryshim në këtë marrëveshje?

13 I AKUZUARI SHALA: Dënimi ma i vogël, ma i mirë është.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
15 pajtoheni me atë që e kemi diskutuar. Unë nuk po qeshem, z.
16 Shala. Është një çështje shumë serioze.

17 I AKUZUARI SHALA: Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
19 më duhet një përgjigje e qartë nga aspekti ligjor. Pra, a ka
20 diçka që do kishit dashtë ta ndryshoni në lidhje me këtë
21 marrëveshje për pranimin e fajësisë që e keni bërë me Zyrën e
22 Prokurorit të Specializuar?

23 I AKUZUARI SHALA: Jo, e nderuar, gjithçka është në
24 rregull nga ana ime.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit. Atëherë, z. Shala, do të kërkoj prej jush që të
2 vetëdeklaroheni në lidhje me akuzat dhe me këtë rast do t'ju
3 kërkoj që të ngriheni në këmbë sikurse e kemi bë edhe në fazën
4 e procedurës paraprake. A mund të çoheni në këmbë, ju lutem?

5 Z. Shala, në konferencën statutore ju u vetëdeklaruat i
6 pafajshëm në lidhje me akuzat për pengim të personave zyrtarë
7 në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në një
8 veprim të përbashkët të një grupi sipas Pikës Dy (2) të
9 Aktakuzës së Konfirmuar të 6 dhjetorit 2023 dhe akuzës për
10 frikësim gjatë procedurës penale sipas Pikës Tre (3) të
11 Aktakuzës së Konfirmuar të 6 dhjetorit, dhe kjo është
12 Parashtrimi numër 7, Aneksi 1 në Dosjen e Çështjes 11.

13 A jeni i gatshëm tani që ta ndryshoni këtë vetëdeklarim,
14 pra, prej i pafajshëm është fajtor?

15 Po?

16 I AKUZUARI SHALA: Në atë kohë kur kam deklaruar i
17 pafajshëm, unë nuk kam qenë i intervistuar asnjëherë nga
18 Prokuroria, as nga hetuesit. Edhe nuk isha i njoftuar
19 plotësisht çfarë bëhet fjalë. Për këtë arsye kam deklaruar i
20 pafajshëm. Tash nuk ka -- tash jam i fajshëm me atë çka jam
21 pajtuar.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 I drejtohem Mbrojtësit, pra me këtë nënkuptoj se: Po, e
25 ndryshoj vetë deklarimin.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, në përputhje me kushtet e
2 marrëveshjes.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
4 Në rregull.

5 Z. Shala, qëndroni në këmbë ju lutem se do të lexoj dhe
6 do t'ju pyes në qoftë se vetëdeklaroheni fajtor në lidhje me
7 atë që do t'ju lexoj.

8 Do të lexoj tani Pikat Dy (2) dhe (3) ashtu siç paraqiten
9 në aktakuzën e konfirmuar të datës 10 korrik 2024, dhe do t'ju
10 pyes që, do t'ju kërkoj pra që të vetëdeklaroheni në lidhje me
11 secilën prej tyre.

12 Domethënë Pika Dy (2): Pengim i personave zyrtarë në
13 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin
14 e përbashkët të një grupi midis ma së paku 5 dhe 12 prilli
15 2023, vepër penale kundër rendit publik, e ndëshkueshme në
16 bazë të Neneve 17, 21, 28, 33, 35, dhe Nenet 401(2) dhe (5) i
17 Kodit Penal të Republikës së Kosovës të vitit 2019 dhe Nenet
18 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

19 Z. Shala, si vetëdeklaroheni në lidhje me këtë akuzë?
20 Fajtor apo i pafajshëm?

21 I AKUZUARI SHALA: Fajtor.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Atëherë, do të vazhdoj te Pika Tre (3), frikësim.

25 Frikësim gjatë procedurës penale midis ma së paku 5 dhe

1 12 prillit 2023, vepër penale kundër administrimit të
2 drejtësisë dhe administratës publike, e ndëshkueshme në bazë
3 të Neneve 17, 21, 31, 33, 35 dhe 387 të Kodit Penal të
4 Kosovës, të Republikës të Kosovës të vitit 2019 dhe Neneve
5 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

6 Z. Shala, a deklaroheni në lidhje me këtë pikë, fajtor
7 apo jo i pafajshëm.

8 I AKUZUARI SHALA: Fajtor.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Tani mund të uleni, z. Shala.

12 Tani do të kalojmë te parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje
13 me dënimin.

14 Z. Shala, këtu do të kem disa pyetje që do t'ia drejtoj
15 Avokatit tuaj. Sigurisht që mund të konsultoheni me të dhe ju
16 lutem që të na e bëni me dije në qoftë se diçka është e
17 vështirë për t'u kuptuar apo diçka nuk kuptoni.

18 E shikoj që jeni në këmbë, Avokat?

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, meqë më drejtuat.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ende
21 nuk kam përfunduar, jam duke i përfunduar, jam duke i
22 formuluar pyetjet. Dhe ju falënderoj.

23 Avokat, dje ZPS-ja parashtrroi dosjet penale të z. Shala,
24 që është parashtrimi 629, Shtojca 1. Z. Avokat, a dëshironi të
25 përgjigjeni në ato parashtrime të Prokurorisë dhe t'i bëni ato

1 parashtrime para Trupit Gjykses? Në qoftë se ka nevojë, mund
2 të kalojmë në seancë private.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Këtë e kam diskutu me z. Shala sot
4 në mëngjes dhe këto dokumente na janë nxjerrë dje jashtë
5 udhëzimeve të Trupit Gjykses, që i ka dhënë, pra, Trupi
6 Gjykses në lidhje me materialet për këtë seancë. Që domethënë
7 ato materiale janë dorëzuar jashtë afatit të paraparë prej jush.

8 Çështja e dytë ka të bëjë me -- dënimin me kusht.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
10 doni të kalojmë në seancë private?

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, nuk ka nevojë për këtë. Natyra
12 e këtyre çështjeve simbas parashtrimeve të Mbrojtjes,
13 mbështetet në faktorin rëndues. Ne parashtrojmë se nuk ka
14 asnjë çështje për të cilën ju, e nderuar Gjykatëse, keni
15 juridiksion për të trajtuar me të tjerë përveç për të marrë
16 parasysh ato si faktorë rëndues, ashtu sikurse i ka
17 parashtruar Prokuroria.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit. I kam parasysh parashtrimet.

20 Prokuror, keni ju diçka për t'u përgjigjur në këto,
21 parashtrimeve të Mbrojtjes?

22 Z. DEVANEY: [Përkthim] Këto dënime janë parashtruar vetëm
23 në cilësinë e faktorëve rëndues për sa i përket caktimit të
24 dënit, dhe janë, domethënë, të përdorshme vetëm për këto
25 procedura. Sikurse tha dhe Avokati i Mbrojtjes, ajo çka mund të

1 ndodhë më vonë është jashtë këtyne procedurave.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit. Do ta ndal mikrofonin vetëm për të parë se ju
4 kam kuptuar si duhet.

5 Atëherë, nuk ka parashtrime të tjera përveç atyre që janë
6 bërë tani.

7 Atëherë, ka dhe një pikë. Dhe kjo nuk ka të bëjë me
8 caktimin e dënimit, por me zhdëmtimet.

9 Trupi Gjykses vëren se sipas Mbrojtjes zhdëmtimet nuk
10 janë të zbatueshme në këtë lëndë gjyqësore, sepse Baza Faktike
11 për të cilën palët janë dakord nuk zbatohet *vis a vis* asnjë
12 personi fizik që mund të ketë pësuar dëm si rezultat i
13 drejtpërdrejtë apo i tërthortë i veprave penale për të cilat i
14 akuzuari e ka pranuar fajin. E shikoj që pohoni me kokë.

15 Z. Avokat, a keni dhe diçka për të shtuar në lidhje me
16 çështjen e zhdëmtimeve?

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Dy pika u nënvizuan për sa u përket
18 zhdëmtimeve dhe ju e ngritët këtë, e nderuar Gjykatëse, duke
19 dhënë afatin deri më 20 janar për parashtrime të tilla.

20 Para së gjithash, nuk është bërë asnjë farë njoftimi apo
21 kërkesë deri më tani në lidhje me zhdëmtimet nga ana e Zyrës
22 së Prokurorisë. Dhe e dyta, në bazë të marrëveshjes për
23 pranimin e fajësisë, baza e kufizuar në lidhje me Pikën Tre
24 (3) demonstroi se nuk është pësuar kurrfarë dëmi sikurse
25 përcaktohet edhe në shënimin për dënimin.

1 Mbi këtë bazë nuk ka asnjë, si të thuash, themel të
2 përshtatshëm mbi të cilin mund të mbështetet Trupi Gjykses në
3 lidhje me zhdëmtimet. Kjo Gjykatë ka trajtuar edhe raste të
4 mëparshme që lidhen me procesin e pengimit të procedurave në
5 çështjen Gucati dhe Haradinaj, në atë çështje nuk u urdhëruan
6 zhdëmtime mbi bazën se nuk kishte prova të mjaftueshme para
7 Gjykatës dhe prova të pranueshme para Gjykatës në lidhje me
8 dëmin e pësuar nga ndonjë person fizik.

9 Pra, është parashtrimi im se meqë nuk ka bazë të
10 përshtatshme për këtë Gjykatë për të trajtuar çështjen e
11 zhdëmtimeve, kjo është thjesht një çështje e pranimit ose jo
12 të kushteve të marrëveshjes dhe të dënimit që janë rënë dakord
13 midis palëve.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit. Atëherë, do t'ia jap fjalën Zyrës së Prokurorit.

16 Z. DEVANEY: [Përkthim] Siç kemi thënë paraprakisht, duke
17 qenë se është bërë një marrëveshje për pranimin e fajësisë,
18 nuk do të bëhet gjykim dhe siç e njoftuat edhe juve, do të
19 ketë një procedurë për një proces për viktimat që të marrin
20 pjesë në këtë çështje, në qoftë se ka baza për zhdëmtimet.
21 Megjithatë, ne nuk jemi dakord me pozicionin e Mbrojtjes
22 lidhur me këtë që nuk ka dëm ndaj viktimave në këtë rast, dhe
23 ne vëmë në dukje se marrëveshjet e fajësisë nuk e kanë
24 kufizuar aftësinë e palëve që të bëjnë parashtrime në lidhje
25 me këtë. Domethënë, për të parë se çfarë dëmi i është

1 shkaktuar viktimave dhe kjo është një rezultat logjik i
2 veprimeve që janë bërë në këtë rast.

3 Në qoftë se ju dëshironi, të nderuar Gjykatës, ne jemi të
4 gatshëm të bëjmë parashtime në lidhje me këtë, ndoshta në
5 seancë private për të mbrojtur identitetin.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Atëherë, faleminderit, z. Prokuror. Por a jeni i gatshëm ju që
8 ta bëni tani? Sepse nuk e kam të qartë. Doni të hyni në seancë
9 private në këtë moment apo dikur më vonë?

10 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

11 Z. DEVANEY: [Përkthim] Provat që kam përmendur më përpara
12 nga viktimat janë prova që janë dhënë nëpërmjet procesit të
13 nxjerrjes së provave. Ne do të bëjmë parashtime në të ardhmen
14 në lidhje me këtë dhe me kontekstin.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit. Kjo e sqaroi pyetjen që kisha për ju.

17 Avokat, unë thashë që do t'ju jepja fjalën për këtë.
18 Pyetja im u sqarua por nuk e di a keni ju ndonjë koment.

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, kam koment.

20 Së pari, nuk ka asnjë provë në këtë Gjykatë që të jetë
21 ofruar dhe dorëzuar. Po të shikoni në paragrafin 15 të
22 marrëveshjes për sa i përket zhdëmtimeve, thuhet se ZPS-ja dhe
23 i pandehuri, dhe pastaj thotë që, "në një moment para kohës
24 kur do të jepet vendimi për dënimin".

25 Ne jemi të mendimit se ZPS-ja ka pasur mundësi të

1 bollshme për ta trajtuar këtë çështje dhe nuk e ka bërë këtë,
2 kështu që nuk mund të jepet, nuk duhet t'i jepet kohë e
3 mëtejshme për këtë. Vetëm kur e ngritët ju këtë çështje
4 atëherë ata menduan dhe thanë që do të bënin parashtrimin në
5 lidhje me këtë. Nuk ka prova në lidhje me -- ose prova të
6 pranueshme që t'i keni ju para, të nderuar Gjykatës, që do
7 t'ju bënin të mundshme të trajtonit çështjen e zhdëmtimeve.

8 Pra, parashtrimi im është që Gjykata ta hedhë poshtë këtë
9 kërkesë të Prokurorisë në tërësinë e saj dhe nuk duhet të
10 bëhet asnjë urdhër për zhdëmtime, sepse nuk ka dhe ne nuk dimë
11 të ketë prova para kësaj Gjykate se ekzistojnë prova të tilla.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit, Avokat. Unë mund të lejoj dhe një raund tjetër
14 diskutimesh, në qoftë se është e nevojshme, si mendoni
15 Prokuror?

16 Z. DEVANEY: [Përkthim] Nuk ka nevojë për diskutime të
17 mëtejshme.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit.

20 Atëherë, do të thotë që vazhdojmë edhe me një pikë
21 tjetër. Kjo është, do t'i drejtohem z. Shala, në lidhje me
22 këtë.

23 Z. Shala, tani po ju kthehem ju. Unë vërej se avokati
24 juaj në emailin e tij ditën e djeshme në orën 8.50 të
25 mëngjesit, është numri i korrespondencë 106, ai njoftoi aty se

1 nuk pritet që ju të bëni ndonjë deklaratë në seancën e sotme.
2 Unë e kam parasysh këtë. Megjithatë, kam disa pyetje që dua
3 t'ju bëj por sigurisht nuk jeni i detyruar që t'i përgjigjeni.

4 Z. Shala, desha të di nëse ju dhe -- z. Shala, dëshironi
5 të shprehni ndonjë keqardhje, ndonjë pendesë, pra në kuptimin
6 që ju vjen keq që keni bërë diçka gabim, në lidhje me Bazën
7 Faktike që u diskutua këtu? Për të cilën është rënë dakord.

8 I AKUZUARI SHALA: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
10 të rrini i ulur. E shikoj që Avokati është ngritur në këmbë.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Kjo është diçka që unë dhe ne nuk e
12 kishim pritur dhe dëshiroj që të marr një moment të
13 konsultohem me z. Shala, por kjo nuk është një çështje që, me
14 të cilën mund trajtoj këtu ku jemi në fund të kësaj salle.
15 Pra, z. Shala ka dhënë informacion dhe njoftim që nuk do të
16 japë deklaratë sot.

17 Dhe kjo me sa di unë, ai nuk është i detyruar që të japë
18 përgjigje pyetjeve që do i bëni ju. Por në qoftë se do të ketë
19 pyetje të tjera në lidhje këto, ju lutem, a mund të
20 konsultohem me të nëse do të ishte e përshtatshme që ai t'i
21 përgjigjet atyre pyetjeve.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Avokat, do t'ju jepet koha në qoftë se keni nevojë për kohë
24 për t'u konsultuar, por Trupi Gjykes mendon që është diçka e
25 ndryshme që të japësh deklaratë dhe ju e bëtë të qartë se cili

1 është pozicioni juaj, por kjo nuk i heq mundësinë Trupit
2 Gjykues sepse do të ishte, mund të jetë një faktor në, që të
3 merret parasysh në dhënien e dënimit. Dhe kjo është arseja pse
4 do të bëhet pyetja.

5 Sa kohë ju duhet?

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Mund të bëj një diskutim shumë të
7 shkurtër me të tani, në moment, dhe pastaj t'ju them nëse më
8 duhet kohë më tepër për t'u konsultuar me të. Në qoftë se më
9 lejoni të flas me të tani.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Desha
11 t'ju them që kjo është pjesa e fundit e kësaj seance për
12 marrëveshjen për pranimin e fajësisë, dhe domethënë në lidhje
13 me z. Shala, vetëm.

14 Dhe desha, ju lutem, të më thoni se sa kohë ju duhet
15 sepse dua ta finalizoj këtë pjesë të seancës përpara se sa,
16 përpara pushimit të drekës. Pra, ju lutem bisedoni me të se si
17 e qysh dhe pastaj më jepni një përgjigje.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Ne prisnim që unë do të bëja
19 parashtrime në lidhje me të, në emrin e tij. Dhe unë si, nuk
20 mund të përgjigjem se çfarë mendon ZPS-ja dhe çfarë pozicioni
21 ka ZPS-ja në lidhje me këtë, dhe në lidhje me parashtrimet, në
22 lidhje me këtë çështje për sa i përket dhënies së dënimit. Nuk
23 besoj se do të na duhet më shumë se 10-15 minuta sidoqoftë,
24 për të diskutuar për këtë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 qoftë se ju do të bëni parashtrime në lidhje me dënimin që do
2 të jepet, unë do t'jua jap fjalën në lidhje me dënimin, por së
3 pari një herë flisni me klientin tuaj dhe pastaj do t'ju jap
4 fjalën.

5 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Avokat, shoh që jeni akoma në këmbë, ju jap fjalën.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Ne patëm një diskutim shumë të
9 shkurtër me z. Shala, dhe ai do që unë të bëj parashtrime në
10 emër të tij.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Atëherë, nga kjo kuptoj që ai nuk do të thotë asgjë në lidhje
13 me pendesën?

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Siç e thashë, ai do që unë t'i bëj
15 parashtrimet në lidhje me këto çështje dhe nuk do t'i
16 përgjigjet pyetjes tuaj.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Atëherë, unë do të shënoj këtu që ai nuk do të japë përgjigje
19 ndaj pyetjeve në lidhje me pendesën.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, ashtu është.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Atëherë, e kemi shënuar në procesverbal.

23 Atëherë, ju, z. Cadman, deshët që të bënit parashtrime në
24 lidhje me dënimin. Atëherë, unë do t'jua jap fjalën për këtë
25 dhe pastaj do t'ia jap fjalën Zyrës së Prokurorit të

1 Specializuar dhe do të bëjmë edhe një raund tjetër diskutimet
2 në lidhje me përgjigjet që kanë palët ndaj njëri-tjetrit. Mbas
3 kësaj do ta mbyllim seancën e paradites për të bërë pushimin e
4 drekës.

5 Atëherë, Avokat, keni fjalën.

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju i keni
7 marrë parashtrimet që kam bërë me shkrim në emër të z. Shala,
8 që i kam paraqitur, që është dokumenti 616, më datë 6 dhjetor
9 në lidhje me dënimin. Dhe sigurisht ne i kemi trajtuar këto në
10 mjaft hollësi për sa i përket marrëveshjes për pranimin e
11 fajësisë dhe çfarë ka pranuar ai, pranimin e fajësisë në
12 lidhje me të.

13 Për sa i përket pengimit të personave zyrtarë në kryerjen
14 e detyrave zyrtare, siç e kemi parë kjo bie në nenin 401(2) të
15 Kodit Penal të Kosovës, kurse çështja tjetër, ose pika tjetër
16 e aktakuzës, frikësimi gjatë procedurës penale, është Neni
17 387. Dhe kjo kufizohet vetëm në ofrimin e një dhurate dhe
18 kufizohet specifikisht vetëm në ofrimin e një dhurate.

19 Unë parashtroj se sjellja për të cilën z. Shala ka, është
20 vetëdeklaruar fajtor, është në shkallën më të ulët të peshës
21 së veprës penale.

22 Për sa i përket Pikës Dy (2) të Aktakuzës, së pari Bazat
23 Faktike për të cilat është rënë dakord nuk thonë që z. Shala
24 faktikisht e pengoi ndonjë person zyrtar në kryerjen e detyrës
25 zyrtare. Vetëm është bërë përpjekje për ta bërë këtë. Kjo

1 gjendet në paragrafin 10 të parashtrimeve që kam bërë në
2 lidhje me dënimin.

3 Së dyti, sjellja e tij është në një shkallë të ulët,
4 është dhe ka të bëjë vetëm me dy kontakte në dy raste të
5 veçanta. Megjithëse është pranuar që z. Shala ka komunikuar me
6 z. Bahtijari dhe z. Januzi, sikurse thuhet edhe në
7 marrëveshjen për pranimin e fajësisë, këto veprime janë pjesë
8 përbërëse e vetvetishme e një veprë penale që kërkon
9 pjesëmarrje në një grup personash të cilët pengojnë ose
10 përpqen të pengojnë, tentojnë të pengojnë, përmes veprimit të
11 përbashkët. Së dyti -- kjo trajtohet në paragrafin 11 të
12 parashtrimeve tona.

13 Së treti, nuk është bërë shpërdorim i detyrës zyrtare dhe
14 së fundi siç e dëgjuam sot, nuk ka ndonjë indikacion që është
15 shkaktuar ndonjë dëm i perceptueshëm nga veprimet e të
16 akuzuarit, ose të pandehurit. Kjo është në paragrafin 12 të
17 parashtrimeve me shkrim.

18 Për këtë arsye ne themi që Pika Dy (2) e aktakuzës është
19 në nivelin më të ulët të peshës së veprës penale, dhe për këtë
20 kemi rënë dhe dakord me Prokurorinë. Kjo është komplet në
21 përputhje me të.

22 Për sa i përket pikës 3, duhet të kujtohem se kjo ka të
23 bëjë vetëm me frikësimin përmes ofrimit të një dhurate dhe
24 përfitimi dhe nuk është bërë asnjë kërcënim serioz, përdorim
25 force, apo ndonjë mënyrë tjetër detyrimi. Kjo është në

1 paragrafin 14 të parashtrimeve tona me shkrim.

2 Të shikojmë tani jurisprudencën e kësaj Gjykate. Trupi
3 Gjykues, në çështjen Gucati dhe Haradinaj, që është e vetmja
4 çështje tjetër që është gjykuar nga kjo Gjykatë në lidhje me
5 pengimin, për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e
6 detyrave zyrtare për, me pjesëmarrjen në një grup, në veprimin
7 e përbashkët të një grupi, të dy të akuzuarit në atë çështje u
8 dënuan me një vit burg. Kjo është në aktgjykimin, në atë
9 çështje në paragrafët 981 dhe 1006.

10 Për akuzën e frikësimit, u dha dënim me katër vjet për të
11 dy të akuzuarit në atë çështje, dhe pastaj u dha një dënim i
12 njësuar prej katër vjet e gjysmë i cili pastaj më vonë u ul në
13 katër vjet.

14 Ka disa aspekte kyçe në çështjen Gucati dhe Haradinaj, ku
15 është e qartë se ato çështje për të cilat ata u dënuan, ato
16 akuza për të cilat ata u dënuan, ishin më të rënda dhe kishin
17 peshë më të rëndë se sa ato për të cilat po diskutojmë sot.
18 Edhe një herë, kur i shikojmë të gjitha këto çështje në
19 përgjithësi është e qartë që një dënim prej tre vjetësh është
20 plotësisht në përputhje me këtë qasje.

21 Në çështjen Gucati dhe Haradinaj, Trupi Gjykues konstatoi
22 se veprimet e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë. Po
23 kështu u konstatua që kishte, ekzistonte frika dhe kishte
24 shqetësime se personat që ishin objekt i atyre kërcënimeve,
25 domethënë siguria e tyre do të vihej në rrezik. Kurse pesha e

1 veprës penale në Nenin 387 për të cilin z. Shala ka rënë
2 dakord të vetëdeklarohet fajtor, nuk ka të bëjë fare me
3 përdorimin e kërcënimit të rëndë, por vetëm me premtimin e një
4 dhurate apo ndonjë forme tjetër përfitimi.

5 Po kështu, ju ftoj të nderuar Gjykatës, se dënimi në
6 çështjen Gucati dhe Haradinaj ishte i një niveli më të lartë,
7 sepse ata u dënuan edhe për çështje, për aspekte të tjera. Jo
8 vetëm për një akuzë të vetme.

9 Dhe së treti, sikurse shihet edhe në dokumentacion, asnjë
10 nga të akuzuarit në çështjen Gucati dhe Haradinaj nuk bëri
11 marrëveshje për pranimin e fajësisë që do të çonte pastaj në
12 mënyrë të pashmangshme një dënim më të ulët për ta.

13 Po kështu, është e qartë që dënimi prej tre vjetësh për
14 sjelljen për të cilën z. Shala ka rënë dakord se e ka kryer
15 është plotësisht në përputhje me praktikën dhe jurisprudencën
16 e Gjykatave të tjera ndërkombëtare. Në parashtrimet tona me
17 shkrim ne kemi përmendur çështjen --

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
19 nderuar Avokat, nuk ka nevojë t'i përsërisni ato çështje nga
20 jurisprudenca ndërkombëtare që i keni përmendur ose i keni
21 parashtruar në parashtrimin me shkrim sepse ne i kemi ato.
22 Sigurisht, ato janë shumë relevante. Por keni parasysh të jeni
23 i sigurt që ne i kemi parë dhe, i kemi parë ato parashtrimet
24 tuaja.

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, nuk desha të përsëris ato që

1 kam parashtruar tashmë me shkrim, dhe nuk do të hyj në hollësi
2 në lidhje me këto çështje sa përmenda, vetëm meqë është seancë
3 publike unë dua që ato të futen në procesverbal dhe të
4 përmenden.

5 Janë tre çështje që unë i referohem në parashtrimin,
6 është e para Haraqija dhe Morina që është një çështje e
7 Tribunalit Penal të Ish-Jugosllavisë. Çështja Milan Vujin dhe
8 Beqaj, edhe ajo është në, e Tribunalit të Hagës për Ish-
9 Jugosllavinë. Edhe pastaj është çështja me -- që është e
10 Mekanizmit Përmyllës.

11 Të gjitha këto çështje kanë të bëjnë me krime kundër
12 administrimit të drejtësisë dhe në secilin rast sjellja e tyre
13 ishte në një nivel më të rëndë se sa ato sjellje që kemi të
14 bëjmë këtu. Domethënë, kishte një nivel më të lartë peshe të
15 veprës penale se sa ato për të cilat është rënë dakord në
16 marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Sigurisht, e pranojmë që
17 kjo çdo çështje do të vendoset mbi bazën e fakteve specifike
18 të secilit rast më vete. Dhe ne mendojmë që dënimi me tre vjet
19 nuk është në mospërputhje, në fakt është më i lartë se sa
20 vendimet që janë dhënë në të gjitha ato çështje të tjera.

21 Pra, unë parashtroj se vendimet që janë dhënë në gjykatat
22 e tribunalet e tjerë janë, mbështesin atë propozim për dënim
23 që ka dhënë Prokuroria dhe për të cilin ne kemi rënë dakord.

24 Për sa i përket parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me
25 dhënien e dënimit. Së pari, z. Shala ka rënë dakord që të

1 pranojë fajësinë në lidhje me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) siç
2 edhe -- ka rënë dakord gjithashtu edhe për dënimin me tre
3 vjet. Dhe në këmbim për këtë pranim të fajësisë, në qoftë se
4 ju e pranoni, të nderuar Gjykatës, Prokuroria ka rënë dakord
5 që të rekomandojë një dënim prej tre vjetësh që është pranuar
6 nga z. Shala, dhe që ai, atij duhet t'i llogaritet edhe koha
7 që ka kaluar në burg deri tani.

8 Me gjithë këtë marrëveshje, Prokuroria bën parashtrime --
9 në parashtrimet e tyre urgjente në lidhje me marrëveshjen e
10 fajësisë dhe dënimin, aty sugjerohet që z. Shala ka rënë
11 dakord dhe Prokuroria thotë që ka rënë dakord për një diçka që
12 është më e rëndë se sa ajo, që është parashtruar. Ata nuk
13 marrin parasysh faktin që ne themi që kjo vepër penale është e
14 nivelit më të ulët dhe ata bëjnë aty pretendime, paraqesin
15 pretendime që janë në dëm dhe të marrëveshjes së fajësisë dhe
16 nuk janë në përputhje me të. Dhe ata argumentojnë në mënyrë të
17 gabuar se nuk duhet t'i jepet peshë e konsiderueshme
18 parashtrimeve të z. Shala në lidhje me karakterin e tij të
19 mirë apo dhe në lidhje me karakterin e të akuzuarve të tjerë.

20 Për sa i përket Pikës së Parë, Prokuroria pretendon se
21 është rënë dakord me secilin të akuzuar në bazë të Rregullës
22 163(2), që të jepen dënime më të ulëta në qoftë se ka
23 marrëveshje për pranimin e fajësisë. Pra, në rastin tonë, nuk
24 ka rrethana të tjera thonë ata, që mund të zbusin dënimin që
25 mund të jepet, sepse ky është dënimi më i ulët. Këto janë

1 paragrafët 23 dhe 31 të parashtrimeve të tyre me shkrim.

2 Kjo nuk merr parasysh veprat penale për të cilat ka rënë
3 dakord z. Shala të pranojë fajësinë. Se ato janë të nivelit të
4 ulët dhe më pak të rënda.

5 Sepse për sa i përket Pikës Dy (2) të Aktakuzës, z. Shala
6 vetëm tentoi të pengojë persona zyrtarë në kryerjen e detyrës
7 zyrtare dhe sjellja ishte e një shkalle të ulët siç e
8 përmenda. Nuk ka pasur abuzim të pushtetit, apo shpërdorim të
9 pushtetit, nuk ka pasur pozitë zyrtare, nuk ka kryer gjë në,
10 si person me pozitë zyrtare dhe nuk është shkaktuar ndonjë dëm
11 i prekshëm nga këto.

12 Po kështu, në Pikën Tre (3), ai nuk ka përdorur as forcën
13 as kërcënimin e rëndë për të arritur atë, për të kryer veprën
14 penale. Por Prokuroria në mënyrë të vazhdueshme i kërkon
15 Trupit Gjykues që të japë dënime të rënda të konsiderueshme,
16 me burgim, pa marrë parasysh se këto vepra penale, se ku futen
17 këto vepra penale për sa i përket shkallëzimit të dënimeve.

18 Për sa i përket Pikës së Dytë është e rëndësishme të
19 theksohet se ashtu siç është edhe në paragrafin, siç thuhet në
20 paragrafin 1 të marrëveshjes së fajësisë, se kjo marrëveshje
21 përcakton të gjithë mirëkuptimin e palëve për natyrën dhe
22 pasojat e pranimit nga z. Shala të fajësisë. Unë e theksoj kjo
23 është "tërësia" e të gjithë marrëveshjes për pranimin e
24 fajësisë, domethënë është rënë dakord për pranimin -- është
25 rënë dakord me marrëveshjen për pranimin e fajësisë në

1 tërësinë e saj.

2 Unë dua, të nderuar Gjykatës, të shikoni paragrafin 14 të
3 marrëveshjes për të parë se çfarë rrjedhojash ka ajo.

4 Unë parashtroj se Parashtrimet Urgjente të Prokurorisë në
5 lidhje me marrëveshjen e fajësisë dhe dënimin përmbajnë disa
6 gabime faktike, ose disa pretendime faktike, që nuk janë as
7 prova të pranueshme, as parashtrime të vlefshme.

8 Në paragrafin 16 gjatë shpjegimit të Pikës Një (1) të
9 aktakuzës, flitet për tentim për pengim. Dhe kjo përmendet,
10 aty përmendet se çfarë ka ndodhur faktikisht. Nuk është pjesë
11 e termave, e kushteve të pranimit të fajësisë që familja ishte
12 aty, familja e Dëshmitarit 1. Po kështu për sa i përket
13 Dëshmitarit 1, dhe Dëshmitarit 4891, këta ishin dëshmitarë të
14 mbrojtur dhe aty thuhet që të dy dëshmitarët kishin mjaft
15 frikë, përjetuan shumë frikë për sigurinë e tyre dhe për
16 sigurinë e familjes së tyre. Kjo nuk është pjesë e
17 marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Dhe unë dua që ju mos
18 t'i merrni parasysh këto parashtrime.

19 Është e qartë nga deklaratat faktike që ka paraqitur
20 Prokuroria këto nuk janë pjesë e marrëveshjes dhe ju kërkoj që
21 ju të mos i merrni ato parasysh.

22 Për sa i përket parashtrimeve që kanë të bëjnë me
23 karakterin e z. Shala dhe që atyre, në qoftë se ka parashtrime
24 për këtë nuk duhet t'i jepet peshë, pavarësisht nga ekzistenca
25 e marrëveshjes, Prokuroria thotë që z. Shala nuk ka

1 bashkëpunuar. As edhe një herë të vetme nuk e kanë ngritur
2 këtë problem me z. Shala gjatë diskutimeve.

3 Më tej, vazhdon duke thënë që asnjëri prej atë akuzuarve
4 nuk ka bërë asnjë përpjekje për të kompensuar, zhdëmtuar
5 viktimat. Edhe këtu siç e kemi dëgjuar në mënyrë të përsëritur
6 sot, këtu, nuk ka asnjë provë që mbështet pretendimin se
7 ndonjëri prej individëve të përfshirë në këtë proces, për të
8 cilin z. Shala pranoi fajësinë, asnjë prej individëve nuk ka
9 pësuar ndonjë dëm për të cilin do të kishte të drejtë të
10 merrte ndonjë zhdëmtim apo kompensim. Dhe sigurisht ashtu siç
11 e thashë më lart, pavarësisht kësaj, nuk është bërë asnjë
12 kërkesë deri më sot për ndonjë formë zhdëmtimi apo kompensimi.

13 Prokuroria dedukton nga kjo, pra pretendimi për mungesë
14 bashkëpunimi për të kompensuar, duke thënë që asnjë rëndësi
15 nuk duhej t'i jepet parashtrimeve lidhur me karakterin e tij.
16 Kjo është e përmendur paragrafin 69, dhe kjo është tërësisht
17 gabim.

18 Parashtrimi i Prokurorisë nuk ka lidhje apo ndikim në
19 referencat sa i përket karakterit, pra natyrës së tij dhe do
20 ta them këtë detajisht, këto gjinden në shtojcat konfidenciale
21 nga 1 deri në 4. Por ajo që doja të thoja është që këto
22 referenca janë, tregojnë se dënimi me burg afatgjatë do të
23 kishte një efekt dëmtues veçanërisht për z. Shala dhe familjen
24 e tij dhe do të zvogëlonte kontributin e tij që ai mund të
25 bëjë për familjen e tij edhe komunitetin, bashkësinë dhe

1 vendin e tij, do ta them, dhe kjo është qartësisht e thënë në
2 këto referenca sa i takon karakterit.

3 Gjithashtu, do t'ju thoja dhe do ju kërkoja që të merrni
4 parasysh faktin se gjatë kohës që z. Shala ishte në
5 paraburgim, babai i tij vdiq dhe ai pati shumë pak kohë me
6 familjen e tij për shkak, si rezultat i asaj vdekje. Është e
7 rëndësishme që kjo të merret parasysh nga ju, të nderuar
8 Gjykatës.

9 Nuk dua të merrem me nxjerrjen e materialeve shtesë që
10 është bërë dje lidhur me provat për dënimet e mëparshme, ju i
11 keni, të nderuar Gjykatës. Siç e kam deklaruar kjo nuk është
12 çështje mbi të cilën ju keni juridiksion të merreni me të,
13 sepse kjo është çështje për një Gjykatë tjetër, por do t'ju
14 kërkoja që t'i shikoni dhe të identifikoni ato në kontekstin e
15 duhur të tyre lidhur me peshën e rëndë të këtyre veprave
16 penale. Edhe këtu janë, bëhet fjalë për vepra penale të një
17 rëndësie të vogël dhe shkalla e dënimit që pasqyrohet në këto,
18 bëhet fjalë për dënime me kusht.

19 Dua të theksoj, megjithatë, faktin që udhëzimi juaj që të
20 gjitha këto materiale të nxirren nga, deri më datën 6 dhjetor,
21 në fakt u nxorën 11 ditë më vonë, dje.

22 Sidoqoftë, këto prova nuk janë relevante për sa i përket
23 referimeve apo përshkrimeve të karakterit të z. Shala. Atë që
24 tregojnë këto referencat e karakterit janë efekti shkatërrues
25 rrënues që një dënim afatgjatë do të kishte në z. Shala dhe

1 familjen e tij.

2 Çështja e riparimeve, zhdëmtimeve është trajtuar më herët
3 dhe nuk do të merrem më me të. Ju ftoj juve, të nderuar
4 Gjykatës, që në bazë të asaj që kam deklaruar më herët, nuk ka
5 bazë të duhur që të nxirret ndonjë urdhër për riparim.
6 Konstatova urdhrin tuaj gojor sot, të nderuar Gjykatës, që kjo
7 do të vononte dhe më tej përmylljen e këtyre çështjeve. Dhe
8 është e rëndësishme të konstatojmë që përfundimi i kësaj është
9 shqyrtim kryesor i kësaj çështje.

10 Z. Shala ka qenë tanimë në paraburgim për më shumë se një
11 vit dhe ka shumë dëshirë të kuptojë dhe të njohë rezultatin
12 përfundimtar të këtij procesi. Vonesa e mëtejshme do t'i
13 shkaktojë dëm të mëtejshëm z. Shala lidhur me këtë pikë.

14 Të nderuar Gjykatës, kërkoj ndjesë për tejkalimin e
15 kohës. Por besoj që është e rëndësishme të vihet në kontekst
16 të duhur gjërat për të cilat është rënë dakord dhe ajo për të
17 cilat është rënë dakord është tërësisht në përputhje me
18 praktikat e kësaj Gjykate dhe praktikat e gjykatave të tjera.
19 Dënimi me të cilin është rënë dakord me Prokurorinë është
20 tërësisht i përshtatshëm dhe i duhur dhe ju ftoj, të nderuar
21 Gjykatës, që të pranoni faktin që të gjitha kushtet, kriteret,
22 janë përmbushur nën kuadër të kornizës ligjore të kësaj
23 Gjykate dhe që kjo marrëveshje për pranimin e fajësisë të
24 pranohet dhe dënimi të pranohet. Kemi bazë ligjore dhe faktike
25 të përshtatshme dhe të duhur që kjo gjë të bëhet dhe ju ftoj,

1 të nderuar Gjykatës, që të veproni në përputhje me këtë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, z. Avokat.

4 Tani i drejtohem Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

5 Së pari, që të bëjmë planifikimin e nevojshëm. Z.

6 Prokuror sa kohë mendoni do t'ju duhet? Jemi afër dy orëve që
7 kishim parashikuar për këtë seancë, kjo nuk do të thotë që nuk
8 do t'ju jepet kohë e mjaftueshme dhe juve, siç i dhashë kohë
9 edhe Mbrojtjes. Por do të doja të di si do vazhdojë më tej.

10 Z. DEVANEY: [Përkthim] Ju keni parashtrimet tona me
11 shkrim. I përgjigjem Mbrojtjes, por nuk besoj që do të më
12 duhet më shumë se dhjetë minuta.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
14 t'ju jap fjalën atëherë, dhe në qoftë se kjo -- çon z. Cadman
15 që të ri -- që të përgjigjet ndaj parashtrimeve tuaja, do
16 t'jua jap këtë mundësi, dhe që të përmbyllim këtë pikë. Pastaj
17 do kalojmë për, do bëjmë pushimin e drekës.

18 Z. Prokuror, e keni fjalën ju.

19 Z. DEVANEY: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

20 Besoj që gjëja më e rëndësishme që duhet të theksohet
21 është ajo për të cilën kemi rënë dakord me Mbrojtjen që dënimi
22 prej tre vjetësh është i duhur dhe i drejtë si dënim. Dhe
23 ndryshe nga pohimet e Mbrojtjes kjo bën, është pjesë e
24 shkallës apo peshës së veprave penale të kësaj natyre. Dënimi
25 maksimal është dhjetë vjet dhe dënimi tre vjetësh, dënimi në

1 këtë rast është tre vjet.

2 Ajo me të cilën nuk jemi dakord me Mbrojtjen është se
3 sjellja, apo e rëndë, e akuzuarit në këtë çështje. Duke, kur
4 shohim faktet për të cilat kemi rënë dakord, mund të arrijmë
5 në përfundimin vetëm se z. Shala ishte fillimi, përfundimi dhe
6 gjithçka në mes të asaj që ka ndodhur gjatë sjelljes penale të
7 këtë çështje.

8 Z Shala ka qenë vetëm fillimi sepse ka orientuar personat
9 të akuzuar të tjerë në këtë çështje në veprimet e tyre. Ai ka
10 qenë përfundimi dhe fundi i kësaj sepse ka siguruar
11 mbështetjen financiare përmes lekëve në këtë çështje dhe
12 ndryshe nga pohimet që tentojnë për të zvogëluar këtë sjellje
13 nga ana e Mbrojtjes, këto komunikime janë pjesë në vetvete e
14 këtyre, janë pjesë e pandashme e këtyre veprave penale. Z.
15 Shala ka qenë motori, pra që ka tërhequr përpara gjithë këtë
16 sjellje kriminale, penale. Veprat, veprimet kriminale përmes
17 komunikimit të vazhdueshëm me disa të akuzuar, menaxhime,
18 qasja, qasja kontakti i dytë pas kontaktit të parë, i cili nuk
19 funksionoi. Pra, në këtë mënyrë sjellja e tij është e rëndë.

20 Dëmi në këtë rast është -- nuk është thjesht tek
21 viktimat. Ndikimi i këtyre veprave penale është pjesë e një --
22 sjelljeje që vazhdon të jetë e pranishme në mënyrë të
23 përsëritur. Dhe kjo është arsyeja pse jemi këtu. Dëshmitarët e
24 Mbrojtur në Dhomat e Specializuara të Kosovës mund të
25 kontaktohen në mënyrë të përsëritur dhe t'i nënshtrohen

1 sjelljeve dhe të jenë objekt i sjelljeve kriminale që kanë
2 efekt frikësues potencial edhe të, tek besimi që publiku ka në
3 efikasitetin e urdhrave të Dhomave të Specializuara dhe
4 vendimeve të tyre përfshirë dhe ato që kanë të bëjnë me masat
5 mbrojtëse. Një dënim i rëndësishëm i një shkalle të lartë do
6 të kishte efekt parandalues sa i takon këtij besimi që publiku
7 do të ketë në këtë.

8 Lidhur me këtë, z. Shala -- dhe Mbrojtja e z. Shala bëri
9 një krahasim me çështjen Gucati dhe Haradinaj duke argumentuar
10 se elementet e pranishëm në këtë çështje janë më të -- nuk
11 janë më të rëndë.

12 Dhe, z. Shala nuk po merr parasysh faktin që viktimat në
13 këtë rast janë kontaktuar personalisht në shtëpinë e tyre në
14 disa raste. Këto janë raste të përsëritura nga disa të
15 akuzuar, nën drejtimin e z. Shala, ish-komandant i UÇK-së dhe
16 përsëri edhe këtu ai punonte në bashkëpunim me persona të
17 tjerë të paidentifikuar për të parandaluar Dëshmitarin 1 nga
18 dhënia e dëshmisë me çdo kusht.

19 Mbrojtja theksoi paragrafin 14 të marrëveshjes së
20 fajësisë ku thuhej që lejohen prova të tilla dhe parashtrime
21 të tilla që nuk janë në mospërputhje me marrëveshjen lidhur me
22 Bazën Faktike të rënë dakord.

23 Në fakt Mbrojtja bëri parashtrime të tjera në formën e
24 dëmit që z. Shala dhe familja e tij pësojnë dhe megjithatë
25 kërkon të përjashtojë njëkohësisht, të mos lejojë që ZPS-ja të

1 bëjë parashtrime të krahasueshme lidhur me dëmin që u bëhet
2 viktimave në këtë rast, që mbështetet edhe nga materiale të
3 nxjerrura në këtë çështje. Dhe nuk, thjesht nuk është në,
4 koherente me faktet, me Bazën Faktike të rënë dakord në këtë
5 çështje dhe përfundimin e logjikshëm për veprime të tilla.

6 Mbrojtja e ka përmendur dhe shtjelluar peshën që duhet
7 t'i jepet, duhet t'i jepet provave lidhur me karakterin. Z.
8 Shala ka dhënë, ka bërë parashtrime lidhur me dënimin nga
9 miqtë dhe familja. Trupi Gjykues ka të drejtën e tij që t'u
10 japë këtyre parashtrimeve peshën që dëshiron të duhur.
11 Megjithatë, ZPS-ja pohon se matja apo kriteri më i duhur dhe
12 relevant është marrëdhënia e z. Shala me sundimin e ligjit dhe
13 dëshira, vullneti, gatishmëria për t'u përfshirë në këtë lloj
14 frikësimi dhe në këtë sjellje të pranishme që janë penguese në
15 këtë rast. Dhe kjo është e kaluara e tij penale për veprat e
16 tilla penale. Kjo është parashtruar.

17 Dhe si e tillë, sjellja e mëhershme kriminale e z. Shala
18 është faktor rëndues që përlligj dënimin në këtë çështje.

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
23 doja që të kalojmë në seancë private në qoftë se trajtohen
24 këto çështje.

25 Z. DEVANEY: [Përkthim] E kuptoj dhe nuk kam kundërshtim

1 për këtë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Znj. Sekretare na kaloni në seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit, znj. Sekretare.

10 Prokuror, e keni fjalën.

11 Z. DEVANEY: [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 Gjëja e fundit të cilës doja t'i përgjigjesha janë

16 komentet e bëra nga Mbrojtja lidhur me, mbi çështjen e

17 bashkëpunimit.

18 Që të jemi të qartë, z. Shala i është dhënë mundësia e

19 bashkëpunimit gjatë një interviste më herët në këtë proces, të

20 cilën ai nuk e pranoi. Bashkëpunimi i tij në vijim është bërë

21 në momentin e fundit dhe ai ishte shumë hezitant dhe bëri

22 vetëm minimumin. Dhe pamë edhe sot që z. Shala nuk dëshiroi të

23 shprehej personalisht në këtë çështje.

24 Këto ishin të gjitha parashtrimet që kisha, e nderuar

25 Gjykatëse. Mendoj edhe një herë që gjëja e rëndësishme që dua

1 të theksohet është se palët pajtohen për dënimin tre vjet, me
2 tre vjet në këtë çështje dhe që është i drejtë, i përshtatshëm
3 duke patur parasysh veprimet e z. Shala, dëmin real dhe
4 potencial ndaj viktimave dhe, më gjerësisht, dëmin potencial
5 të mundshëm ndaj Dhomave të Specializuara, për të cilin dënimi
6 i përshtatshëm në këtë çështje do të ketë ndikim që ta
7 zvogëlojë për të siguruar besimin e publikut në këtë
8 institucion.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
10 Avokati Mbrojtës ju jap mundësinë të përgjigjeni në qoftë se
11 dëshironi.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Shkurtimisht.

13 Së pari, ju, të nderuar Gjykatës, keni lexuar sot në
14 mëngjes hollësitë e asaj që përmban marrëveshja për pranimin e
15 fajësisë. Lidhur me kontaktet e shumta në fakt është e qartë
16 që bëhet fjalë për dy kontakte.

17 Sa i takon ndonjë shkëmbimi të mundshëm parash, të
18 nderuar Gjykatës, ju mund ta konstatonit që kjo është thënë nga
19 dëshmitari, jo nga ndonjë nga të akuzuarit.

20 Nuk dua të merrem me çështjen e dëmit, por Prokuroria
21 duhet të pranojë që kjo është e ndaluar në marrëveshjen për
22 pranimin e fajësisë, është pranuar si e tillë që nuk ka patur
23 dëm dhe nuk ka prova për një dëm të tillë.

24 Dhe së fundi sa i takon dy dënimeve, edhe këtu ju i keni
25 këto, të nderuar Gjykatës. Mund të lexoni hollësitë që ato

1 përmbajnë, dhe t'i vlerësoni ato në kontekstin e tyre të duhur
2 për atë që janë.

3 Komenti i fundit që do bëja është që sugjerimi që një
4 çështje penale bie në fund të shkallës së dënimit, nuk e
5 zvogëlon apo e bën të parëndësishme një vepër penale. Ajo
6 thjesht e bën veprën penale në kontekstin e duhur. E vendos
7 atë në kontekstin e duhur. Dhe parashtrimet e bëra vënë këto
8 çështje në bazë të marrëveshjes për fajësinë në kontekstit të
9 duhur që është në pjesën e ulët, të vogël, pra të shkallës së
10 dënimit. Dhe për rrjedhim, dhe rrjedhimisht, dënimi prej tre
11 vitesh është tërësisht i përshtatshëm dhe i duhur. Kjo është
12 ajo që doja të thoja.

13 Vërejtja tjetër që do të doja të bëja është sa i takon
14 bashkëpunimit. Është bërë një ftesë nga Prokuroria ndaj z.
15 Shala pas paraburgimit të z. Shala për një periudhë kohore
16 nëse dëshironte të jepte intervistë në baza vullnetare. Dhe
17 pas këshillimit, këshillave të marra, ai nuk pranoi një gjë të
18 tillë. Ai nuk është intervistuar përpara arrestimit të tij.
19 Nuk është intervistuar menjëherë pas arrestimit të tij, por
20 disa muaj më vonë në qendrën e paraburgimit.

21 Nuk janë bërë ftesa të tjera për të bashkëpunuar gjatë
22 këtyre procedurave, gjatë kësaj procedure, përveç atyre që,
23 pra, komunikimi ndërmjet palëve për çështjen e marrëveshjes së
24 fajësisë dhe pas atyre diskutimeve. Pra, kjo është ajo që doja
25 të thoja. Pra, të sugjerohet këtu që kjo është faktor rëndues

1 fakti që ai nuk ka bashkëpunuar, thjesht ju nuk mund ta
2 ndëshkoni atë për diçka që të cilën, që atij nuk i është dhënë
3 mundësia të bëjë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit. Ka diçka tjetër që ZPS-ja dëshiron të shtojë?

6 Z. DEVANEY: [Përkthim] Nuk ka asgjë tjetër.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit, z. Avokat. ZPS-ja nuk ka asgjë për të shtuar.
9 Ishit i fundit që e kishit fjalën.

10 Shoh që keni diçka për të shtuar.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Sapo m'u kujtua një pikë që duhet
12 ta theksoj.

13 Nuk është e duhur të penalizohet një i akuzuar në çështje
14 të tilla si këto për shkak që ai dëshiroi dhe zgjedh të flasë
15 përmes avokatit të tij. Është tërësisht e përshtatshme dhe e
16 duhur që ai të bëjë një zgjidhje të tillë. Dhe besoj që kjo
17 ishte pika e fundit që ZPS-ja bëri lidhur me pendesën
18 shprehjen e pendesës, ai zgjodhi të flasë përmes avokatit të
19 tij dhe kjo është tërësisht e duhur dhe e përshtatshme dhe nuk
20 duhet të penalizohet për këtë gjë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit. U konstatua.

23 Atëherë, pyetja ime është në këtë pikë -- nëse palët kanë
24 diçka tjetër për të ngritur përpara se të përfundojmë këtë
25 pjesë të seancës sa i takon marrëveshje të fajësisë për z.

1 Shala.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] U bë pyetja nëse z. Shala dëshiron
3 të marrë pjesë në seancën e ditës së nesërme. Ju informoj që
4 ai nuk dëshiroi të marrë pjesë. Kuptoj që duhet të bëhet një
5 heqje dorë për mosmarrje pjesë me shkrim. Natyrisht është pak
6 e vështirë për neve që të bëjmë diçka tjetër përveçse një
7 heqje dorë, pra në formë të shkruar, por do të duhesh me
8 dorëshkrim. Ai do të marrë pjesë nesër përmes videolidhjes. Ka
9 zgjedhur të mos marrë pjesë as personalisht apo përmes
10 videolidhjes.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull për këtë. Kjo është, ka disa kushte formale që duhet
13 të përmbushen. CMU-ja më thonë që do të jenë në gjendje t'ju
14 ndihmojnë në mënyrë proaktive dhe duhet të komunikoni me ta që
15 kjo çështje të zgjidhet.

16 Megjithatë, prania për seancën, pas seancës që ka të bëjë
17 me marrëveshjen për pranimin e fajësisë midis Bahtijarit, z.
18 Bahtijari dhe ZPS-së do të kemi një seancë tjetër gjysmë
19 orëshe shtesë pas asaj, pas një ore pushimi për të trajtuar
20 gjëra që mund të paraqiten. Pra, në këtë rast prania e palëve
21 është e domosdoshme.

22 Edhe në rast se i akuzuari nuk dëshiron të marrë pjesë
23 për diskutimet mbi pranimin e fajësisë së të akuzuarve të
24 tjerë, për këtë seancën shtesë që sapo përmenda gjysmë orëshe
25 do të kërkoja që të akuzuarit të jenë të pranishëm, të marrin

1 pjesë.

2 Arritëm në fund të seancës, pra, për marrëveshjen e
3 pranimin e fajësisë midis z. Shala dhe ZPS-së. Tani do bëjmë
4 një pushim dhe do bëjmë, pra, një orë e gjysmë pushim. Do
5 ritakohemi këtu në orën 15.00 dhe jo në 14.30. Z. Rees dhe
6 ZPS-ja, z. Prokuror, mendoj do vazhdojmë deri rreth orës
7 17.00, bazuar është atë që ndodhi deri tani, ky është plani që
8 kemi për sot pasdite.

9 Seanca ndërpritet dhe shihemi në orën 15.00.
10 faleminderit.

11 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.27

12 --- Seanca rifillon në orën 15.03

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
14 se erdhët përsëri për këtë seancë të pasdites. Së pari do t'ju
15 kërkoj palëve që përsëri të prezantohen.

16 Dhe do të filloj Mbrojtjen e z. Januzi.

17 Urdhëroni.

18 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit. Përfaqësimi nuk ka
19 ndryshime nga seanca e paradites.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 Për Prokurorinë.

23 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Tazneen Shahabuddin,
24 Prokurore. Kemi dhe ekipin e njëjtë nga mëngjesi dhe
25 gjithashtu John Devaney, Ndhmësprokuror, si dhe Joshua

1 Hafetz, Prokuror dhe Line Pedersen, që është Administratore e
2 çështjes.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Nga ekipe të tjera të Mbrojtjes, përfaqësuesi i z. Shala
6 keni fjalën.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk ka ndryshim nga mëngjesi.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Dhe për z. Bahtijari.

11 ZNJ. GERRY [Përkthim] Një ndryshim i vogël. Jemi vetëm
12 tre këtu sot pasdite. Unë Felicity Gerry, Ndihmësmbrojtësja
13 Marion Carrin.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit. Tani do të fillojmë me seancën në lidhje me
16 marrëveshjen për pranimin e fajësisë midis z. Januzi dhe ZPS-
17 së.

18 Për hir të procesverbalit, theksoj se marrëveshja për
19 pranimin e fajësisë midis z. Sabit Januzi dhe ZPS-së u arrit
20 më 6 dhjetor 2024 dhe se përfaqësuesi apo Mbrojtësi i të
21 akuzuarit është Jonathan Elystan Rees.

22 Avokat, a mund ta konfirmoni këtë?

23 Z. REES: [Përkthim] Po, e konfirmoj.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit.

1 Përpara se të fillojmë, do të kërkoj që të konfirmohen
2 nënshkrimet e Avokatit Mbrojtës dhe z. Januzi në versionet e
3 ndryshme të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, atij në
4 shqip dhe atij në anglisht. Do të përpiqem që këtë ta bëj me
5 versionet elektronike pa pas nevojë që ato t'i tregohen z.
6 Januzi.

7 Kështu që do t'i kërkoj Sekretares së Gjykatës që të
8 vendosë në ekran dokumentin 618, Shtojca 1. Konfirmimi do të
9 bëhet --

10 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
11 këshillohen]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
13 është Shtojca 2, më falni, jo Shtojca 1 e parashtimit 618.
14 Dhe do të shkojmë tek Shtojca 1 e parashtimit 632.

15 Znj. Sekretare, shkoni ju lutem tek faqet 9 dhe 10 të
16 këtij dokumenti. Dhe do t'ju jap kohë, znj. Sekretare, që të
17 vendosni të dy versionet në ekran atë në anglisht dhe në
18 shqip. Faleminderit. Tani i kemi në ekran faqen 10 në të dy
19 versionet - ose, më falni. Më duhet versioni në shqip, prapë
20 bëra gabim dhe ngatërresë, znj. Sekretare. Po, në rregull
21 është ajo faqe. Faleminderit.

22 Z. Januzi, a e shikoni në ekranin përpara jush dy
23 versionet e marrëveshjes që i keni nënshkruar atë në anglisht
24 edhe atë në shqip, a i shihni përpara vetes në ekran?

25 I AKUZUARI JANUZI: Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
2 kërkoj Ndhmëses që ta ndihmojë z. Januzi.

3 Z. Januzi, nënshkrimi te versioni në shqip a është
4 nënshkrimi juaj?

5 I AKUZUARI JANUZI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
7 mund të përsërisni përgjigjen?

8 I AKUZUARI JANUZI: Po, nënshkrimi im është. Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
10 lutem siguroni që ta ndizni mikrofonin, z. Januzi. A mund edhe
11 një herë ju lutem ta përsërisni përgjigjen sepse mikrofonin
12 nuk e kishit ndezur dhe përgjigja juaj duhet të hyjë në
13 procesverbal. Ju lutem edhe një herë përsëritni përgjigjen.

14 I AKUZUARI JANUZI: Po, nënshkrimi im është.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
16 versionin në shqip?

17 I AKUZUARI JANUZI: Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
19 në anën e djathtë të ekranit është versioni në anglisht i
20 marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Në faqen 10, a është aty
21 nënshkrimi juaj?

22 I AKUZUARI JANUZI: Po, nënshkrimi im është.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull. Faleminderit.

25 Znj. Sekretare, a mund të shkojmë tek faqja 11.

1 Z. Januzi, versioni në shqip nga ana e majtë e ekranit, a
2 është aty nënshkrimi juaj i dyti në qoftë se e shikoni prej
3 lartë domethënë?

4 I AKUZUARI JANUZI: Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
6 në versionin në anglisht, që është në të djathtë të ekranit,
7 nënshkrimi i parë nga lartë-poshtë a është nënshkrimi juaj?

8 I AKUZUARI JANUZI: Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Nuk do t'i heqim një herë dokumentet, do t'i kërkoj
12 Avokatit Mbrojtës, z. Januzi që të përgjigjet në të dy
13 versionet, pra, në atë në shqip dhe atë në anglisht, a qëndron
14 aty nënshkrimi juaj, z. Avokat?

15 Z. REES: [Përkthim] Po, është versioni, është nënshkrimi
16 im në të dy versionet dhe ky është një shembull i mirë duke i
17 pasur të dy dokumentet afër njëri-tjetrit në ekran mund, pra,
18 të pyetet edhe znj. Shahabuddin për të konfirmuar në qoftë se
19 në të dy versionet është edhe nënshkrimi i saj.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Sigurisht që e kam ndërmend ta bëj këtë.

22 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Konfirmoj se aty qëndron
23 nënshkrimi im, si dhe nënshkrimi i Prokurores së Specializuar,
24 e cila është nënshkruar në praninë time.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Atëherë do të shkojmë tek faqja 10 te të dy versionet. Në
3 këtë rast versioni në shqip nuk është i rëndësishëm apo nuk
4 është relevant, por është ai anglisht.

5 Avokat, a mund të konfirmoni se tek ky versioni në
6 anglisht e shihni nënshkrimin tuaj?

7 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk e shoh.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
9 jeni i sigurtë?

10 Z. REES: [Përkthim] Po, po. E shoh, në versionin në
11 anglisht, po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit për konfirmimin.

14 Atëherë në rregull. Faleminderit, Mbrojtës.

15 Atëherë të vazhdojmë, z. Januzi. Nuk ka nevojë të ndizni
16 mikrofonin njëherë përnjëherë. Faleminderit.

17 Z. Januzi, për çdo herë që do t'ju bëj pyetje dhe do të
18 kërkoj përgjigje prej jush, ju lutem ndizeni mikrofonin aty
19 tek ajo pulla ku ndizet. A e keni të qartë sesi funksionon?
20 Sepse Ndhmësja nuk do të qëndrojë aty afër jush gjatë gjithë
21 seancës. Pra, kur t'ju bëj pyetje, ideja është që ta ndizni
22 mikrofonin sepse ndryshe nuk mund ta marrë përkthimin e asaj
23 që e thoni. Dhe përgjigja juaj është shumë me rëndësi.
24 Faleminderit.

25 Mendoj që për momentin nuk kemi nevojë për ndihmën tuaj

1 më, znj. Sekretare.

2 Z. Januzi, sikurse e dini dhe Mbrojtësi juaj sigurisht që
3 e di, Trupi Gjykses mund të miratojë marrëveshjen për pranimin
4 e fajësisë që është arritur midis ZPS-së dhe Mbrojtësit tuaj
5 në emrin tuaj nëse është bindur se janë përmbushur disa
6 kushte. Kështu kërkohet nga rregulla 94(5) e Rregullores.

7 Prandaj, unë do t'ju bëj disa pyetje dhe gjithashtu do
8 t'i bëj pyetje edhe ZPS-së edhe Mbrojtësit tuaj, sipas
9 nevojës, për të verifikuar se janë përmbushur të gjitha
10 kushtet e rregullës 94(5).

11 A e keni të qartë këtë, z. Januzi?

12 I AKUZUARI JANUZI: Po, të kqartë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 rregull.

15 Do të filloj së pari me rregullin 94(5)(a). Në
16 marrëveshjen për pranimin e fajësisë të nënshkruar prej jush
17 thuhet se i keni diskutuar kushtet e marrëveshjes me
18 Mbrojtësin tuaj dhe se marrëveshjen e keni pranuar pas
19 konsultimeve të mjaftueshme me Mbrojtësin. I referohem
20 paragrafit 6, 19 dhe 24 të marrëveshjes për pranimin e
21 fajësisë.

22 Z. Januzi, a mund të konfirmoni se kështu ka qenë?

23 I AKUZUARI JANUZI: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit. Tani do të kaloj tek rregulla 94(5) nënpikat (b)

1 dhe (c). Në këtë kontekst, do t'i kalojmë bashkë me ju kushtet
2 e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në mënyrë që Trupi
3 Gjykses të mund të vlerësojë se i kuptoni kushtet e
4 marrëveshjes së fajësisë dhe se pajtoheni me ato kushte.
5 Domethënë, unë dua të di në qoftë se i keni kuptuar ato kushte
6 dhe në qoftë se jeni pajtuar me to.

7 Z. Januzi, a konfirmoni se e keni shikuar, shqyrtuar me
8 kujdes me Mbrojtësin tuaj çdo pjesë të marrëveshjes për
9 pranimin e fajësisë në një gjuhë që e kuptoni dhe se i kuptoni
10 kushtet e kësaj marrëveshjeje sikurse specifikohen në
11 paragrafin 24 të saj?

12 I AKUZUARI JANUZI: Po, e konfirmoj.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Domethënë, e konfirmoni se i kuptoni, se jeni njoftuar me të
15 në gjuhë që e kuptoni dhe, domethënë, kuptoni se çfarë thuhet
16 në të dhe i kuptoni gjithashtu edhe kushtet e paraqitura në
17 marrëveshje?

18 I AKUZUARI JANUZI: Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit. Tani do të kalojmë tek rregulla 94(5)(c) në
21 lidhje me faktet që i keni pranuar ju, z. Januzi, mbi të cilat
22 bazohen akuzat që përmban marrëveshja për pranimin e fajësisë.
23 Do të fillojmë me Shtojcën 1 të marrëveshjes për pranimin e
24 fajësisë, që është në faqen 12 të parashtrimit përkatës, ku
25 është e paraqitur baza faktike për të cilën palët kanë rënë

1 dakord.

2 Në qoftë se kjo mund të vendoset në ekran në shqip dhe në
3 anglisht. Ju faleminderit.

4 Z. Januzi, do t'ju lexoj, do ta lexoj bazën faktike për
5 të cilat palët kanë rënë dakord:

6 "I pandehuri Sabit Januzi pranon se ishte pjesë e një
7 grupi që kërkonte të nxiste Dëshmitarin 1 që të mos jepte
8 dëshmi para Dhomave të Specializuara të Kosovës përmes
9 premtimit të përfitimit. Në veçanti, anëtarët e grupit - duke
10 vepruar nën drejtimin e Haxhi Shalës - i shkuan Dëshmitarit 1
11 në shtëpinë e tij përkatësisht më 5 dhe 12 prill 2023. Gjatë
12 vizitës së 5 prillit 2023 ... Ismet Bahtijari i tha
13 Dëshmitarit 1 se ai duhej të tërhiqte dëshminë e tij para
14 Dhomave të Specializuara të Kosovës. Gjatë vizitës së 12
15 prillit 2023, i pandehuri Sabit Januzi në vijim të vizitës së
16 parë i transmetoi Dëshmitarit 1 një ofertë që Haxhi Shala dhe
17 të tjerët do ta ndihmonin atë nëse do të tërhiqte dëshminë e
18 tij. Para dhe pas vizitave më 5 prill dhe 12 prill 2023, i
19 pandehuri Sabit Januzi komunikoi dhe koordinoi me anëtarët e
20 tjerë të grupit për ndërveprimet e tyre me Dëshmitar 1."

21 Z. Januzi, a e konfirmoni marrëveshjen në lidhje me bazën
22 faktike për të cilën palët kanë rënë dakord, ashtu sikurse ua
23 lexova tash?

24 I AKUZUARI JANUZI: Po, e konfirmoj.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Tani do të vazhdoj me leximin, meqë përmenden paragrafin
3 3 të marrëveshjes, do të vazhdoj, pra, me leximin e
4 paragrafëve 8, 9, 13 deri në 18 dhe 24(I), (II), (III), pra,
5 pra me një (i), (ii) dhe (iii) të Aktakuzës së Konfirmuar të
6 datës 10 korrik 2024.

7 Do të filloj me paragrafin 8 të Aktakuzës së Konfirmuar
8 dhe do t'i kërkoj Sekretares që në ekran të vendosë versionet
9 në shqip dhe në anglisht. Faleminderit.

10 A e shikoni dokumentin përpara vetes në ekran? Pra, të dy
11 versionet, tekstin e Aktakuzës së Konfirmuar, z. Januzi?

12 I AKUZUARI JANUZI: Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 rregull. Faleminderit.

15 Paragrafi 8 i Aktakuzës së Konfirmuar të datës 10 korrik
16 thotë si vijon:

17 "Më 5 prill 2023, Shala i telefonoi Januzit. Më pas edhe
18 Bahtijari i telefonoi Januzit."

19 Dhe tani do të kalojmë tek paragrafi 9:

20 "Pasi i telefonoi dhe u siguroa që Dëshmitari 1 ishte në
21 shtëpi, Bahtijari shkoi në shtëpinë e Dëshmitarit 1. Bahtijari
22 i tha Dëshmitarit 1 se Shala e kishte kontaktuar kohët e
23 fundit dhe e kishte dërguar që t'i thoshte Dëshmitarit 1 se
24 duhet të tërhiqte dëshminë."

25 Tani do të kalojmë tek paragrafi numër 13:

1 "Më vonë, më 5 prill 2023, pasi Bahtijari kishte vizituar
2 Dëshmitarin 1, Shala dhe Januzi, si dhe Januzi dhe Bahtijari
3 individualisht patën kontakte të shumta me mesazhe dhe
4 telefon, ku përfshihen edhe kontaktet midis Shalës dhe Januzit
5 për bashkërendimin e një takimi personal atë natë."

6 Dhe pastaj paragrafi 14:

7 "Gjatë ditëve në vijim, Shala dhe Januzi, ndër të tjerë,
8 mbetën në kontakt dhe u lidhën edhe përmes telefonit së paku
9 katër herë midis 6 prillit dhe 9 prillit 2023.

10 "Më 12 prill 2023", jemi tash te paragrafi 15, "pak pasi
11 i kishte telefonuar Shalës, Januzi shkoi në shtëpinë e
12 Dëshmitarit 1. Në shtëpinë e Dëshmitarit 1, Januzi i tha
13 Dëshmitarit 1 se Shala i kishte kërkuar Januzit të vinte aty
14 në vijim të vizitës së Bahtijarit për të mësuar se çfarë
15 planifikonte të bënte Dëshmitari 1 dhe mund të zgjidhej
16 çështja e dëshmisë së tij.

17 "Konkretisht, Januzi i tha Dëshmitarit 1 se Shala i
18 kishte kërkuar Januzit që të përcillte mesazhin se nëse
19 Dëshmitari 1 do të tërhiqte dëshminë, Shala dhe persona të
20 tjerë të papërmendur me emër do t'i ofronin 'ndihmë'.
21 Dëshmitari 1 u përgjigj se në qoftë se Shala dhe/ose të tjerët
22 do t'i jepnin atij 200.000 euro, do të arrihej ujdia."

23 Tash jemi tek paragrafi 17:

24 "Dëshmitari 1 nuk konfirmoi e as mohoi se ishte
25 dëshmitar. Januzi tha që do t'u tregonte 'atyre' se çfarë

1 kishte thënë Dëshmitar 1.”

2 Paragrafi 18.

3 “Pak pas vizitës së 12 prillit 2023 që i bëri Dëshmitarit
4 1, Januzi i telefonoi sërish Shalës.”

5 Dhe tani shkojmë tek paragrafi 24(i):

6 “Më 5 prill 2023, me udhëzim të Shalës, Bahtijari
7 kontaktoi Dëshmitarin 1 dhe (i) i tha Dëshmitarit se
8 Dëshmitari 1 duhet të tërhiqte dëshminë në proceset e DSK-
9 së.”

10 “Më 12 prill 2023, me udhëzim të Shalës, Januzi kontaktoi
11 Dëshmitarin 1 në vijim të kontaktit të mëhershëm të Bahtijarit
12 për t’i komunikuar Dëshmitarit ofertën se Shala dhe persona të
13 tjerë të papërmendur me emër, do ta ndihmonin Dëshmitarin 1
14 nëse ai pranonte të hiqte dëshminë e tij.”

15 (iii):

16 “Para dhe pas kontakteve të tyre me Dëshmitarin 1, Januzi
17 dhe Bahtijari komunikuan dhe bashkërenduan me njëri-tjetrin
18 dhe me Shalën.”

19 Kjo ishte përmbajtja e paragrafëve të Aktakuzës së
20 Konfirmuar e datës 10 korrik 2024.

21 Tani do të kaloj te paragrafi 5 i marrëveshjes për
22 pranimin e fajësisë, ku thuhet si vijon.

23 Do të presim për një moment që t’i kemi para nesh
24 paragrafët e duhur. Faleminderit, znj. Sekretare.

25 “Sabit Januzi dhe Prokuroria pajtohen që nëse Prokuroria

1 do të bënte paraqitjen e provave, atëherë faktet dhe akuzat e
2 përcaktuara në paragrafët," dhe ato paragrafë posa ua lexova,
3 "pra, 8, 9, 13 deri në 18 dhe paragrafin 24 nënparagrafët (i),
4 ii dhe iii) të Aktakuzës së datës 10 korrik do të
5 vërtetoheshin jashtë dyshimit të arsyeshëm dhe se ato fakte
6 janë të vërteta dhe të sakta dhe nuk kundërshtohen nga Sabit
7 Januzi. Sabiz Januzi ruan të drejtën e tij për të kundërshtuar
8 çdo fakt dhe akuzë tjetër që përmban Aktakuza e datës 10
9 korrik 2024 dhe çdo konstatim që përmban ajo."

10 Z. Januzi, a e konfirmoni ju këtë deklaratë që posa ua
11 lexova?

12

13 I AKUZUARI JANUZI: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit.

16 Z. Januzi, Trupi Gjykses gjithashtu do të sigurohet se ju
17 jeni plotësisht i vetëdijshëm dhe në dijeni të akuzave që i
18 përmban marrëveshja për pranimin e fajësisë. Për këtë qëllim
19 do t'ju lexoj paragrafët 8 dhe 9 të vet marrëveshjes për
20 pranimin e fajësisë dhe gjithashtu edhe paragrafin 3 të kësaj
21 marrëveshjeje, sepse paragrafi 8 i referohet paragrafit 3.

22 Tash jemi te paragrafi 3 prej aty do të lexoj:

23 "Sabit Januzi bie dakord të pranojë fajin para Trupit
24 Gjykses në përputhje me rregullat 92 deri në 94 të Rregullores
25 në lidhje me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës të datës 10

1 korrik 2024 në masën që ata pretendojnë në Pikën Dy (2) pengim
2 të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare duke marrë
3 pjesë në aksionin e përbashkët të një grupi midis më së paku 5
4 prillit dhe 12 prillit 2023, e ndëshkueshme sipas Kodit Penal
5 të Kosovës ('KPK') nenet 17, 21, 28, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5)
6 dhe nenet 15(2) dhe neni 16(3) të ligjit për Dhomat e
7 Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji')
8 dhe në Pikën Tre (3), frikësim gjatë procedurës penale me anë
9 të premtimit për dhuratë ose formë tjetër të përfitimit së
10 paku midis 5 prillit dhe 12 prillit 2023 e ndëshkueshme sipas
11 Kodit Penal të Kosovës ..."

12 Tani kalojmë në paragrafin 8 po në të njëjtin dokument që
13 thotë kështu:

14 "Sabit Januzi e kupton plotësisht se ai po pranon
15 fajësinë në lidhje me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës,
16 siç përshkruhet më lart dhe konkretisht pranon sjelljen e tij
17 të përcaktuar në paragrafët 8, 9, 13 deri në 18 dhe 24
18 (kufizuar nënparagrafët i(i), ii, dhe iii) të Aktakuzës dhe
19 siç përshkruhet më tej në bazat faktike të rëna dakord."

20 Dhe paragrafi 9, që është gjithashtu i rëndësishëm për sa
21 i përket natyrës së veprave penale dhe paragrafi 9 thotë
22 kështu:

23 "Sabit Januzi e kupton se nëse do të zhvillohej gjykimi,
24 Prokurorisë do t'i kërkohej të provonte elementët e mëposhtëm
25 të neneve 21, 397, 401(2) dhe (5), jashtë dyshimit të

1 arsyeshëm.”

2 Për Pikën Dy (2), nën pikën (a) është:

3 “Pjesëmarrja në një grup personash, i cili përmes
4 veprimit të përbashkët pengon ose tenton të pengojë një person
5 zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.” Sipas nenit 401(2) e
6 Kodit Penal të Kosovës.

7 “Vepra penale është kryer ndaj një gjyqtari, prokurori,
8 zyrtari të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë ose ndaj një
9 personi të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria ose ndaj një
10 oficeri policie në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.” Neni
11 401(5) e KPK-së.

12 Dhe “vetëdija dhe dëshira për të kryer aktin ose vetëdija
13 se një pasojë e ndaluar mund të ndodhë si rezultat i veprimit
14 ose mosveprimit dhe bashkimit në ndodhjen e tij”. Ky është
15 neni 21 i Kodit Penal të Kosovës.

16 Ndërsa për Pikën Tre (39 të Aktakuzës “është përdorimi i
17 forcës ose kërcënimit të rëndë ose ndonjë mënyrë tjetër të
18 detyrimit, premtimi për dhuratë ose në ndonjë formë tjetër
19 përfitimi”, që është neni 387 i KPK-së.

20 Në pikën (b), është “që të nxisë një person tjetër që të
21 mos jepte deklaratë ose të jepte deklaratë të rreme ose të mos
22 jepte informacion të vërtetë policisë, prokurorit, gjykatësit
23 dhe ky informacion ka të bëjë me pengimin e procedurës
24 penale.” Që është përsëri neni 387 i Kodit Penal të Kosovës.

25 Dhe pika (c) është, “vetëdija dhe dëshira për të kryer

1 aktin ose vetëdija se një pasojë e ndaluar mund të ndodhë si
2 rezultat i veprimit ose mosveprimit dhe bashkimit me ndodhjen
3 e këtij.” Neni 21 i Kodit Penal të Kosovës.

4 Z. Januzi, a pajtoheni që jeni dakord me këto, a mund të
5 konfirmoni që jeni dakord me këto akuza?

6 I AKUZUARI JANUZI: Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Për sa i përket pranimit të fajësisë, unë do të lexoj
10 paragrafët 3 dhe 7 të marrëveshjes për pranimi e fajësisë që
11 është pjesërisht përsëritje e asaj që lexova pak përpara por
12 është në kontekst tjetër. Paragrafi 3:

13 “Sabit Januzi bie dakord të pranojë fajin para Trupit
14 Gjykes në përputhje me rregullën 94 të Rregullores në lidhje
15 me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës, të datës 10 korrik
16 2024, në masën që ato pretendojnë, në Pikën Dy (2), pengim të
17 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të zyrtare duke marrë
18 pjesë në veprimin e përbashkët të një grupi midis së paku 5
19 prillit dhe 12 prillit 2023, e dënueshme sipas Kodit Penal të
20 Kosovës ... nenet 17, 21, 28, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5) dhe
21 nenet 15(2) dhe 16(3) të ligjit për Dhomat e Specializuara
22 dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe për Pikën Tre (3),
23 frikësim gjatë procedurës penale me anë të premtimit për
24 dhuratë ose çfarëdo forme tjetër përfitimi midis së paku 5
25 prillit dhe 12 prillit 2023, e dënueshme sipas neneve që u

1 përmendën ...”

2 Z. Januzi, a konfirmoni se pajtoheni me këto, pra, ju
3 pranoni fajësinë në lidhje me këto dy pika?

4 I AKUZUARI JANUZI: Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Atëherë të kalojmë tek paragrafi 7:

7 “Z. Sabit Januzi bie dakord të pranojë fajësinë në lidhje
8 me akuzat e identifikuara në paragrafin 3 më lart sepse ai në
9 fakt është fajtor dhe pranon fajin e tij dhe pranon
10 përgjegjësinë e plotë për sjelljen e tij siç përshkruhet në
11 bazën faktike të rënë dakord.”

12 Z. Januzi, a konfirmoni se pajtoheni në lidhje me këtë
13 pikë?

14 I AKUZUARI JANUZI: Po, konfirmoj.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Januzi, Trupi Gjykes mban shënim pajtimin tuaj në lidhje me
17 këto pika dhe do t’ju kërkoj pak më vonë që të konfirmoni
18 zyrtarisht që të vetëdeklaroheni zyrtarisht në lidhje me këto
19 pika.

20 Për sa i përket dënimit.

21 Për sa i përket, z. Januzi, unë lexova në paragrafin 11
22 të marrëveshjes për pranimin e fajësisë se ju pajtoheni me
23 dhënien e një dënimi në midis 24 dhe 30 muaj burgim. Dhe
24 marrëveshja gjithashtu thotë, në paragrafin 16, se në këmbim
25 për pranimin e fajësisë ZPS-ja do t’i rekomandoj Trupit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë mbi Marrëveshje për Pranimin e Fajësisë (Seancë e hapur) Faqe 107

1 Gjykues një dënim brenda shkallëzimit 24 deri 30 muaj burgim
2 dhe do të rekomandojë që të quhet apo të llogaritet koha të
3 cilën tashmë e keni kaluar në burgim të Dhomave të
4 Specializuar të Kosovës.

5 Dhe sipas paragrafit 16(c) të marrëveshjes, ZPS-ja
6 gjithashtu pajtohet që të heqë akuzën numër 1 kundër jush, z.
7 Januzi. Z. Januzi, a e konfirmoni këtë?

8 I AKUZUARI JANUZI: Po, e konfirmoj.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Tani të kaloj në paragrafin 12 të marrëveshjes për
12 pranimin e fajësisë që ka të bëjë me mjetet juridike.

13 Dhe fillimisht them që ZPS-ja ka tërhequr kërkesën për
14 rishqyrtim apo për të kërkuar leje për apelim të vendimit
15 F00612. Që është vendimi F631 i datës 16 dhjetor 2024. Si
16 rezultat, paragrafi 12 i marrëveshjes do të ndryshohet në
17 mënyrë që të jetë në përputhje me vendimin 612. Trupi Gjykues
18 do të japë një urdhër për këtë më vonë. Megjithatë, dua të
19 siguroj që ju e kuptoni sesi ndikon kjo te marrëveshja juaj.
20 Dhe që ju jeni dakord me këtë ndryshim, sigurisht, ju mund të
21 flisni, të konsultoheni me avokatin tuaj përpara se të jepni
22 përgjigjen.

23 Z. Januzi, a e kuptoni dhe a pajtoheni që në qoftë se
24 Trupi Gjykues e miraton marrëveshjen dhe cakton një dënim që
25 është në përputhje me kushtet e marrëveshjes për pranimin e

1 fajësisë, ju nuk do lejoheni që të bëni apel kundër atij
2 vendimi dhe, e dyta, që nuk do të bëni kërkesë që të tërhiqni
3 vendimin e fajësisë ose vetëdeklarimin e fajësisë dhe të bëni
4 apel kundër dënimit tuaj?

5 Pra, dua që të konfirmoni që i kuptoni dhe pajtoheni me
6 të dyja këto pika, z. Januzi? Dhe, sigurisht, mund të bisedoni
7 me avokatin tuaj përpara sesa të jepni përgjigje.

8 Z. REES: [Përkthim] Po, dua të flas me klientin. Po para
9 sesa ta bëj këtë dua një sqarim.

10 Paragrafi 12(a), mënyra sesi është hartuar e tani
11 përmendet "aktgjykimi apo vendimit për dënimin që përputhet me
12 rekomandimin në paragrafin 16(a)". Ndoshta nuk ka ndonjë
13 dallim midis kushteve që përmendët ju, e nderuar Gjykatës edhe
14 atyre, domethënë, në qoftë se Trupi Gjykues "përcakton një
15 dënim që është në përputhje me kushtet e marrëveshjes së
16 fajësisë."

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

18 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se është kështu, atëherë në
19 rregull. Po e vetmja arsye që e ngre këtë, e nderuar
20 Gjykatëse, është se në paragrafin 16(c) në faqen 8 nga 12, do
21 të shikoni se ekziston e drejta për apelimin e ndonjë vendimi
22 për zhdëmtime.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
24 në qoftë se e kam lexuar këtë, kjo është pyetje retorike në
25 fakt, po ZPS-ja dhe Mbrojtja e z. Januzi, ju jeni pajtuar me

1 "atë vendimin që do të jepet në atë kohë"?

2 Dhe ju fjala "dhënie dënimit". Dhe vendimi 612 e thotë
3 qartë që ne nuk do të imponojmë ndonjë gjë.

4 Kjo besoj që është një marrëveshje midis palëve edhe,
5 sigurisht, Trupi Gjykses në qoftë se nuk do të miratojë diçka
6 do t'i japi vendimet, ato parashtrimet edhe njëherë për t'u
7 ndryshuar.

8 Z. REES: [Përkthim] Po, po, patjetër. Po sigurisht ka një
9 dallim midis asaj që është arritur marrëveshje për dhënien e
10 dënimit që merret me rekomandimin edhe që kjo është në
11 paragrafin 16(a) dhe që është dënimi prej 24 deri 30 muaj.

12 Dhe pastaj e drejta për të apeluar vendimet në qoftë se
13 do të ketë ndonjë vendim për zhdëmtim.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 qoftë se ne do të imponojmë, në qoftë se ne do të japim një
16 vendim të tillë.

17 Z. REES: [Përkthim] Po. Desha vetëm që ta sqaroj këtë.

18 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Avokat, a konfirmoi që mund të vazhdojmë?

21 Z. REES: [Përkthim] Po, mund të vazhdohet.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Januzi, unë dua që të konfirmoni që e kuptoni dhe pajtoheni me
24 të gjithë këto pika që do të lexoj - më falni - këto dy pikat
25 më lart, a pajtoheni me ato që u përmendën më lart?

1 I AKUZUARI JANUZI: Po, pajtohem.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
3 të qenë e sigurtë. A jeni dakord, pra, për të qenë të sigurtë
4 që në qoftë se Trupi Gjykses miraton këtë marrëveshje për
5 pranimin e fajësisë dhe cakton një dënim që përputhet me
6 kushtet e marrëveshjes së fajësisë, ju nuk mund të kërkon
7 apel? Pajtoheni me këtë?

8 I AKUZUARI JANUZI: Të kuptoj dhe pajtohem.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
10 njëjta dhe për të dytën, që nuk do të bëni kërkesë që ta
11 tërhiqni vetëdeklarimin si fajtor apo të bëni apel kundër
12 vendimit të fajësisë që do jepet? A e kuptoni dhe a pajtoheni
13 me këtë?

14 I AKUZUARI JANUZI: E kuptoj dhe pajtohem.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Nga e Prokurorisë, paragrafi 16 i marrëveshjes për
18 pranimin e fajësisë. Ju vë në dukje paragrafin 16 si pika (a)
19 ashtu edhe pika (b), pra, që do të tërhiqet edhe nga ju
20 kërkesa për rishqyrtim dhe leje për apel.

21 Z. Januzi, sipas rregullës 94(5)(c), Trupi Gjykses duhet
22 të bindet se ju e keni bërë vetëdeklarimin dhe keni hyrë në
23 këtë marrëveshje me vullnetin tuaj të lirë. Në paragrafin 24
24 ju keni thënë "askush nuk më ka kërcënuar ose nuk më ka
25 detyruar në ndonjë mënyrë për të hyrë në këtë marrëveshje" dhe

1 "Unë ... kam hyrë në këtë marrëveshje, e kam bërë këtë
2 marrëveshje lirisht dhe në mënyrë vullnetare." Dhe Avokati
3 juaj në paragrafin 25 parashtrohet se vendimi juaj për të bërë
4 këtë marrëveshje është një vendim i bazuar "në informacion dhe
5 është bërë mbi baza vullnetare".

6 Z. Januzi, a mund t'i konfirmoni Trupit Gjykses se ju
7 jeni pajtuar me këtë marrëveshje në mënyrë vullnetare, pa
8 kërcënim dhe pa shtrëngim?

9 I AKUZUARI JANUZI: Po, znj. Gjyqtare. E konfirmoj se në
10 këtë marrëveshje kam hyrë pa presionin e askujt dhe pa asnjë
11 lloj kërcënimi, me vullnetin tim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit. E shënuam.

14 Të kalojmë në pikën tjetër. Trupi Gjykses dëshiron të
15 konfirmojmë, z. Januzi, se ju i kuptoni pasojat e marrëveshjes
16 për pranimin e fajësisë dhe se ju hiqni dorë nga e drejta për
17 t'u gjykuar sipas procedurës së zakonshme të gjykimit sipas
18 rregullës 94(5)(d).

19 Në lidhje me këtë, z. Januzi, ka disa hapa dhe ne do t'i
20 kalojmë së bashku ato.

21 Së pari, do të lexoj paragrafin 17(a) deri në (f) dhe
22 paragrafin 18(a) deri në (c) të marrëveshjes, sepse këto
23 paragrafë përmbledhin të drejtat nga të cilat ju hiqni dorë
24 dhe të drejtat që do vazhdoni t'i gëzoni në bazë të kësaj
25 marrëveshjeje.

1 Z. Januzi, mbi bazën e kësaj marrëveshjeje ju do të hiqni
2 të drejtën, pjesërisht ose plotësisht, nga mundësia për të
3 ushtruar këto të drejta. Dhe do të lexoj paragrafin 17(a):

4 Është e drejta për t'u deklaruar i pafajshëm dhe për të
5 kërkuar nga Prokuroria që të vërtetojë akuzat në Aktakuzë
6 jashtë dyshimit të arsyeshëm në një gjykim publik, të drejtë
7 dhe të paanshëm;

8 E drejta për t'u gjykuar në praninë tuaj dhe për t'u
9 mbrojtur nga një mbrojtës i specializuar në një gjykim të
10 tillë;

11 E drejta për të ngritur mbrojtje dhe për të paraqitur
12 arsye për përjashtimin e përgjegjësisë penale dhe për të
13 paraqitur prova të pranueshme në një gjykim të tillë pa
14 paragjykuar ushtrimin e së drejtës për të bërë parashtrime dhe
15 për të paraqitur prova në lidhje me dënimin;

16 E drejta që të mos detyroheni të dëshmoni kundër vetes
17 ose të pranoni fajin;

18 Dhe e drejta për të marrë në pyetje ose për pasur, për të
19 marrë në pyetje në emrin tuaj dëshmitarë kundër jush dhe për
20 të siguruar pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve
21 në emrin tuaj në të njëjta kushte si dëshmitarët kundër jush,
22 pa paragjykuar ushtrimin e së drejtës tuaj për të marrë në
23 pyetje çdo dëshmitar që mund të thirret për të dëshmuar dhe të
24 drejtën për të thirrur dëshmitarë dhe për ta marrë atë në
25 pyetje në emrin tuaj në çdo procedurë të lidhur me dënimin;

1 dhe

2 E drejta për të ndjekur mjete juridike të apelit lidhur
3 me vendimin e fajësisë apo për caktimin e dënimit siç është
4 specifikuar në paragrafin 12 më lart.

5 Z. Januzi, a mund të kem konfirmimin tuaj se ju i kuptoni
6 këto dhe hiqni dorë nga këto të drejta?

7 I AKUZUARI JANUZI: Po, e kuptoj dhe vullnetarisht heq
8 dorë nga këto të drejta.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së
10 dyti, sipas kushteve të marrëveshjes për pranimin e fajësisë,
11 z. Januzi, paragrafi 18, tani, aty e kam fjalën, kuptohet se
12 ju do të ruani të gjitha të drejtat e tjera, duke përfshirë,
13 në veçanti, të drejtën për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës i
14 specializuar në të gjitha fazat e kryerjes së procedurës dhe
15 për të komunikuar lirshëm me mbrojtësin në mirëbesim dhe të
16 drejtën për të paraqitur çdo informacion ose provë relevante
17 për përcaktimin e dënimit në përputhje me rregullën 162(1) dhe
18 (5) të Rregullores dhe e drejta për të paraqitur apel për çdo
19 zhdëmtim në qoftë se do të jepet vendim për këtë në këtë rast.

20 A e kuptoni këtë?

21 I AKUZUARI JANUZI: Po, e kuptoj.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
23 Prokurore, keni fjalën.

24 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Pasi dëgjova shkëmbimet
25 tuaja me z. Januzi, është pozicioni Prokurorit të Specializuar

1 që janë plotësuar kushtet e paragrafit 94(5) përfshirë edhe
2 pjesët (e) dhe (f).

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Z. REES: [Përkthim] Ne jemi në të njëjtin qëndrim. Ne
6 shohim që ZPS-ja në parashtrimet me shkrim, që është dokumenti
7 F00618, dhanë edhe hollësitë tjera në lidhje me vlerësimin për
8 sa i përket rregullës 94(5)(f) sidomos. Dhe nuk kemi asgjë
9 tjetër por vetëm që ne kemi të njëjtin qëndrim edhe si për
10 nënrregullën (e) dhe (f).

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Z. Januzi, pasi dëgjuat çfarë thanë përfaqësuesi i
14 Prokurorisë edhe Mbrojtësi juaj, a mund të na konfirmoni edhe
15 një herë që i kuptoni të gjitha pasojat e kësaj marrëveshjeje
16 dhe se nuk dëshironi të ndryshoni asgjë në këtë marrëveshje
17 për pranimin e fajësisë.

18 Ju keni fjalën, z. Januzi.

19 I AKUZUARI JANUZI: Po, znj. Gjyqtare. I kuptoj të gjitha
20 pasojat dhe nuk heq dorë nga -- se e konfirmoj të njëjtën.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
22 dëshiron të ndërrosh asgjë.

23 I AKUZUARI JANUZI: Nuk dëshiroj të ndërroj asgjë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Januzi, gjatë seancave të 9 tetorit 2023 dhe 12 korrikut 2024,

1 ju u vetëdeklaruat i pafajshëm ndaj akuzës së tentimit për
2 pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare me
3 pjesëmarrjen në një grup, me veprimin e përbashkët të një
4 grupi sipas Pikës 2 në Aktakuzën e Konfirmuar të 4 tetorit
5 2023 dhe akuzën e frikësimit gjatë procedurës penale sipas
6 Pikës 3 të Aktakuzës së 10 korrikut 2024.

7 Jeni tani i gatshëm që të ndryshoni këtë vetëdeklarim?

8 I AKUZUARI JANUZI: Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit. Atëherë do të vazhdoj dhe do të lexoj Pikat 2
11 dhe 3 që janë reflektuar në Aktakuzën e datës 10 korrik 2024,
12 ju lutem mund të çoheni në këmbë kur t'jua lexoj këtë.
13 Faleminderit.

14 Pika 2: Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave
15 zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të
16 një grupi, midis së paku 5 dhe 12 prillit 2023, vepër penale
17 kundër rendit publik, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21,
18 28, 33, 35, 401(2) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës dhe
19 neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

20 Z. Januzi, si vetëdeklaroheni, fajtor apo i pafajshëm?

21 I AKUZUARI JANUZI: Fajtor. Fajtor.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
23 vazhdojmë me Pikën 3: Frikësim gjatë procedurës penale midis
24 së paku 5 dhe 12 prillit 2023, vepre penale kundër
25 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, e

1 ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 31 33, 35 dhe 387 të
2 Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe neneve 15(2), 16(3)
3 të Ligjit.

4 Z. Januzi, si vetëdeklaroheni në lidhje me këtë, fajtor
5 apo i pafajshëm?

6 I AKUZUARI JANUZI: Fajtor.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Z. Januzi, mund të uleni.

10 Përpara sesa të kalojmë tek dhënia e dënimit ose
11 parashtrimet në lidhje me dënimin, dëshiroj të diskutoj
12 shkurtimisht çështjen e zhdëmtimeve.

13 Trupi Gjykes vëren, i nderuar Avokat, që sipas Mbrojtjes
14 se zhdëmtimet nuk janë të zbatueshme dhe nuk janë të
15 përshtatshme në mungesë të një dëmi në lidhje me Dëshmitarin
16 1. Ky është parashtrimi 617, që keni dorëzuar ju.

17 Doni të shtoni diçka ndaj kësaj?

18 Z. REES: [Përkthim] Po. Kisha ndërmend që ta trajtoja
19 këtë çështje dhe desha të them edhe disa gjëra në përgjithësi
20 në lidhje me parashtrimet e ZPS-së. Nuk e di mund ta bëj tani
21 apo dëshironi që t'i bëj këto parashtrime më vonë kur të vijë
22 kjo pikë e rendit të ditës.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
24 trajtojmë çështjen e zhdëmtimeve tani, sepse në këtë mënyrë do
25 t'i lejojmë edhe Prokurorisë që të japi mendimet e saj në

1 lidhje me këtë çështje dhe të ketë shkëmbime të tjera
2 pikërisht për këtë.

3 Z. REES: [Përkthim] Për sa i përket çështjes së
4 zhdëmtimeve, ajo është e lidhur ngushtë me çështjen e dëmit të
5 shkaktuar. Neni 22(3) i Ligjit thotë që zhdëmtimet janë të
6 zbatueshme vetëm kur një person ka vuajtur dëm që është
7 shkaktuar drejtpërdrejt nga krimi që është kryer nga të
8 akuzuarit. Dhe në rastin tonë, vetëm për këto dy pika të
9 Aktakuzës për të cilat ai tha jam fajtor, vetëm ato janë
10 relevante.

11 E para, Pika 1, është një veprë penale e drejtuar kundër
12 ZPS-së dhe thjesht është penguar puna e saj, puna e ZPS-së në
13 lidhje me këtë.

14 Dhe Pika 2 e Aktakuzës ka të bëjë me veprën penale që
15 parashikohet në nenin 387 të Kodit Penal të Kosovës, që ai u
16 deklarua fajtor për këtë dhe kjo përfshihet edhe në bazën
17 faktike. Gjëja e parë që do të themi për bazën faktike mbi të
18 cilën është bërë marrëveshja është se kemi vetëm një person që
19 mund të përshkruhet në mënyrë të duhur si viktimë i veprave
20 penale, i referohet atij si Dëshmitar 1 që është i pranishëm
21 në këtë pikë. Asgjë nuk është bërë, nuk është bërë asgjë
22 marrëveshje lidhur me këtë.

23 Sa i përket Dëshmitarit 1, Dëshmitari 1 vetëm, pra,
24 zhdëmtimet do të ishin të përshtatshme apo të duhura në qoftë
25 se do të vërtetohej që Dëshmitari 1 ka pësuar dëm të

1 drejtpërdrejtë si rezultat i ndihmës së ofruar atij, pra, në
2 qoftë se po të tërhiqte dëshminë e tij. Dhe nuk ka prova që
3 mbështesin një përfundim të tillë. Në faktin, nuk është as
4 pretendim ky, nuk është bërë as pretendim.

5 Dhe do të merrem në të njëjtën kohë edhe me çështjen e
6 dëmit sepse është një nga dy çështjet. Pra, dëmi dhe zhdëmtimi
7 janë çështje që janë drejtpërdrejt të lidhura.

8 Në fazat e hershme sot, z. Devaney u referua provave që
9 janë nxjerrë. Mendoj që e di se për çfarë e kishte fjalën. E
10 kishte fjalën për transkriptet e intervistës së dëshmitarit,
11 Dëshmitari 1, pra, që është Dëshmitari W04891.

12 Dhe në fazat e hershme, jam i sigurtë që ju kujtohet edhe
13 juve, Prokuroria kishte bërë kërkesë për pranimin e
14 transkripteve të Dëshmitarit W04981 si dëshmi e re në vend, si
15 prova në vend të dëshmisë së dhënë me gojë. Kjo kërkesë nuk u
16 pranua.

17 Dhe nuk kishte prova qoftë nga Dëshmitari 1 apo nga
18 Dëshmitari W04891.

19 Sa i takon parashtrimeve të Prokurorisë lidhur me dëmin,
20 mund të shikoni, po t'i hidhni një sy paragrafit 23 të
21 parashtrimit F00618, në veçanti në krye të faqes 8 të këtij
22 dokumenti -- është faqja 9 e dokumentit tjetër, dokumenti 8
23 është dokumenti thelbësor. Por do të shihni aty shumë të qartë
24 se Prokuroria ishte e mendimit, qëndrimi i tyre, i bazuar edhe
25 në marrëveshjen për fajësinë, ishte që dëshmia nuk ishte e

1 nevojshme në këtë rast sepse, siç thanë ata, "baza faktike e
2 siguruar nga secili i akuzuar ishte e qartë dhe e
3 mjaftueshme". Dhe ne u pajtuam tërësisht me këtë. U pajtuam,
4 kishte rënie dakord lidhur me këtë për sa i takon, pra, bazës
5 faktike, siç e tha Prokuroria sot, kishin gjithçka që u duhej,
6 që u nevojitej, që këërkohej dhe për rrjedhojë për nevojat e
7 përcaktimit të dënimit sipas kësaj marrëveshjeje.

8 Tani do t'i referohem shkurtimisht aktakuzës së rishikuar
9 të datës 17 dhjetor për të cilën biseduam sot në mëngjes sepse
10 edhe pse ju vendosët, e nderuar Gjykatëse, që sot paradite dhe
11 pasdite do të trajtonit z. Shala dhe z. Januzi duke u kthyer
12 tek aktakuza e datës 10 korrik drejtpërdrejt, aktakuza e
13 rishikuar më tej, e cila është dorëzuar dje, na ndihmon
14 gjithsesi sepse ashtu siç pajtohet Mbrojtja dhe Prokuroria ajo
15 pasqyron përmbajtjen e marrëveshjes së fajësisë e rishikuar më
16 tej.

17 Dhe pa iu referuar drejtpërdrejt dokumentit, ju keni
18 konstatuar sot në mëngjes kur më bëtë pyetjen pse paragrafët
19 11, 19 në veçanti, siç paraqiten në aktakuzën e rishikuar të 6
20 dhjetorit, janë ekuivalentë të paragrafëve që janë
21 ekuivalentet e tyre në aktakuzën e 10 korrikut 2024, ishin
22 fshirë.

23 Përgjigja e asaj, së bashku me ndryshimet, ishte se ishin
24 fshirë sepse nuk ishin pjesë e çështjes për të cilën është
25 bërë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe që, domethënë, që

1 dikush të ketë pësuar frikë apo shqetësim.

2 Dhe, për shembull, që të më jepni pak kohë. Referencat në
3 aktakuzë për dëshmitarë që mund, që ka pësuar frikë apo
4 shqetësim janë fshirë nga marrëveshja sepse faktet e tilla nuk
5 paraqiten në asnjë prej paragrafëve qoftë të Aktakuzës së 10
6 korrikut 2024 apo as të cilën z. Januzi e ka pranuar dhe në
7 bazën faktike të pranuar është shtojca e marrëveshjes për
8 pranimin e fajësisë.

9 Gjithashtu është arritur marrëveshje për fshirjen, pra,
10 heqjen e referenca që kanë të bëjnë me qëllimin për të
11 frikësuar dëshmitarë nga aktakuza e rishikuar përsëri sepse
12 ajo pasqyron vetëm synim dhe sipas marrëveshjes për pranimin e
13 fajësisë është synim për të shtyrë dëshmitarin, për të nxitur
14 Dëshmitarin 1 që të tërhiqte dëshminë e tij ose që të mos
15 jepte dëshmi në procedurat zyrtare të ZPS-së.

16 Dhe është marrë vesh, pra, është arritur marrëveshje të
17 fshihen këto referenca, referenca ku përmendet vënia e
18 presionit apo presioni ndaj Dëshmitarit 1 për të ndryshuar dhe
19 mohuar deklaratën e tij. Kjo është fshirë sepse, në pajtim me
20 marrëveshjen për fajësinë, dëshmitari nuk ka pësuar presion
21 por në fakt kjo është shënuar aty.

22 Dhe është pranuar dhe arritur marrëveshja të fshihet
23 referenca "kontakt i padëshiruar" që ka pas Dëshmitari 1.
24 Sepse ky kontakt, në fakt, është bërë në bazë të ftesës së
25 Dëshmitarit 1, Dëshmitari 1 ka ftuar z. Januzi tek adresa e

1 vendbanimit të tij më 12 prill 2023 dhe kur ishte i pranishëm
2 në shtëpi sepse Dëshmitari 1 kishte thënë atij që të vinte në
3 atë vend.

4 Dhe ne themi këtu që nuk ka provë dëmi, sigurisht nuk ka
5 prova të dëmit të drejtpërdrejtë që rezulton nga oferta e
6 ndihmës që është ofruar Dëshmitarit 1. Dhe, për rrjedhojë, në
7 pajtim me nenin 22, zhdëmtimi nuk mund të jetë i zbatueshëm në
8 mungesë të dëmit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Ia jap fjalën Prokurorisë tani.

12 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Sa i takon zhdëmtimeve, ZPS-
13 ja do të propozonte që të mos bëjë parashtime në këtë kohë
14 duke patur parasysh urdhrin gojor të nxjerrë sot në mëngjes i
15 cili e referon këtë çështje tek Zyra për Mbrojtjen e
16 Viktimave. Dhe ata do të kenë mundësinë që të përgjigjen, pa,
17 në momentin që do të kemi mundësinë që të përgjigjemi, në
18 momentin që zyra për Viktimat të ketë identifikuar viktimat
19 pjesëmarrëse dhe të nxjerrin raportin e tyre lidhur me,
20 domethënë, këtë do të paraqesin parashtimet tona nga sa u
21 takon pjesëve faktike më vonë. Në këtë moment, ne po flasim
22 për një situatë abstrakte, sepse nuk dimë nëse raporti do të
23 përmbajë ndonjë viktimë pjesëmarrëse.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit, Prokurore.

1 Tani kalojmë, z. Avokat, keni fjalën ju. Sepse e shoh që
2 jeni në këmbë.

3 Z. REES: [Përkthim] Po.

4 Tani mund të kaloj tek çështja e materialeve të siguruara
5 nga sistemi qendror i të dhënave i dëshmive të penaltetit të
6 sistemit të Kosovës.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kisha
8 një rend tjetër të ditës në mendje, por meqenëse e keni
9 fjalën, mund të diskutoni pjesën e dënimit.

10 Tani kalojmë tek parashtrimet e Mbrojtjes për dënimin, në
11 lidhje me dënimin.

12 Z. Januzi, unë kam një pyetje. Z. Januzi, kam një pyetje
13 për avokatin tuaj. Në qoftë se ndonjë gjë është e paqartë mund
14 të konsultoheni me të.

15 Z. Januzi, fillimisht do të diskutoj me avokatin tuaj
16 lidhur çështjen e dëshmisë së penaltetit tuaj.

17 Z. Avokat, ZPS-ja parashtroj dje dëshminë e penaltetit
18 të z. Januzi. Ky është parashtrimi i protokolluar 629, Shtojca
19 2. Nëse dëshironi të bëni ndonjë parashtrim lidhur me këtë
20 mund ose në seancë private na thoni.

21 Z. REES: [Përkthim] Dëshiroj të bëjë disa parashtrime.
22 Dëshiroj të shënohet publikisht në seancë publike se dje kemi
23 marrë një certifikatë, vërtetim nga sistemi qendror i dëshmive
24 të penaltetit në Kosovë, i datë s 6 dhjetor 2024, ku
25 vërtetohet se z. Januzi nuk ka, nuk ka qenë i dënuar më parë

1 përmes një vendimi të formës së prerë në Kosovë.

2 Do të doja në këtë fazë që të kalojmë në seancë private.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit, z. Avokat.

5 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

6 [Seancë private]

7 [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit.

15 Vërejmë parashtimet me shkrim të palëve lidhur me
16 dënimin. Përveç këtyre parashtimeve me shkrim, ftoj palët të
17 bëjnë parashtime me gojë apo komente në Gjykatë sot.

18 Konstatoj që Mbrojtësi i z. Januzi do të bëjë një gjë të
19 tillë, pastaj do t'ia jap fjalën Zyrës së Prokurorit të
20 Specializuar.

21 Z. Avokat, fjalën e keni ju.

22 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit. Desha të trajtojë në
23 mënyrë të drejtpërdrejtë disa prej çështjeve që i referohen
24 dëmit, thjesht shkurtimisht, çështje që përmbajnë parashtimet
25 me shkrim të Prokurorisë. Paragrafët janë 48, 49 veçanërisht.

1 Por më duket që duke patur parasysh qëndrimin e
2 Prokurorisë sot pasdite, këto Prokuroria nuk paraqet, nuk bën
3 parashtrime sa i takon dëmit, por po presin procedurat e
4 zhvilluara nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave dhe nuk kam
5 nevojë të trajtojë këtë pikë sot.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ua lë
7 juve, z. Avokat, nëse dëshironi të bëni parashtrimin mbi këtë
8 pikë, do t'iu konstatoj, në qoftë se dëshironi që të mos
9 vazhdoni, e kuptoj.

10 Z. REES: [Përkthim] Referoj Panelin tek këto çështje,
11 këto dy paragrafë. Dhe nuk dua të përsërisë atë që kam thënë
12 që për qëllime të nevojat të kësaj marrëveshjeje të fajësisë
13 nuk ka prova. Nuk pranim. Dhe nuk ka konstatime gjyqësore
14 sipas standardeve penale të provave të pranueshme lidhur me
15 përcaktimin apo vërtetimin e dëmit. Dhe në rrethana të tilla,
16 kjo duhet të hiqet sepse jemi në rrugë të gabuar sa i takon
17 këtyre dy paragrafëve.

18 Ne, natyrisht - ZPS-ja dhe Mbrojtja - jemi pajtuar për
19 një shkallë dënimi të duhur. Minimumi është 24 vite dhe
20 parashtrimi im është që ky është dënimi i duhur dhe i
21 përshtatshëm. Është dënimi minimum edhe pse ligji në Kosovë
22 përmban një dispozitë për një që Gjykatësi që përcakton
23 dënimin mund të shkojë edhe më poshtë se kjo, mund të japë
24 edhe dënim më ulët. Në rast kur ka karakteristika të veçanta
25 ose elementë të veçantë zbutës që mund ta justifikojnë një gjë

1 të tillë. Dhe në parashtrimet e mia kam thënë që dënimi i
2 duhur do të ishte 24 muaj.

3 Arsyeja është sepse nuk ka dyshim, z. Januzi po vepronte,
4 ka vepruar sipas udhëzimeve. Ndërsa Prokuroria u referohet
5 ndërhyrjeve të shumta me Dëshmitarin 1 - ata kur thonë "të
6 shumta", e kanë fjalën për dy - në fakt, z. Januzi ka qenë në
7 kontakt vetëm një herë me Dëshmitarin 1.

8 Dhe sjellja fajtor apo që përfshihet në Pikën 3 është,
9 ndihma e pasaktësuar, është ofrimi i pasaktësuar i ndihmës.
10 Kjo është sjellja për të cilën personi është fajtor. Nuk bëhet
11 fjalë për ofertë parash. Nuk ka qenë ofertë për një shumë
12 parash. Ka qenë një ofertë ndihme e pavlerësuar, e
13 papërcaktuar. Dhe parashtrimi jonë është që ky është
14 përkufizimi më i turbullt me kriteret më të ulëta të veprës
15 penale sipas -- të parashikuar nga neni 387 i Kodit Penal të
16 Kosovës.

17 Pas kësaj nxitjeje, oferte nxitjeje, Dëshmitari 1 vetë
18 pastaj kërkoi para. Pra, para nuk është që atij ju ofruan para
19 konkretisht, por ai kërkoi para. Dhe kërkoi një shumë dhe
20 shumë të konsiderueshme. Kjo shumë u refuzua. Dhe nuk u bënë
21 pastaj përpjekje të tjera për të nxitur dëshmitarin.

22 Sot në mëngjes z. Devaney sugjeroi që këtu, kjo është një
23 çështje ku bëhet fjalë për një marrëveshje, marrëveshja ishte
24 për të bërë që Dëshmitari 1 të mos jepte dëshmi me çdo kusht.
25 Kjo është qartësisht e pasaktë sepse oferta nuk ishte që

1 Dëshmitari -- se kjo ishte në fakt një ofertë e bërë që ai
2 tërhiqej në shkëmbim të shumës 200.000 euro dhe nuk ka patur
3 përpjekje të tjera.

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR] Shumën 200.000 eurosh nuk e mori dhe ndoshta kjo e
7 ka lënë atë të pakënaqur dhe të inatosur, por kjo nuk përbën
8 dëm për qëllime të zhdëmtimeve edhe qoftë edhe për përcaktimin
9 e dënimit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
11 lejoni t'ju ndërpres.

12 Znj. Sekretare -- po bëni pyetje për seancë private.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit.

11 E keni fjalën, z. Avokat.

12 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

13 Deri më tani u përqendrova tek Pika 3 edhe pse sjellja,
14 sjellja që u pranua dhe zbatohet për vetëdeklarimin e fajësisë
15 në lidhje me Pikën 3, është e njëjtë me sjelljen që lidhet dhe
16 me Pikën 2, mirëpo pasojat, ose pasojat e mundshme janë të
17 ndryshme.

18 Në lidhje me Pikën 2, në qoftë se i shikoni pasojat në
19 lidhje me SC apo zyrtarin e një e vet Prokurorisë apo të
20 këtyne dhomave. Ne themi se nuk është bërë kurrfarë sugjerimi
21 sigurisht që jo në bazë të ndonjë marrëveshjeje dhe se, në
22 fakt, as Zyra e Prokurorisë dhe as ndonjë zyrtar i kësaj
23 Gjykate, nuk është penguar në asnjë mënyrë apo vonuar në
24 kryerjen e detyrave të veta brenda kuadrit të punës së Dhomava
25 të Specializuara si rezultat i veprimeve të të akuzuarit.

1 Këto fjalë janë marrë nga Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore
2 në çështjen Gucati dhe Haradinaj, kur ata evidentuan se çfarë
3 është e nevojshme për t'u marrë parasysh kur gjykohet në qoftë
4 se pengimi ka ndodhur në fakt krahasuar me tentimin e atij
5 pengimi. Parashtrime të ngjashme ka bërë edhe z. Cadman sot në
6 mëngjes në lidhje me tentimin për pengim.

7 Në mënyrë të ngjashme, nuk ka pasur kurrfarë sugjerimi se
8 si rezultat i përdorimit apo shpenzimit të kohës dhe të
9 burimeve të ZPS-së se ajo u pengua apo vonua në kryerjen e
10 hetimeve të veta. Përsëri, këto fjalë janë marrë nga
11 aktgjykimi në Çështjen 07, Gucati dhe Haradinaj.

12 Në atë çështje, Trupi Gjykses e bëri të qartë se
13 dëshmitarët apo kontaktet me dëshmitarët e ZPS-së bëhen çdo
14 ditë. Dhe në këtë çështje, nuk ka prova dhe sigurisht që nuk
15 ka prova të pranueshme që ka ndodhë një gjë e tillë.

16 Tani do të flas për faktorët rëndues paraparë në
17 rregullën 163(1) (b) dhe nenin 72 të Kosovës, që sipas mendimit
18 tonë nuk vlejnë në rastin e z. Januzi.

19 Në lidhje me faktorët zbutës, përsëri, të përmendur në
20 rregullën 163(1) ka disa faktorë që kërkojnë përshtatjen e
21 dënimit. Së pari, kërkohet që të bëhet marrëveshje për
22 pranimin e fajësisë dhe kërkohet specifikisht përmes një skeme
23 legjislative që ky fakt duhet të merret parasysh si faktor
24 lehtësues.

25 Z. Januzi nuk ka dhënë deklaratë, por ka dhënë udhëzime

1 në lidhje me pendesën se ai përmes meje don të shprehë
2 pendesën për sjelljen e tij në prill të vitit 2023.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Avokat, a ju kam kuptuar drejt se z. Januzi nuk do të ishte i
5 gatshëm, në qoftë se do ta pyesnim ne që të shprehte pendesën
6 personalisht?

7 Z. REES: [Përkthim] Nuk është e lehtë për z. Januzi dhe
8 për atë punë edhe për shumë të pandehur tjerë që të flasin në
9 Gjykatë dhe kjo nuk duhet të merret si diçka kundër tij. Unë,
10 siç thashë, unë prej tij mora udhëzime të qarta që të shpreh
11 pendesën e singertë në emër të tij. Unë kam marrë udhëzime të
12 qarta prej tij për ta bërë këtë.

13 Mund ta pyes që të konfirmoj këtë, por besoj që ai nuk do
14 ta bënte këtë me lehtësi sepse nuk e ka të lehtë të flasë në
15 Gjykatë. Kemi Prokurorinë në këtë anë të sallës Gjykatës, kemi
16 Mbrojtjen në këtë anë të Gjykatës, në qoftë se ju dëshironi
17 unë mund ta pyes z. Januzi që ta konfirmojë këtë që ta thashë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Avokat, ta them qartë. Në këtë moment, fakti që z. Januzi
20 paraqet pendesën e tij përmes jush nuk mbahet kundër tij në
21 këtë moment.

22 Z. REES: [Përkthim] Por a do të merret atëherë parasysh
23 në favor të tij?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi
25 Gjykues, pas Zyrës së Prokurorisë dhe pas parashtrimeve të

1 Mbrojtjes mund të pyes dhe nuk ka kurrfarë detyrimi në qoftë
2 se i akuzuari vetë dëshiron të thotë diçka në lidhje me këtë.
3 Mirëpo, Trupi Gjykses nuk do t'ia imponojë askujt ta bëjë
4 këtë.

5 Dhe ju mund të thoni që "Preferojmë që jo", ju keni dhënë
6 arsyet e juaja. Por unë këtë jua lë juve.

7 Z. REES: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Kjo është
8 Gjykatë e juaj dhe ju mund t'i drejtoheni z. Januzi
9 drejtpërdrejt dhe nëse ka mundësi të konsultohem me të për
10 disa minuta.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Urdhëroni.

13 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

14 Z. REES: [Përkthim] Z. Januzi ma bëri me dije se është në
15 gjendje t'ju ndihmojë drejtpërdrejt në qoftë se dëshironi.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
17 i gatshëm?

18 Z. REES: [Përkthim] Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Atëherë do të vazhdojmë parashtrimet e juaja në lidhje me
21 dënimin dhe pastaj do t'i kthehem kësaj.

22 Z. REES: [Përkthim] Për sa u përket faktorëve lehtësues
23 që kërkojnë dhe dënim më të ulët, ne siç thamë edhe më herët,
24 ju referohemi faktit se ai nuk ka dosje penale. Nuk ka asgjë
25 kundër tij të regjistruar në evidencën penale. Dhe se Mbrojtja

1 -- dhe se Trupi Gjykues duhet t'i kushtojë vëmendjen e duhur
2 elementëve të bashkëpunimit dhe sjelljes së tij me Prokurorinë
3 e Specializuar dhe me Dhomat e Specializuara. Gjithashtu, ju
4 ftoj që të merrni parasysh këtë si faktor lehtësues.

5 Tani, shkurtimisht, do të flas shkurtimisht për çështjet
6 e zbutjes së dënimit. Një prej këtyre faktorëve është
7 marrëveshja për pranimin e fajësisë. Kjo nuk është në këtë
8 çështje një marrëveshje që është bë një momentin e fundit. Në
9 përputhje me rregullën 94(1), një marrëveshje për pranimin e
10 fajësisë mund të bëhet edhe në fund të çështjes.

11 Kjo marrëveshje për pranimin e fajësisë u bë përpara
12 hapjes së çështjes gjyqësore. Dhe kjo thuhet në rregullën
13 94(1) që është kohë e përshtatshme për t'u bërë. Dhe
14 marrëveshja u bë në një moment kur e vetmja kërkesë për
15 pranimin e provave e parashtruar nga Prokuroria u refuzua. Dhe
16 kjo është kërkesa e Prokurorisë për pranimin e intervistës apo
17 transkriptove të intervistës të Dëshmitarit 1 dhe Dëshmitarit
18 4891 në vend të dëshmive të tyre gojore. Ju, të nderuar
19 Gjykatës, e refuzuat këtë kërkesë.

20 Dhe gjithashtu kishte dhe një kërkesë apo kërkesa në
21 lidhje me mosnxjerrje materialesh prej Mbrojtjes, këto
22 pretendime i paraqiti Mbrojtja duke i vënë në dukje dhe
23 mosnxjerrjen e duhur të materialeve nga ana e ZPS-së. Këto
24 kërkesa kanë mbetur të pazgjidhura dhe ishin të pazgjidhura
25 deri në momentin e marrëveshjeve në fjalë. Dhe ato mbetën të

1 pazgjidhura edhe sot e kësaj dite.

2 Fakti që janë arritur marrëveshje për pranimin e
3 fajësisë, në lidhje me z. Januzi konkretisht, i ka kursyer një
4 sasi të madhe kohe Gjykatës si edhe i ka kursyer shpenzime të
5 shumta.

6 Për sa i përket çështjes së bashkëpunimit në lidhje me z.
7 Januzi, ne parashtrojmë se ai ka treguar bashkëpunim me Zyrën
8 e Prokurorit të Specializuar që në fazën më të hershme dhe kjo
9 është, duhet të merret në të mirën e tij. Ka filluar ky
10 bashkëpunim që nga fillimi kur kontaktuar për herë të parë kur
11 u nxor një urdhër *ex parte* nga Zyra e Prokurorit që ai të
12 paraqitet në adresën e tij dhe të kryhet një kërkim apo
13 kontroll në shtëpinë e tij si dhe të makinës së tij dhe
14 gjithashtu kërkesë për t'u kontrolluar edhe telefoni mobil i
15 tij.

16 Në fakt, ajo që ndodhi është se hetimi i ZPS-së u krye në
17 adresën e z. Januzi. Z. Januzi u takua me vullnet të lirë me
18 përfaqësuesit e ZPS-së. Ai në mënyrë vullnetare e dorëzoi
19 telefonin mobil dhe ua dorëzoi ZPS-së pa nevojë që të zbatohet
20 urdhri i kontrollimit.

21 Në atë datë, pra, në maj, më 3 maj 2023, ai u informua se
22 ishte duke u hetuar, ishte pjesë e diskutimit midis tij dhe
23 hetuesve dhe që nga kjo datë, pra, 3 maji e deri në tetor
24 2023, ky bashkëpunim ka punuar e ka shkuar të lirë për
25 intervistë në selinë EULEX-it.

1 Midis majit -- dhe dorëzoi telefonin mobil vullnetarisht
2 dhe në tetor, ai në mënyrë vullnetare u paraqit për
3 intervistë. Kur shkoi në selinë e EULEX-it për intervistë, ai
4 dha intervistë atje. Intervistë të plotë ku përshkroi hollë e
5 gjatë ngjarjet. Ai, në fakt, këtë e bëri edhe pse ndaj tij
6 ishte ngritur akuzë por ajo nuk ishte bërë e njohur atij.

7 Pastaj duke i marrë parasysh rrethanat e tij personale,
8 ai është i moshës 58-vjeçare. Nuk ka dosje penale. Është një
9 ushtar i mëhershëm. Ka luftuar gjatë luftës. Që nga lufta ka
10 punuar si baba, është edhe gjysh. Është njëri familjar. Është
11 njeri i komunitetit. Ka lidhje të forta me vendin ku jeton në
12 fshatin e Fushticës së Epërme. Atje ka jetuar dhe vepruar
13 gjithë jetën e tij. Atje është rritur, ka punuar atje, ka
14 vazhduar të jetojë aty.

15 Dhe shtëpia e tij që kishte ndërtuar familja në atë tokë
16 edhe përpara lindjes së tij është rinovuar me vetë shpenzimet
17 e familjes. Ai jeton atje me tre djemtë e tij - dhe dhënat për
18 ta përmenden në parashtrimet me shkrim - me vajzën e tij, me
19 dy të rejat e tij dhe gjashtë nipat dhe mbesat që janë të
20 moshës shumë të re. Për fat të keq, z. Januzi humbi gruan e
21 vet para disa vjetësh kur ajo edhe ndërroi jetë.

22 Ai është një njeri që jeton një jetë modeste, ai punon me
23 tre djemtë e tij në ndërtimtari.

24 Dhe në kohën e arrestimit të tij z. Januzi nuk punonte
25 për shkak të arsyeve shëndetësore. Ai ka reumatizëm të rëndë

1 në të dy gjunjët që është një rrezik dhe vështirësi e madhe
2 për dikënd që bën punën që bën ai.

3 Për sa u përket mjeteve financiare kemi dhënë disa
4 hollësi në lidhje me to në paragrafin 33 të parashtrime me
5 shkrim. Të ardhurat e familjes janë të përbashkëta dhe
6 përdoren për mbajtjen e një familjeje prej 13 njerëzish. Dhe
7 këto të ardhura ndryshojnë prej muaji në muaj, është, pra,
8 janë të ardhura të një familjeje, ekipi të përbërë prej
9 anëtarëve të familjes që merren me ndërtimtari dhe ajo që
10 fitohet në muaj nga të gjithë në familje përdoret për mbulimin
11 e shpenzimeve të jetesës të 13 njerëzve, gjashtë prej të
12 cilëve janë fëmijë dhe shtatë të tjerët janë të rritur dhe të
13 gjithë jetojnë së bashku në shtëpi.

14 Z. Januzi, një nga gjërat që e ka menduar dhe çka i ka
15 munguar gjatë kohës që ka qenë në paraburgim, është koha që
16 kalon me nipat dhe mbesat. Ai është një punëtor i madh edhe
17 pse ka vështirësi shëndetësore ai vazhdon punën si murator.
18 Dhe kur nuk punon ai kryesisht kalon kohën e lirë me nipat dhe
19 mbesat e tij.

20 Dhe dëshira e tij më e madhe është thjesht të kthehet në
21 shtëpi të jetë me nipat dhe mbesat sa më shpejt që të jetë e
22 mundur.

23 Ne parashtrojmë se duke i marrë parasysh të gjitha këto
24 që i thashë më lart duhet t'i caktohet një dënim më i ulët,
25 përkatësisht 24 muaj, duke marrë parasysh dhe kohën e kaluar

1 në paraburgim deri tani.

2 Së fundi, ngremë edhe një çështje. Ftojme Trupin Gjykses
3 që ta marrë parasysh këtë për një urdhër të mëtejshëm. Pra, ju
4 ftojme që të nxirrni një urdhër të mëtejshëm, që dënimi i
5 caktuar, të themi prej 24 muajve, duke marrë parasysh kohën e
6 kaluar në burg, të mos zbatohet me përjashtim kur i akuzuari
7 kryen një vepër penale tjetër gjatë periudhës së verifikimit
8 që duhet të jetë jo më e shkurtër se një vit. Dhe se ky
9 verifikim ligjor duhet të caktohet për qëllimet e urdhrit.

10 Është brenda të drejtës diskrecionale të Gjykatës të
11 nxjerrë një urdhër të tillë. Është marrë parasysh edhe nga
12 Trupi Gjykses I në çështjen Guçati dhe Haradinaj dhe i keni
13 referencat e nevojshme në parashtrimet e mia me shkrim të
14 cilat i referohen asaj pjese. Mund t'ju jap edhe hollësi të
15 tjera në qoftë se kjo do t'ju ndihmojë, mirëpo këtë do ta
16 gjeni në vetë aktgjykimin e atij Trupi Gjykses.

17 Dhe për më tepër, sipas nesh, kjo do të ishte një mjet
18 mjaft i fuqishëm për t'u përdorur në këtë çështje gjyqësore,
19 sigurisht që është brenda diskrecionit të Trupit Gjykses. Pra,
20 që një urdhër për caktimin e dënimit dhe zbatimin e dënimit,
21 urdhër që ai dënim të mos zbatohet me përjashtim kur i
22 akuzuari kryen ndonjë vepër penale tjetër gjatë periudhës së
23 verifikimit dhe kjo do të ndihmonte dhe rehabilitimin dhe
24 riintegrimin e të pandehurit. Ai don të kthehet sa më shpejt
25 në shtëpi dhe të jetë me nipat dhe mbesat e veta. Ai tashmë

1 është 12 muaj në paraburgim. Ai nuk ka kaluar nëpër diçka të
2 ngjashme deri tani në jetën e vet. Dhe siç është parë apo
3 treguar nga shprehja e singertë e pendesës përmes meje, kjo ka
4 pas efekt të madh mbi të.

5 Në qoftë se dhe ne themi se nuk është kështu, por në
6 qoftë se ai do të ishte i gatshëm të bënte një shkelje tjetër
7 në të ardhmen, atëherë do të kishte me një anë të vendimit të
8 tillë motivimin e duhur që të mos e bënte këtë.

9 Këto janë parashtrimet e mia në lidhje me dënimin.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Tani do t'ia jap fjalën znj. Prokurore. E keni fjalën,
13 urdhëroni. A mund të m thoni sesa kohë do ju duhet
14 përafërsisht?

15 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Do të përpiqem që të
16 përgjigjem brenda dhjetë minutave, mirëpo do të mundohem që
17 t'i mbulojë të gjitha pikat që i ngriti Mbrojtja.

18 Në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, palët kanë rënë
19 dakord për një shkallëzim dënimi prej 24 deri në 30 muaj
20 burgim për z. Januzi. Mbrojtja thotë në parashtrimet e veta me
21 shkrim dhe tani para Trupit Gjykses, se duhet të caktohet një
22 dënim më i ulët prej këtij shkallëzimi, pra, një dënim vetëm
23 prej 24 muajsh.

24 Është qëndrimi i ZPS-së se një dënim prej 30 muajsh
25 burgim, pra, më i lartë prej këtij shkallëzimi a do të ishte i

1 përshtatshëm dhe i nevojshëm në këtë rast duke marrë parasysh
2 peshën e veprave penale që ka kryer z. Januzi, duke përfshirë
3 edhe rolin specifik që ka kryer gjatë këtyre.

4 Të filloj me veprat penale. Veprat penale për të cilat ka
5 pranuar fajësinë janë: Ai dhe të akuzuarit e tjerë kanë vënë
6 në cak një dëshmitar konkret. Kanë bashkërenduar kontaktet, dy
7 kontaktet me dëshmitarët për ta nxitur atë që të mos japë
8 dëshmi përpara këtij Tribunali. Z. Januzi, konkretisht ishte
9 në komunikim të ngushtë me dy të akuzuarit tjerë gjatë gjithë
10 periudhës së Aktakuzës dhe ai personalisht e kontaktoi
11 dëshmitaren gjatë kontaktit të dytë apo në lidhje me kontaktin
12 e dytë që ndodhi.

13 Dhe ai veproi nën udhëzimet e z. Shala, mirëpo e mori si
14 detyrë të vetën që t'i drejtohej dëshmitarit personalisht. Dhe
15 kur e bëri këtë pas takimit të parë vijoi takimi i dytë i z.
16 Januzi, me çfarë ne nënvijëzojmë se vazhduan përpjekjet për ta
17 detyruar dëshmitarin të tërhiqte dëshminë e vet përpara këtij
18 Tribunali. Dhe ai më pas vazhdoi dhe ia transmetoi ofertën për
19 "ndihmë" nga z. Shala dhe persona të tjerë të papërmendur në
20 emër për ta detyruar dëshmitarin që në fund të tërhiqte
21 dëshminë para kësaj Gjykate.

22 Tani kam parashtrime që dua t'i bëj për sa i përket dëmit
23 dhe thashë më herët se këtë do ta bëjmë pasi të marrim
24 parashtrimet e Zyrës për Përfaqësimin e Viktimave.

25 Ne dëgjuam nga Mbrojtësi sot në mëngjes se faktet që keni

1 përpara dhe duhet të shqyrtoni janë vetëm ato që janë të
2 pasqyruara në Shtojcën 1 të marrëveshjes për pranimin e
3 fajësisë.

4 Tani, baza faktike përmban faktet në lidhje me të cilat
5 të akuzuarit pranojnë fajin në mënyrë që Trupi Gjykses të mund
6 t'i shpallë fajtorë për veprat penale të pengimit dhe të
7 frikësimit gjatë procedurës penale.

8 Unë do t'i them Trupit Gjykses sipas rregullave tona
9 sidomos rregulla 162(1), i detyron "Mbrojtjen dhe Prokurorin e
10 Specializuar që të informojnë Panelin për çdo gjë që mund t'i
11 ndihmojë ata në marrjen e vendimit ..."

12 Ky rregull ka precedent në tribunalet tanë dhe
13 specifikisht do t'i them Panelit që të shikojë çështjen Babic
14 në Tribunalin e ish-Jugosllavisë dhe vendimin për dënimin që u
15 dha aty numër 18/07 i datës 18/07/05. Në paragrafin 18 ai
16 Panel atje tha që do të ushtronte diskrecionin e vet në
17 përcaktimin e dënimit mbi bazën e fakteve për të cilat ishin
18 rënë dakord nga palët si dhe informacioneve shtesë.

19 Unë po e parashtroj këtë sepse ka prova që janë bërë të
20 njohura gjatë kohës, gjatë këtyre procedurave, përfshirë edhe
21 deklaratat e dëshmitarit që i përmendi kolegu, që trajtojnë
22 disa -- një pjesë të dëmit të cilin ZPS-ja në qoftë se do
23 ishte bërë gjykim do t'i kishte vërtetuar gjatë atij gjykimi.
24 Dhe unë desha të përmend atë që tha kolegu im në lidhje me
25 ryshfetin monetar që u ngrit në kontekstin e kontaktit të z.

1 Januzi.

2 Desha të kërkoj nga Trupi Gjykses që të marrë parasysh
3 faktin se përveç materialeve që u kemi dhënë palëve, nuk ka
4 materiale të tjera, por Prokuroria dëshiron që të bëjë
5 parashtrimet e veta në lidhje me dënimin.

6 Megjithatë, desha të them këtë që Trupi Gjykses i ka të
7 gjitha materialet për të cilat ka nevojë për të marrë vendim
8 për të konstatuar i vetmi dënim i drejtë për z. Januzi është
9 në fakt 30 muaj burgim.

10 Më falni, një moment.

11 Desha të përmend diçka tjetër para sesa të kaloj në një
12 çështje tjetër, Mbrojtësi i Specializuar përmendi dhe një fakt
13 tjetër që përmban materiali që i është bërë i njohur atyre,
14 por që nuk e përmban aktakuza apo marrëveshja që është se
15 kontakti midis z. Januzi dhe dëshmitari në rastin e dytë siç e
16 kemi quajtur, kontakti i dytë është iniciuar nga dëshmitari.

17 Por në përgjigje të kësaj dua që t'ju referoj, të nderuar
18 Gjykatës, në materialin që është nxjerrë për palët nga ZPS-ja
19 sepse aty, kjo nuk është e gjithë historia, aty thuhet se
20 faktet siç janë paraqitur aty në lidhje me këtë ryshfet
21 monetar nuk është e tëra. Deklarata e dëshmitarit paraqet me
22 hollësi se si z. Januzi u paraqit tek shtëpia e dëshmitarit
23 dhe çfarë e bëri dëshmitarin që t'i kërkonte atë shumë parash.

24 Pra, Trupi Gjykses, mendoj unë, nuk duhet ta kufizojë
25 veten por duhet t'i përmbahet rregullës 162(1) në mënyrë që të

1 shqyrtohen të gjitha faktet që mendon se janë të arsyeshme për
2 përcaktimin e dënimit në këtë rast.

3 Për sa i përket dëmit, që është pjesë përbërëse e gjithë
4 kësaj analize edhe në lidhje me materialin shtesë. Arsyeja pse
5 e them këtë është se edhe pa përmendur, pa iu referuar
6 materialeve të bëra të ditura që janë dorëzuar palëve, po
7 thjesht në pranimet që janë në marrëveshjen për pranimin e
8 fajësisë dhe që i kemi diskutuar këto, të gjitha këto janë të
9 mjaftueshme që Trupi Gjykses, bazuar në faktet që janë pranuar
10 dhe është krejt e parashikueshme, që rezultati i dy kontakteve
11 që u bënë me dëshmitarin njëri pa tjetrit, shumë shpejt, njëri
12 pas tjetrit nga dy njerëz të ndryshëm, me siguri që kishin
13 efektin që kanë shkaktuar dëm tek ai, pra, i kanë shkaktuar
14 atij frikë.

15 Nuk është e vetmja veprë penale kjo për të cilën po
16 flasim sot. Sepse është edhe vepra penale kundër administrimit
17 të drejtësisë që përbën një problem mjaft të madh, një sfidë
18 dhe vështirësi mjaft të madhe për sigurinë dhe integritetin e
19 procedurave gjyqësore, përfshirë edhe në këtë Tribunal. Këto
20 minojnë zbulimin e të vërtetës dhe pengojnë drejtësinë edhe
21 vendosjen e drejtësisë për shoqërinë si e tërë. Dhe ndikimi i
22 këtyre veprave penale, është rezultat i një atmosfere
23 mbizotëruese të frikësimit në Kosovë edhe në gjykime të tjera
24 të këtij lloji.

25 Fakti që një dëshmitar i mbrojtur i DHSK-së kontaktohet

1 disa herë edhe kjo, ky fakt ka efekt shkuraajues edhe tek
2 dëshmitarët e tjerë të cilët do të mendojnë dhe do të
3 shkuraajohen prej dhënies së dëshmisë.

4 T'i kthehemi dhe faktorëve të tjerë që duhet të shqyrtojë
5 Trupi Gjykses. Sipas rregullës 163(2), pranimi i fajësisë
6 duhet të çojë në një dënim më të ulët, por edhe faktorë të
7 tjerë edhe koha se kur bëhet ky pranim duhet të merret
8 parasysh.

9 Rekomandimi i ZPS-së për dënimin e reflekton këtë, pra,
10 dhënia e 30 muajve e reflekton këtë ulje të dënimit. Në bazën
11 faktike, z. Januzi bëri vetëm disa pranime të kufizuara. Këto
12 pranime erdhën vetëm në prag të fillimit të gjykimit. Kjo
13 ishte rreth një javë para sesa të bëheshin deklaratat hyrëse
14 dhe të fillonte gjykimi. Këtë ne e mbështesim, sigurisht, këto
15 dy pika të Aktakuzës për të cilat u bënë pranimet sot, po këto
16 janë vetëm minimumi në këtë rast.

17 Po kështu, Mbrojtësi i Specializuar përmendi dy
18 incidentet që ai propozon se tregojnë se z. Januzi ka
19 bashkëpunuar. Së pari, kur u përball me urdhrin për kontrollim
20 dhe sekuestrim të telefonit, ai e ofroi. Por, sigurisht, është
21 e vështirë ta quash këtë si të bërë me vullnet të lirë kur
22 hetuesit kanë ardhur aty me një urdher për kontrollim dhe
23 sekuestrim, për sekuestrimin e telefonit tuaj. Pra, unë do të
24 thoja që Trupi Gjykses nuk duhet t'u kushtojë shumë vëmendje
25 këtij faktori.

1 Së dyti, për më tepër intervista që i dha ai ZPS-së nuk
2 mund të quhet se ai ishte bashkëpunim nga ana e tij. Ai e
3 pranoi që kishte vizituar dëshmitarin, por as nuk iu afrua
4 bërjes së një pranimi që do të krijonte bazat faktike të cilat
5 janë bazat për në lidhje me pranimin e fajësisë sot. Pra, ai
6 faktikisht u përpoq të pengonte ose t'i mjegullonte faktet që
7 lidheshin me veprën penale të tij.

8 Dhe duke pasur parasysh të gjithë këto faktorë, ZPS-ja
9 argumenton se duke i vënë të gjithë këto në balancë, të marra
10 së bashku, Trupi Gjykses duhet të japi një vendim në anën në
11 pjesën më të lartë të përshkallëzimit të dënimeve që është 30
12 muaj në burg.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Avokat, keni fjalën përsëri për ndonjë parashtrim nga ana
15 juaj.

16 Z. REES: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, unë do të trajtoj
17 çështjen se cilat fakte duhet të merren parasysh.

18 Fraza kyçe këtu është "faktet". Fjala kyçe është
19 "faktet". Për faktet biem dakord, këto janë rënë dakord, kjo
20 nuk është çështje për diskutim këtu, ato duhet, faktet duhet
21 të vërtetohen në standardin penal të vërtetimit. Dhe nuk mund
22 të ketë asnjë lloj konsiderate tjetër në këtë drejtim.

23 Unë ndoshta nuk u shpreha qartë, se nuk do të thotë se
24 ajo që shikoni ju është vetëm baza e fakteve për të cilat
25 është rënë dakord. Për shembull, mund të shikoni dhe

1 informacion tjetër që pranohet nga të gjitha palët si, për
2 shembull, është certifikata nga Zyra e Dhënies së Evidencave
3 Penale e Kosovës, zyra qendrore ku thuhet se ai nuk ka asnjë
4 dënim penal.

5 Po kështu informacione të tjera mund të ofrohen, mund të
6 jenë ofruar nga ZPS-ja në të kaluarën. Mund të jenë ofruar nga
7 dëshmitarët në të kaluarën. Por fakti që ne kundërshtojmë
8 është që, ato nuk mund të bëhen pjesë e vendimit tuaj në këtë
9 fazë përveç nëse ato vërtetohen sipas standardit penal, sipas
10 drejtësisë penale bazuar në provat që janë paraqitur kësaj
11 Gjykate.

12 Unë i rikujtoj Trupit Gjykues dhe ZPS-së për marrëveshjen
13 që z. Avokat vetë e ka nënshkruar në paragrafin 5 të së cilës
14 përcaktohen, siç e keni thënë edhe juve, e nderuar Gjykatëse
15 dhe aty trajtohen ato paragrafët, ju i trajtuat një nga një
16 paragrafët e Aktakuzës së datës 10 korrik 2024 të cilat ai
17 pranon dhe që ai -- ato do të ishin, do të vërtetoheshin
18 përtej dyshimit të arsyeshëm në qoftë se do të bëhej gjykimi.

19 Paragrafi 5 po kështu e bën të qartë se ai kundërshton
20 faktet e tjera në lidhje me pretendimet që përmban Aktakuza e
21 10 korrikut. Kjo është në marrëveshjen që e ka nënshkruar vetë
22 Prokuroria dhe për të cilën është rënë dakord dhe për të cilën
23 po flasim sot.

24 Pra, ju mund të shikoni dhe informacione të tjera si, për
25 shembull, referenca, rekomandime në mbështetje të një

1 pandehuri, apo nëse ka ndonjë dënim të mëparshëm nga gjykatat
2 e Kosovës, të gjitha këto janë çështje që nuk janë
3 kontrovesiale dhe nuk janë në -- vihen në dyshim ose të
4 debatueshme nga palët.

5 Por çfarëdo sugjerimi se ka pasur frikë apo shqetësim nga
6 Dëshmitari 1, këtë ne e vëmë në dyshim. A kemi ne dëshmi prej
7 tij, prova prej tij për këtë? Kështu që ne nuk mund të shkojmë
8 përtej marrëveshjes për pranimin e fajësisë për gjëra që nuk
9 janë, për të cilat ai nuk është pajtuar shprehimisht.

10 Kolegia tha, e përshkroi atë që ka pranuar z. Januzi
11 është minimumi i mundshëm, po, sigurisht, ai do të dënohet mbi
12 ato baza dhe prandaj ai këtë pranuar që të bëjë, atij i vjen
13 keq për atë që ka bërë dhe do të dënohet në bazë të kësaj, por
14 jo në bazë të informacioneve të tjera të cilat nuk janë të
15 provuara dhe në bazë të një vendimi gjykate.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
17 t'ia jap fjalën Prokurores nëse ka ndonjë diçka tjetër për të
18 shtuar.

19 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Nuk kam asgjë tjetër për të
20 shtuar.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
22 Faleminderit, znj. Prokurore.

23 Atëhere unë kam një ose ndoshta më shumë sesa një pyetje
24 për z. Januzi.

25 Z. Januzi, avokati juaj tha në emrin tuaj se ju keni

1 reflektuar gjatë kohës që ishit në paraburgim dhe dëshironi të
2 thoni që ju vjen keq, jeni penduar për sjelljen tuaj në prill
3 të vitit 2023. Dhe pyetja ime e parë për ju është: A e
4 konfirmoni ju këtë që sapo u tha?

5 I AKUZUARI JANUZI: Po, e konfirmoj.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
7 mund t'i thoni Panelit, Trupit Gjykses se pse ju vjen keq për
8 këtë që keni bërë, pse jeni penduar?

9 I AKUZUARI JANUZI: Duhet të ngritem në këmbë, apo jo?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
11 ka nevojë të ngriheni në këmbë.

12 I AKUZUARI JANUZI: Pa marrë parasysh se rastis që dhe
13 takimi im me dëshmitarin e Prokurorisë, pra, është fakt përbën
14 pengim të drejtësisë, normal që nuk më vjen mirë për atë gjë.
15 Dhe pse nuk jam jurist dhe ndoshta nuk e kam marrë parasysh me
16 kohë, po nuk më vjen mirë për gjestin që kam bërë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A do
18 të bënit diçka të ngjashme në të ardhmen?

19 I AKUZUARI JANUZI: Tani kur e kuptoj rëndësinë e saj,
20 sigurisht që nuk do ta bëj.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
22 nëse ju kuptova drejt, ju po i thoni Trupit Gjykses dhe, më
23 korrigjoni nëse e kam gabim, pra, ju e konsideroni që sjellja
24 juaj ishte e gabuar?

25 I AKUZUARI JANUZI: Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Januzi, kjo ishte e mjaftueshme për Trupin Gjykues.

3 Kjo ishte pjesë e fundit e seancës në lidhje me
4 marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga ana e z. Januzi,
5 midis tij dhe Prokurorisë, nëse, sigurisht, vetëm në qoftë se
6 nuk ka ndonjë gjë tjetër që duan të ngrenë palët.

7 E shikoj që palët thonë jo, që nuk kanë asgjë për të
8 thënë, për të shtuar. Mbrojtja po thotë që nuk ka gjë për të
9 shtuar.

10 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Unë kam diçka në lidhje me
11 një propozim për sa i përket procesit. Për sa i përket
12 aktakuzës të rishikuar më tej për z. Januzi, Trupi Gjykues
13 parashikon që të kërkojë një ndryshim të paragrafit 12 të
14 marrëveshjes. Dhe nuk e di nëse do të jetë e mundur që këto
15 ndryshime në marrëveshje të bëhen me shkrim dore në mënyrë që
16 të mos kemi ndonjë stërzgjatje të këtij procesi apo të bëhet
17 një -- dhe që të mos bëhet një marrëveshje e re.

18 Desha vetëm thjesht t'ia paraqes këtë Trupit Gjykues nëse
19 mund ta bëjmë këtë në mënyrë të shpejtë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Avokat kjo është një vërejtje që nuk ka të bëjë vetëm me
22 marrëveshjen e pranimit të fajësisë për z. Januzi, por në
23 përgjithësi për të tre të akuzuarit?

24 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po. Ashtu është.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Atëherë ta shënojmë këtë për procesverbal. E kemi mbaruar
2 seancën për z. Januzi sot. Dhe tani do të marrim në shqyrtim
3 propozimin e bërë nga Prokurorja në lidhje me ndryshimet e
4 mëtejshme që mund t'i bëhen marrëveshjeve për pranimin e
5 fajësisë, të triave atyre.

6 Unë do t'i ftoj Mbrojtësit e të tre të akuzuarve që të
7 japin amendimet e tyre për këtë dhe pastaj do të vazhdojmë më
8 tej në bazë të kësaj.

9 Z. REES: [Përkthim] E kam parasysh që nesër do të kemi
10 një farë kohe për ta diskutuar këtë. Dhe unë sigurisht i
11 bashkohem lutjes që ne ta trajtojmë këtë çështje sa më shpejt,
12 por mund të biem dakord se me çfarë kushtesh do t'i bëjmë këto
13 dhe të biem -- dhe pas kësaj unë mund t'ia shpjegojë z. Januzi
14 dhe mund t'i kërkoj që të nënshkruaj dhe t'i shpjegoj çdo gjë
15 që është kërkuar të bëhet në atë marrëveshje.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Z. Shala nuk do të jetë nesër këtu,
17 por unë mendoj që nuk është aq e thjeshtë për t'u bërë. Sepse
18 do të duhet një farë kohe. Po sigurisht unë i lavdëroj
19 përpjekjen që po bëhen për t'i organizuar këto.

20 Por unë mendoj që është më mirë që këto ndryshime të
21 bëhen dhe ne pastaj të organizojmë rendin sesi do të
22 nënshkruhen këto marrëveshje.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Avokatja e z. Bahtijari.

25 ZNJ. GERRY [Përkthim] Kërkoj ndjesë. A mund të ma bëni

1 pyetjen dhe një herë? Kërkoj ndjesë isha pak e hutuar.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
3 jeni dakord me këtë çfarë parashtrimesh keni në lidhje me
4 propozimin e Prokurores?

5 ZNJ. GERRY [Përkthim] Unë nuk mendova se kjo ka të bëjë
6 me z. Bahtijari sepse ai do të jetë këtu nesër. Mendova që
7 është për personat që nuk do të jenë këtu nesër, të akuzuarit
8 që nuk do të jenë këtu nesër.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne
10 nuk do ta diskutojmë këtë çështje tani. Po Prokuroria tha që
11 ka të bëjë me ndryshimet që mund t'i bëhen marrëveshjes dhe
12 nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga të akuzuarit.

13 ZNJ. GERRY [Përkthim] Klienti im nuk është këtu. Ai do të
14 jetë këtu nesër. Kështu që mund të merremi me këtë çështje
15 nesër. Unë nuk e kisha mendjen kur po e bënit pyetjen juve
16 sepse faktikisht ai nuk është këtu dhe mendova se kjo pyetje
17 nuk ka të bëjë me mua.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
19 që do bëjmë dhe mund të jetë një ide. Shoh që mund të jetë
20 edhe e dobishme. Ka shumë mundësi që do të bëhen dhe do të
21 ketë nevojë për ndryshime të tjera shtesë.

22 Në qoftë se arrihet marrëveshje për të hequr ndonjë
23 paragraf pas diskutimit që patëm dhe tërheqjes së kërkesës për
24 rivlerësim apo autorizimit për të bërë apel kundër vendimit
25 612, mund të ndodhë që do ketë edhe çështje të tjera që ju

1 duhet të diskutohen më tej.

2 Palët janë të mirë se ardhura që të arrijnë marrëveshje,
3 të bien dakord që ka pjesë të marrëveshjes për pranimin e
4 fajësisë që nuk janë të zbatueshme më, por kjo nuk e
5 parandalon Trupin Gjykues që të propozojë ndryshime tjera
6 shtesë në këtë marrëveshje. Ky është qëndrimi jonë tani për
7 tani.

8 Znj. Prokurore.

9 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit. Unë bëra
10 propozimin bazuar në faktin që kuptova se bëhet fjalë për
11 ndryshime vetëm në paragrafin 12. Në vend që të zbatohen
12 ndryshimet për të cilat është rënë dakord, ndoshta është mirë
13 që të presim derisa Paneli të rimarrë vendimin lidhur me të
14 gjitha ndryshimet.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
16 Prokurore, në mëngjes sot udhëzimet, planifikimi për mënyrën e
17 zhvillimit të seancës përfshinte edhe udhëzime të tjerë shtesë
18 të Trupit Gjykues lidhur me këtë çështje. Për momentin nuk jam
19 në gjendje t'ju them më shumë lidhur me këtë pikë. Duhet të
20 diskutojmë mes nesh së pari.

21 Në rregull. Tani kalojmë tek një çështje që nuk është
22 trajtuar akoma përpara. Që të mbyllim seancën e sotme, vërejmë
23 një kërkesë të znj. Bahtijari. Pra, nesër, në seancën e
24 nesërme lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë z.
25 Bahtijari, në mëngjes, kjo ishte kërkesa me qëllim që të

1 përdoret sa më mirë koha që është në dispozicion dhe kjo
2 kërkesë është dorëzuar Trupit Gjykses përmes emailit në orën
3 14.54.

4 Trupi Gjykses është i -- ka shumë besim që koha do të
5 jetë e mjaftueshme për të trajtuar kushtet e marrëveshjes që
6 kanë të bëjnë me z. Bahtijari dhe çështjet që lidhen me të në
7 seancën e pasdites dhe për rrjedhojë kërkesa hidhet poshtë, do
8 të fillojmë në orën 1.00 pasdite siç është përcaktuar në
9 kalendarin paraparak.

10 Me këtë mbyllim urdhrin gojor të Trupit Gjykses.

11 Ka diçka tjetër që dëshironi të ngrini? Dhe do t'ju jap
12 fjalën z. Rees.

13 Znj. Prokurore, keni diçka për të paraqitur?

14 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Asgjë më shumë për sot.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Rees, e keni fjalën ju.

17 Z. REES: [Përkthim] Një çështje shkurtimisht. Është një
18 kërkesë për riklasifikim.

19 Më herët keni nxjerrë një vendim, e nderuar Gjykatëse,
20 për çështje që kanë të bëjnë me procedurat e fajësisë,
21 diskutimeve dhe marrëveshjes së fajësisë, parashtimi 612,
22 duhet të rregullonte këto procesin, pra, që na ka çuar deri në
23 seancën e sotme. Si pjesë e kësaj parashtimi binte bashkë me
24 një shtojcë konfidenciale ex parte me udhëzimin për Prokurorin
25 e Specializuar që të japë, dorëzojë deri më datën jo më vonë

1 se më 6 dhjetor parashtrimet mbi çështjet konkrete të
2 specifikuara në shtojcë si pjesë e këtij vendimi dhe kjo është
3 përsëritur në vendimin tuaj në arsyetimin e vendimit.

4 Tani kemi kaluar fazën e procedurës së marrëveshjes për
5 fajësinë lidhur me z. Januzi, e kemi përbyllur këtë edhe pse
6 do vazhdojmë nesër me të akuzuarin tjetër, kërkesa jonë është
7 për Gjykatën që të rivlerësojë riklasifikimin e shtojcës dhe
8 parashtrimet që i përgjigjen asaj të dorëzuara nga ZPS-ja
9 sipas parashtrimit 612 në rast se Mbrojtja dëshiron të bëjë
10 parashtrime dhe ata kanë mundësinë, në qoftë se duan, të bëjnë
11 parashtrime lidhur me përmbajtjen e tij.

12 Natyrisht, nuk e di përmbajtjen e tij sepse për momentin
13 është *ex parte* dhe e vetmja palë e cila e ka parë atë është
14 Prokuroria. Nga ky udhëzim nxjerrë, deduktoj që bëhet fjalë që
15 ata bëjnë parashtrime në këtë dhe do të kërkoja që Gjykata ta
16 rivlerësojë, ta riklasifikojë atë sepse ka qenë pjesë e
17 vendimit që rregullonte këtë seancë për marrëveshjen e
18 pranimit të fajësisë dhe neve jemi të mendimit që të
19 pandehurit të shohin të dyja kërkesën dhe parashtrimet që
20 lidhen me të nga ZPS-ja.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
22 Prokurore, a mund të vazhdojmë të qëndrojmë në seancë publike?

23 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Nuk do të trajtoj thelbin
24 por do të trajtoj rolin e Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

1 mund të parashikoj atë që do të thoni, a i kërkon Trupit

2 Gjykues që të kalojmë në seancë private, apo jo?

3 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jemi mirë në seancë publike.

4 Ajo që do të them në seancë publike është sa i takon
5 shtojcës, ne nuk mbështesim riklasifikimin e saj. Ka të bëjë
6 me masat mbrojtëse të dëshmitarëve. Dhe qartësisht që jo vetëm
7 parashtrimet nuk duhet të shihen përpara që të kërkohet
8 riklasifikimi por do të parashtronim se *WPSO* duhet të
9 konsultohet lidhur me përmbajtjen e kësaj shtojce.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Avokat a keni diçka për të thënë?

13 Z. REES: [Përkthim] Falenderoj kolegen time për
14 informacionin e pakët që na dha, të paktën për natyrën e këtij
15 dokumenti, materiali. S'kishim asnjë informacion për këtë.

16 A pranojmë apo jo është pjesë e tërësishme e kornizës
17 legjislative të Dhomave të Specializuara dhe komunikimet ex
18 parte mes Trupit Gjykues dhe ZPS-së dhe palët nëse është e
19 nevojshme edhe kjo është pjesë e kësaj kornize ligjore,
20 legjislative. Unë inkurajoj vazhdimisht në rastet kur është e
21 mundshme edhe në qoftë se dokumenti nuk mund të riklasifikohet
22 që t'i jepet një përshkrim i dokumentit që në mënyrë që të
23 paktën të kuptojmë se a do të duhej që të ishte klasifikuar
24 për ashtu siç është klasifikuar.

25 Pra, do të kërkoja se në qoftë se nuk bëhet të bëhet

1 riklasifikimi në tërësi, të paktën të jepet një version i
2 redaktuar ose një dokument që jep një përmbledhje të
3 përmbajtjes së këtij materiali që të kuptojmë të paktën që
4 ishte dokument *ex parte* dhe që nuk kishte sugjerim nga ana
5 jonë që juve t'ju tregohet një dokument që ndikon në këtë
6 procedurë sa i takon të drejtave të të pandehurve.

7 Kaq kishim.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Avokatët e tjerë Mbrojtës a kanë diçka për të thënë?

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Pasi duke qenë se diskutuam këtë
11 çështje me z. Rees, këtë që sapo paraqiti, ne e mbështesim atë
12 dhe mbështesim këtë, por s'jemi çështje të tjera për të
13 ngritur në këtë fazë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
15 t'ju jap fjalën znj. Prokurore, por do të dëgjoj parashtrimet
16 fillimisht të të gjithë Avokatëve Mbrojtës.

17 ZNJ. GERRY [Përkthim] Ajo që dëgjuam nga Prokuroria sot
18 bazuar në atë, ne do të kërkonim që parashtrimet e
19 protokolluara të përcaktojnë kategoritë që janë mbesin si *ex*
20 *parte*. Të paktën që ky parashtrim të qartësojë këtë dokument
21 në veçanti dhe ndoshta mund të çojë pastaj në rishqyrtimin e
22 tij dhe riklasifikimin e tij.

23 Pra, më duket se jam diku mes dy palëve.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Parashtrimet u dëgjuan, u shënuan.

1 Znj. Prokurore, keni diçka për të shtuar përpara që t'ju
2 them sesi do veprojnë Trupi Gjykses në vijim?

3 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Doja të kërkoja që të
4 trajtojmë këtë çështje në parashtrime me shkrim, sepse nuk
5 ndihemi shumë rehat që të përgjigjemi në shkëmbime gojore të
6 menjëhershme. Është diçka që kërkon më shumë reflektim dhe
7 ndoshta që të paraqesim edhe propozime që mund të adresojnë
8 çështjet e ngritura dhe shqetësimet e ngritura nga avokati i
9 Mbrojtjes.

10 Pra, propozimi im është që të kalojmë këtë pjesë ta
11 trajtojmë me parashtrime me shkrim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
13 diskutojmë sërish këtë çështje nesër në qoftë se është e
14 nevojshme, përndryshe do të japim një urdhër, do të lëshojmë
15 një urdhër që do të trajtojë mënyrën e vazhimit të mëtejshëm.

16 Shoh avokaten mbrojtëse të z. Bahtijari që ka ngritur
17 dorën. Znj. Gerry.

18 ZNJ. GERRY [Përkthim] Shumë shpejt. Kam -- unë bëra
19 sugjerimin që të mos kërkohej, me qëllim që të ndihmojnë
20 përcjelljen e pyetjeve z. Bahtijari në momentin kur ai do jetë
21 këtu nesër, të jetë sa më thjesht që është e mundur, ndoshta
22 udhëzime për sa i përket numrave që duhet të lexohen.

23 Dhe e kam shkruar këtë në një dokument thjesht në mënyrë
24 që t'ju ndihmojë juve. Nuk po bëj kërkesë, po thjesht po ju
25 pyes që -- nuk po bëj parashtrim të protokolluar, është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë mbi Marrëveshje për Pranimin e Fajësisë (Seancë e hapur) Faqe 162

1 thjesht një sugjerim që ndoshta mund ta merrni parasysh e të
2 keni një kopje të përkthyer për të.

3 Nuk mendoj që më takon mua që t'i jap atij pyetjet që
4 mund ta ndihmojnë, pra, paraprakisht. Dhe uroj thjesht që ju
5 ta bëni. Sugjerimi është që kjo të bëhet sa më shpejt nesër.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
7 morëm parasysh kërkesën tuaj, sugjerimin tuaj, si dëshironi ta
8 formuloni atë dhe do të transmetojmë udhëzimet juve sa më
9 shpejt që të jetë e mundur.

10 ZNJ. GERRY [Përkthim] Faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me
12 këtë mbyllim seancën e sotme.

13 Siç e thamë më herët, do të shihemi nesër në orën e 3.30
14 me përbërjen e tre të akuzuarve. Në 15.30 do të jenë të gjithë
15 të akuzuarit, avokatët e tyre mbrojtës, kërkojmë, pra, praninë
16 e tyre natyrisht. Ndërsa ne do të vazhdojmë seancën në 1.00
17 pasdite, siç e thamë më herët, për marrëveshjen për pranimin e
18 fajësisë sa i takon z. Bahtijari, mes z. Bahtijari dhe ZPS-së.
19 Pra, e gjithë kjo mund të përfundojë rreth orës 3.30,
20 megjithatë mund të shkojë pak edhe më vonë. Ndoshta mund të
21 shkojë deri në orën 4.00-4.30. Ka patur disa dallime mes
22 seancës për z. Januzi dhe seancës për z. Shala sa i përket
23 kohës që është dashur.

24 Tani falënderoj palët për pjesëmarrjen e tyre në seancën
25 e sotme. Dua të falënderoj edhe përkthyesit - u kërkova atyre,

1 nuk kërkova që të punojnë përtej orarit të caktuar - por e
2 gjitha kjo u organizua nga teknikët dhe personeli i sigurisë,
3 falënderoj të gjithë këta për ndihmën, mbështetjen e tyre.

4 --- Seanca mbyllet në orën 17.36

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25